RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI PËRPUTHSHMËRINË

NË

UJËSJELLËS KANALIZIME SHA SARANDË

SHTATOR 2022

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.....	7
II.	**HYRJA**	
1.	Objekti i auditimit.....	10
2.	Qëllimi i auditimit.....	10
3.	Identifikimi i çështjes.....	10
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	**11**
5	Përgjegjësitë e audituesve.....	11
6	Kriteret e vlerësimit.....	11
7	Standardet e auditimit.....	11
8	Metoda e auditimit.....	12
9	Dokumentimi i auditimit	12
III.	**PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....**	12
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	12
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	13
2.1	**Pika 1.** Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.....	13-15
2.2	**Pika 2.** Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese (Këshilli i Administrimit dhe Administratori)	16-17
2.3	**Pika 3.** Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë.....	18-20
2.4	**Pika 4.** Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.	21-24
2.5	**Pika 5.** Mbi rregullshmërinë e shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).....	25-30
2.6	**Pika 6.** Mbajtja e evidencave kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.....	31-37
2.7	**Pika 7**. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen e zbatimin e kontratave.	39-63
V.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET.....**	**64-81**
VI.	**ANEKSE.....**	**82-104**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Aktiviteti kryesor i Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë është shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët dhe shitja e tij, mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre, forcimi i marrëdhënieve me konsumatorët. UK SHA Sarandë është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin, rinovimin dhe modifikimin e sistemit të furnizimit me ujë, furnizimin me ujë të konsumatorit në mënyrë të vazhdueshme gjate 24 orëve të çdo dite të vitit sipas standardeve në fuqi të cilësisë së ujit.
Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria aktivitetit të subjektit për periudhën nga 01.01.2019 deri më datë 31.12.2021.
Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, vendimmarrja e arganeve drejtuese të shoqërisë, planifikimi dhe realizimi i programit ekonomiko-financiar, pasqyrat financiare, shpenzime për investime, shpenzimet operative, realizimi i prokurimeve dhe kontratave përkatëse, etj.

I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Referenca me Raportin Përfundimtar të auditimit.	Rëndësia	Rekomandimi
1	Për periudhën objekt auditimi ndërmjet UK SHA Sarandë dhe OSHEE janë lidhur 23 kontrata për furnizimin me energji elektrike të vetë shoqërisë si dhe funksionimin e stacioneve të pompimit, pompave apo elektropompave. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, detyrimi i lindur nga mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE deri më datë 31.12.2021, ka arritur në vlerën 114,177,290.87 lekë, si dhe kamatëvonesat mbi këtë detyrim në **shumën 101,626,174.54 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë,** veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8662, datë 18.09.2000, *"Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike"* i ndryshuar, neni 1.	Pika 5	E Lartë	-Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për likuidimin e faturave të energjisë elektrike në afatet e përcaktuara nga kuadri rregullator në fuqi, për të mos krijuar kamatëvonesa, të cilat rëndojnë artificialisht buxhetin e institucionit. - Nga Këshilli i Administrimit të merren masa të menjëhershme, ku të hartohet një plan emergjent për shlyerjen detyrimeve dhe kamatëvonesave që ka Shoqëria ndaj OSHEE për 23 kontratat për furnizimin me energji elektrike.

2	Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Bankave BEI, IDA dhe KfŴ janë lidhur marrëveshjet e financimit konkretisht: 1. Marrëveshja me BEI për Projektin "Infrastruktura Ujore Bashkiake Stacioni i trajtimit të ujërave të ndotura" me vlerë financimi në shumën 2,357,251 Euro. 2. Marrëveshja me IDA për Projektin "Projekti Bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime" me vlerë financimi në shumën 2,186,719 USD. 3. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake I" me vlerë financimi në shumën 4,000,000 Euro. 4. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake II" me vlerë financimi në shumën 500,000 Euro. Për likuidimin e këtyre shumave të sipërpërmendura ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si përfaqësues i Qeverisë Shqiptare dhe Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë janë nënshkruar akt marrëveshjet nën huaje respektive, ku ende kanë mbetur detyrimet për t'u shlyer deri më datë 31.12.2021, si më poshtë: 1.1. Marrëveshja me BEI për Projektin "Infrastruktura Ujore Bashkiake Stacioni i trajtimit të ujërave të ndotura" UK SHA Sarandë ka detyrimin ndaj MFE në shumën 1,668,815 euro si dhe penalitete në **shumën 141,223.38 euro e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë,** si pasojë e mos likuidimit në kohë të detyrimeve të parashikuara në akt marrëveshjet nën huaje. 1.2. Marrëveshja me IDA për Projektin "Projekti Bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime" ka detyrimin ndaj MFE në shumën 2,304,419 USD. 1.3. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake I" UK SHA Sarandë ka detyrimin ndaj MFE në shumën 144,959 euro. 1.4. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake II" UK SHA Sarandë nuk ka detyrim ndaj MFE mbi këtë akt marrëveshje nën huaje.	Pika 5	E Lartë	Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për analizimin e detyrimeve që janë krijuar ndër vite referuar akt marrëveshjeve të nën huas të lidhura me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si pasojë e paaftësisë paguese për shlyerjen e kredive, ku t'i bëjë me dije ministrisë situatën e vështirë ekonomike financiare të institucionit për zgjidhjen e kësaj problematike me qëllim shmangien e penaliteteve të cilat lindin si pasojë e mos likujdimit në kohë të këtyre kredive.

3	Nga auditimi i dokumentacionit mbi organizimin e strukturës organizative të aplikuara për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë të miratuara respektivisht me Vendimin nr. 15/2, datë 20.12.2017 dhe nr. 3, datë 24.02.2020, të Këshillit të Administrimit me numër 170 punonjës për secilin vendim sa më sipër konstatohet se, është tejkaluar numri i fuqisë punëtore në total me 116 punonjës përgjatë periudhës objekt auditimi konkretisht: për vitin 2019 me 41 punonjës, për vitin 2020 me 13 punonjës dhe për vitin 2021 me 62 punonjës. Shuma e likuiduar për punonjësit mbi strukturën e miratuar është **3,264,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.** Ky efekt ka ardhur si pasojë e punësimeve të reja por edhe të punonjësve me kontrata tre mujore të cilat janë kryer nga Administratori i Shoqërisë sipas vendimeve përkatëse. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masat e duhura për bashkërendimin e punës mbi zbatimin e strukturës së miratuar mbi të cilën nuk duhej të kalohej numri total i punonjësve, gjithashtu ndërmjet tyre nuk rezulton të ketë patur një komunikim të vazhdueshëm gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj në punë me qëllim marrjen e masave të duhura për respektimin e numrit total të punonjësve të miratuar në strukturën organizative, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 8, pika 1, pika 8, germa "d", neni 11, pika 1, dhe strukturës organizative të miratuar respektivisht me Vendimin nr. 15/2, datë 20.12.2017, dhe nr. 3, datë 24.02.2020, të Këshillit të Administrimit.	Pika 4	E lartë	-Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura që, emërimi i punonjësve të rinj, lëvizja dhe qarkullimi i tyre të bëhet në sinergji me Zyrën e Burimeve Njerëzore, duke marrë informacion të vazhdueshëm në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator të rekrutimeve në punë. -Nga Administratori i Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masat e duhura që, në të ardhmen të respektohet numri i të punësuarve sipas strukturës së miratuar dhe legjislacionit në fuqi, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet.
4.	Kontrata e punimeve civile "Ndërtim i kanalizimeve të ujërave të zeza në Bllokun mbi rrugën nr.5, Lagje nr. 3, Sarandë", është nënshkruar me nr. 590 prot., datë 03.12.2020, me Kontraktorin "JV I. G. & 2. K.", me vlerë 31,821,600 lekë. Referuar dokumentacionit të dosjes teknike, në shtresën e betonit e cila është vendosur në rrugë, verifikuar vetëm në dy seksione anash shtresës së betonit, është vendosur zgarë hekuri me dimensione të hekurit 3-5 mm, me kuadratë (plegma) 15 cm x 15 cm. Në lidhje me realizimin e	Pika 7	E lartë	UK SHA Sarandë, të ngrejë një komision të veçantë për analizimin e kostos së tombinove rrethore të vendosura nga kontraktori duke reflektuar diferencën në vlerë krahasuar me tombinot e projektuara dhe vlera e diferencës të zbritet nga vlera e

	pusetave si më sipër, ishte parashikuar që ato të ndërtoheshin me formë drejtkëndore me beton të derdhur në objekt. Nga verifikimi në terren rezulton që ato janë vendosur të parapërgatitura si dhe në formë rrethore.			garancisë së kontratës së punimeve të bashkimit të operatorëve "JV I. G. & 2. K." SHPK. Po ashtu, të verifikohet dimensioni i zgarave të vendosura në shtresën e betonit.
5	Kontrata "Ndërtim stacioni i ri pus-çpimi në Vrion dhe lidhja me rrjetin kryesor transmetues", është nënshkruar me nr. 442 prot., datë 20.10.2020, me Kontraktorin "M./S" SHPK, me vlerë 9,404,900 lekë pa TVSH. Bazuar në dokumentacionin përkatës rezulton se për zërin b.1.14 "Pjesë speciale çeliku, Ø ~ 200 mm", është preventivuar dhe certifikuar sasia 950 kg. Në librezën e masave nuk është detajuar kjo sasi sipas elementëve përkatës, për përcaktimin e saktë të peshës. Nga verifikimi i disa zërave të punimeve në objekt, rezulton se për vendosjen e tubacionit Ø ~ 200 mm, janë parashikuar: - F.V brryl 90^0, 45^0 Ø – 200 mm. - F.V saraçineska çeliku me fllanxha Ø – 200. - F.V Valvula moskthimi Ø – 200. - F.V distancor. - F.V Nyje bashkuese. - F.V ventila çeliku me fllanxha (shkarkues + kontroll). I vetmi element i cili konsiderohet pjesë speciale çeliku, janë dado bullonet të cilat janë përdorur për lidhjen e fllanxhave, të cilët janë në sasi 48 copë me peshë 50 kg. Sasia 900 kg është certifikuar pa përcaktuar se cilëve elementë i përkasin. ***Vlera 270,000 lekë*** (900 kg x 300 lekë/kg) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik. Nga verifikimi i disa zërave të punimeve rezulton se është vendosur tubacion Ø – 200, në sasinë 28 ml ose 1,078 kg (3 ml është i pa vendosur, por gjendje në objekt). Sasia e certifikuar për këtë zë punimi është 43 ml, ose me peshë 1667.1 kg, nga ku rezulton diferenca 15 ml, ose 589 kg. ***Vlera 176,700 lekë*** (589 kg x 300 lekë/kg), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori M./S SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Në sheshin e stacionit të pompimit (pusit të çpimit), janë realizuar punime të shtrimit me çakëll, punime	Pika 7	E lartë	UK SHA Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **446,000 lekë**, nga Kontraktori "M./S" SHPK, për punime të likuiduara port të pa realizuara.

	të cilat pretendohet se janë realizuar nga kontraktori. Nga verifikimi i dokumentacionit, nuk rezulton i reflektuar në ndonjë dokument realizimi i një procesi të tillë. Po ashtu, sa i përket lidhjes së tubacionit me ankerat e betonit, janë vendosur profile metalike, të cilat nuk përbëjnë pjesë speciale çeliku. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 8.2 dhe 8.3.			

I. 3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit.

Nga auditimi i kryer pranë UK Sarandë, për periudhën 01.01.2019 deri datë 31.12.2021, lidhur me përputhshmërinë, rezultoi se:
Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, në përgjithësi ka zbatuar kuadrin rregullator, por janë konstatuar edhe shmangie të cilat kanë ndikuar në përformancën financiare të shoqërisë. Nuk ndiqen si duhet marrëdhëniet me punonjësit sa i takon kontratës kolektive të punës, procesi i rekrutimit nuk bëhet duke përcaktuar kritere të qarta si dhe niveli i pagave nuk miratohet në asamblenë e aksionarit. Detyrimet afatshkurtra kanë tendencë rritje, kryesisht për pagesat e energjisë elektrike, por edhe ndaj operatorëve ekonomikë, efektet e të cilave do të vështirësojnë më tej performancën fnanciare.
Nga ana e shoqërisë nuk hartohen programe ekonomike afatmesme apo afatgjata, për pëmirësimin e performancës së shoqërisë.
Likuidimet realizohen me mungesë dokumentacioni dhe kontrolli i brendshëm nuk është në nivelin e duhur sa i takon qarkullimit të bazës materiale, shpenzimit të karburanteve etj. Ka mangësi në proceset e prokurimit, për realizimin e tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.
Shoqëria ka krijuar detyrime për mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE deri më datë 31.12.2021, me vlerë 114,177,290.87 lekë si dhe kamatëvonesat mbi këtë detyrim me vlerë 101,626,174.54 lekë, e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e UK SHA Sarandë.
Shoqëria është penalizuar me 141,223.38 Euro, si pasojë e mos likuidimit në kohë të detyrime të parashikuara në akt marrëveshjet e nën huasë, për realizim investimesh me financim të huaj..
Ka tejkalim të numrit të punonjësve shoqëruar me efekt negativ financiar me vlerë 3,264,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e UK SHA Sarandë.
Në zbatimin e kontratave të punimeve civile janë konstatuar punime të likuiduara por të pa realizuara me dëm ekonomik me vlerë 486,000 lekë.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinion për auditimin e përputhshmërisë:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të UK SHA Sarandë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

"Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e UK SHA Sarandë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale në raste të kufizuara dhe jo të përhapura, që justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar[1] të përputhshmërisë.

II. Baza për opinionin e përputhshmërinë.

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit "Ujësjellës Kanalizime" SHA Sarandë në zbatim të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" , ISSAI 4000[2] dhe ISSAI 100, paragrafi 42.

Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet ISSAI-P1, "Deklarata e Limës"; ISSAI P-10, "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe ISSAI P-12, ISSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Në i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së.

Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga UK SHA Sarandë dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Në besojmë së dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur gjithashtu mbi gjykimin profesional të audituesit. Gjithashtu, në besojmë së dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Shoqëria ka krijuar detyrime për mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE deri më datë 31.12.2021, me vlerë 114,177,290.87 lekë si dhe kamatëvonesat mbi këtë detyrim me vlerë 101,626,174.54 lekë, e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e UK SHA Sarandë. Shoqëria është penalizuar me 141,223.38 Euro, si pasojë e mos likuidimit në kohë të detyrime të parashikuara në akt marrëveshjet e nën huasë, për realizim investimesh me financim të huaj..

Ka tejkalim të numrit të punonjësve shoqëruar me efekt negativ financiar me vlerë 3,264,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e UK SHA Sarandë.

Në zbatimin e kontratave të punimeve civile janë konstatuar punime të likuiduara por të pa realizuara me dëm ekonomik me vlerë 486,000 lekë.

[1] Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti i një çështje nuk është aq material sa të justifikojë dhënien e një opinioni të kundërt

[2] ISSAI 4000-Udhërrëfyesi i Auditimit të Përputhshmërisë

III. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:
Menaxhimi i UK SHA Sarandë është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatorë në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për hartimin dhe miratimin e buxhetit dhe të pasqyrave të llogaridhënies vjetore në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm efektiv, për të mundësuar përgatitjen e tyre pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

IV. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:
Përgjegjësia e auditimit është të shprehë një opinion bazuar në rezultatet e auditimit të kryer, për të marrë *siguri të arsyeshme*, që veprimtaria e UK SHA Sarandë, në të gjitha aspektet, është pa gabime dhe anomali materiale. Audituesit e KLSH-së nëpërmjet auditimit të realizuar në këtë institucion krijuan bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), Objektivi ynë lidhet me *dhënien e sigurisë së arsyeshme* mbi përputhshmërinë e aktivitetit të UK SHA Sarandë, me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara, administrative si dhe mbi përdorimin e duhur dhe efecient të burimeve financiare e administrative të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Për këtë audituesit e KLSH, aplikojnë gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese nëpërmjet të cilës, audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme që trajtohen në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 *"Për organizimin dhe funksionimin e KLSH"*, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 384/1 prot., datë 29.04.2022, nga data 04.05.2022 deri më datë 01.07.2022, në subjektin Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë (UK SHA Sarandë), për periudhën nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2021, u krye auditimi *"Mbi Përputhshmërinë"* nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. A. T., Përgjegjës grupi
2. M. H., auditues
3. E. K., auditues
4. K. G., auditues

1. Objekti i auditimit: Auditim mbi "Përputhshmërinë" në UK SHA Sarandë, periudhën e aktivitetit nga data 01.01.2019 deri më datë 31.12.2021.

2. Qëllimi i auditimit: Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse UK SHA Sarandë, në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë *(sipas ISSAI 400, p 18).*

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e proceseve dhe aktiviteteve të institucionit.

3. Identifikimi i çështjes: Raporti Përfundimtar mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të UK Sarandë për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2021, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

Zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Zbatimin i ligjshmërisë për emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese (Këshilli i Administrimit dhe Administratori).

Hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë.

Zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Rregullshmëria e shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).

Mbajtja e evidencave kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.

Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen e zbatimin e kontratave.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për

garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.
Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.
Strukturat drejtuese, duhet të orientojnë strukturat e institucionit, për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet.
5. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit e KLSH janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.
6. Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Ligji nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura"; Ligji Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i procedurës civile në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në RSH", të ndryshuar me ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014; Ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, si dhe akte të tjera të fushës së ndërtimit dhe urbanistikës; VKM nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"; VKM nr. 870 datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit" i ndryshuar; VKM nr. 864, date 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë"; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", VKM nr. 918 datë 29.12.2014 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike"; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e modelit të rregullores 'Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjellës kanalizimeve SHA'"; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik"; Rregullorja e brendshme dhe rregullore të tjera të funksionimit të institucionit, etj.
7. Standardet e auditimit: Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të

Auditimit në KLSH, mbështetur në:
- Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
-Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

8. Metodat e auditimit: Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e UK SHA Sarandë, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti.

9. Dokumentimi i auditimit: Auditimi është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI),për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.

Aktiviteti kryesor i Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë është shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm për konsumatorët dhe shitja e tij, mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe të impianteve të pastrimit të tyre, forcimi i marrëdhënieve me konsumatorët. UK SHA Sarandë është përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin, rinovimin dhe modifikimin e sistemit të furnizimit me ujë, furnizimin me ujë të konsumatorit në mënyrë të vazhdueshme gjate 24 orëve të çdo dite të vitit sipas standardeve në fuqi të cilësisë së ujit. Në rast se Operatori nuk mund ta ofrojë këtë shërbim, atëherë duhet të marrë masa që të ofrojë shërbimin më të mirë të mundshëm. Në këtë rast Operatori duhet të njoftojë Konsumatorin për orët e furnizimit me ujë, në mënyrë që Konsumatori të marrë masa për të përballuar mungesat e përkohshme. Gjithashtu, UK SHA Sarandë është përgjegjës për administrimin e sistemit të furnizimit me ujë deri tek pika e lidhjes, largimin e disiplinuar të ujërave të ndotura që gjenerohen në pronën e konsumatorit dhe që lidhet me sistemin e kanalizimeve në zonën e shërbimit të Operatorit, si dhe trajtimin e tyre përpara shkarkimit në trupën ujore pritëse (në rast se zona e shërbimit është e pajisur me impiant trajtimi), mirëmbajtjen e elementeve përbërës të sistemit të kanalizimit të ujërave të ndotura, operimin dhe mirëmbajtjen e impiantit të trajtimit të ujërave të

ndotura, administrimin e sistemit të kanalizimeve të ujërave të ndotur nga pika e shkarkimit te ujërave te ndotura deri tek vepra e shkarkimit në trupën ujore pritëse.
Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria aktivitetit të subjektit për periudhën nga 01.01.2019 deri më datë 31.12.2021.
Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, vendimmarrja e arganeve drejtuese të shoqërisë, planifikimi dhe realizimi i programit ekonomiko-financiar, pasqyrat financiare, shpenzime për investime, shpenzimet operative, realizimi i prokurimeve dhe kontratave përkatëse, etj.

III.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:
Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III.2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
Nga auditimi konstatohet që:

1. Titulli i gjetjes:	Mos respektim afati për zbatim rekomandimesh
Situata:	Nga Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë nuk është respektuar afati 20 ditor nga data e njoftimit të Raportit të Auditimit, në lidhje me raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.
Kriteri:	Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa "j".
Ndikimi:	Nga ana e UK SHA Sarandë është raportuar për ndjekjen e zbatimin e rekomandimeve në përfundim të periudhës 6 mujore.
Shkaku	Mos respektimi i ligjit organic të KLSH.
Rëndësia:	E ulët.
1.1 Rekomandimi:	UK SHA Sarandë, të marrë masa për njoftimin e KLSH mbi planin e masave që hartohet për zbatimin e rekomandimeve të lënë, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të shoqërisë.

Sa i përket masave organizarive, situata paraqitet si më poshtë
Janë në proces zbatimi rekomandimet nr. 1.1, 1.2, 2.1, 2.2, 5.1, 7.1, 15.1, 16.1, 19.1, 24.1, 29.1, 29.2, 30.1, 30.2, 34.1, 35.1, 37.1. Janë zbatuar pjesërisht rekomandimet nr. 6.1 dhe 11.1, si dhe nuk janë zbatuar rekomandimet si më poshtë:
Rekomandimi 12.1: Administratori dhe Këshilli i Administrimit i UKS SHA Sarandë, duhet të marrin masa të menjëhershme, për përcaktimin e klasave sipas pozicioneve të punës, nivelit të

pagave sipas klasave, shqyrtimin dhe miratimin e tyre në Këshillin e Administrimit si dhe miratimin e tyre nga Asambleja e Përgjithshme.
Rekomandimi 17.1: Përgjegjësja e Zyrës së Financës të marrë masa të menjëhershme, për dokumentimin e veprimeve të kryera me bankë në dy aspekte, konkretisht: dokumentacionin autorizues dhe dokumentacionin justifikues të shpenzimeve, duke bashkëngjitur dokumentacionit origjinal për çdo transaksion të kryer.
Rekomandimi 23.1: Zyra e Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin e duhur (origjinal/ose fotokopje të noterizuara), inventarizimin e tyre, si dhe indeksimin e tyre sipas regjistrit të personelit.
Rekomandimi 23.1: Administratori dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa të menjëhershme për plotësimin e kontratave individuale të punës me të gjithë elementët e duhur për sa i përket pagës së punonjësve.
Rekomandimi 25.1: Administratori dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e praktikave të tilla dhe zbatimin e nivelit të njëjtë të pagave për pozicione të njëjta pune.
Rekomandimi 26.1: Administratori, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Financës të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin e drejtë të pagës bazë, mbi të cilën do të përllogariten elementët shtesë (pagës bruto) dhe mbi këtë elementët pakësues (paga neto).
Rekomandimi 36.1.1: UKS SHA, si Autoritet Kontraktor duhet të marrë masa, për ndërprerjen e praktikave të copëzimit të fondeve, në rast të prokurimit të mallrave apo grup mallrave të së njëjtës natyrë, të shërbimeve apo punëve publike, me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me fondin limit të përllogaritur për to dhe kufijtë monetarë të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.

Sa i përket masave shpërblim dëmi situata paraqitet si më poshtë:
Rekomandimi 1.1: Administratori i UKS SHA, Zyra e Financës marrë masa për zhdëmtimin nga secili prej përdoruesve të mjetit (sipas aneksit bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit pas përllogaritjes së vlerës në lekë sipas çmimit përkatës), të sasisë së karburantit prej 2745 litra, afërsisht në vlerën 378,810 lekë, të pajustifikuar me dokumentacionin përkatës.
Rekomandimi 1.2: Administratori i UKS SHA, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Administrimit në bashkëpunim me Zyrën e Financës, të marrë masa për arkëtimin e vlerës së shpërblimeve të përfituar padrejtësisht, për pjesëmarrje në mbledhjet e KA, nga anëtarët e tij, përkatësisht z. S. K në shumën 123,760 lekë dhe z. A. L në shumën 70,720 lekë.
Ndërsa është në proces zbatimi rekomandimi 3.1: Autoriteti Kontraktor UKS SHA, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 60,169 lekë, të cilësuar si dëm ekonomik, për shkak të zbatimit me vonesë të kontratës nga OE dhe mos aplikimit të penaliteteve për këtë vlerë nga Autoriteti Kontraktor.

Sa i përket masave për eliminimin e efektieve negative nuk është realizuar asnjëri nga dy rekomandimet e lëna si më poshtë:
Rekomandimi 1.1: Administratori i UKS, të marrë masa të menjëhershme që të rishikojë nevojat për staf (punonjës) si dhe të plotësojë strukturën organizative të UKS në përputhje me këto nevoja dhe të miratojë numrin e punonjësve në organet drejtuese të UKS SHA.
Rekomandimi 1.2: UKS SHA, si Autoritet Kontraktor, të marrë masa për negocimin e afatit të zbatimit të kontratës së "Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit", deri më 26.07.2019, duke

përllogaritur fillimin e periudhës 1 vjeçare të mirëmbajtjes, nga data 26.07.2018, e dorëzimit të përmirësimit të sistemit nga operatori ekonomik "I. S" SHPK.

Sa i përket masave disiplinore, situata paraqitet si më poshtë:
Nuk është zbatuar masa disiplinore "Vërejtje me paralajmërim"për administratorin.
Është zbatuar rekomandimi "Vërejtje me paralajmërim për znj. U. Sh., Zh. M.
Është zbatuar rekomandimi "Vërejtje me shkrim", për z. V. G., z. Z. K., znj. E. G., znj. A. V., z E. R. dhe znj. A. B..

2. Titulli i gjetjes:	Janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve, por jo të plota.
Situata:	Në auditimin e kaluar, janë rekomanduar 43 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 16, zbatuar pjesërisht 2, në proces zbatimi 18 dhe të pa realizuara 7. Janë rekomanduar 5 masa shpërblim dëmi, nga të cilat janë zbatuar 2, një është në proces zbatimi dhe 2 nuk janë zbatuar. Janë rekomanduar 4 masa për eliminimin e efekteve negative, nga të cilat janë zbatuar 2 dhe nuk janë zbatuar 2. Janë rekomanduar 9 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 8 dhe nuk është zbatuar 1.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa "j".
Efekti/Ndikimi:	Realizimi i rekomandimeve përmirëson situatën e UK SHA Sarandë.
Shkaku	Nga ana e shoqërisë ka patur përpjekje për realizimin e rekomandimeve, por nuk ka arritur t'i realizojë plotësisht.
Rëndësia:	E Mesme.
2.1 Rekomandimi:	UK SHA Sarandë, të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim përmirësimin e situatës dhe rritjen e **performancës** së shoqërisë.

III.2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionin e strukturave drejtuese (Këshilli i Administrimit dhe Administratori).

Për periudhën objekt auditimi 2019, 2020, 2021 nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Strukturave Drejtuese (Këshilli i Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua se Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë është emëruar dhe është pjesë përbërëse e Këshillit të Administrimit me të drejtë vote. *Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar,* më konkretisht në Kreun II, *Këshilli i Administrimit,* sistemi me një nivel, Neni 155, *Numri, Emërimi dhe përbërja e Këshillit të Administrimit,* Pika 1, *Këshilli i Administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratorët e shoqërisë.* Gjithashtu veprimi i mësipërme bie në kundërshtim edhe me Nenin 156, *Zgjedhshmëria e kufizuar,* Pika 2, *"Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i Këshillit të Administrimit, nëse ai, njëkohësisht, është",* Germa b, *"është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë".*

Pra siç shprehet qartë në ligj Administratori nuk mund të jetë pjesë përbërëse e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë.

Për vitin 2019 Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, përbëhet nga 3 anëtarë: z. *Sh. L., Kryetar i Këshillit të Administrimit dhe Administrator i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, z. S. K., Zv. Kryetar i Këshillit të Administrimit dhe z. D. B., anëtar i Këshillit të Administrimit.*

Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, për vitin 2019 ka marrë në total 4 vendime.

1. Titulli i gjetjes:	Mos realizimi i mbledhjeve sipas kerkesave.
Situata:	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Regjistri për pjesëmarrjen në mbledhje të anëtarëve të Këshillit të Administrimit) për Këshillin e Administrimit dhe Administratori, konstatohet se anëtaret nuk janë mbledhur të paktën 1 (një) herë në muaj.
Kriteri:	VKM nr. 63, date 27/01/2016, Neni 14, Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit, Pika 1.
Ndikimi:	Vonesa në shqyrtimin e dokumentacionit, për aktivitetin e shoqërisë.
Shkaku	Mos respektimi i akteve nënligjore.
Rëndësia:	E mesme.
1.1 Rekomandimi:	Këshilli i administrimit të marrë masa për zhvillimin e mbledhjeve, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.

Për vitin 2020 Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, përbëhet nga z. *K. K., Kryetar i Këshillit të Administrimit, z. E. Gj., Zv. Kryetar i Këshillit të Administrimit dhe z. Sh. L., anëtar i Këshillit të Administrimit dhe Administrator i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë.*

Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, për vitin 2020 ka marrë në total 30 vendime.

Për vitin 2021 Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, përbëhet nga z. *K. K., Kryetar i Këshillit të Administrimit, z. E. Gj., Zv. Kryetar i Këshillit të Administrimit dhe z. Sh. L., anëtar i Këshillit të Administrimit dhe Administrator i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë.*
Këshilli Administrativ i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë për vitin 2021 janë marrë në total 12 vendime.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Strukturave Drejtuese për vitin 2020, nuk u konstatuan mangësi në mbajtjen e dokumentacionit dhe as parregullsi në vendimet e marra për këtë vit.

2. Titulli i gjetjes:	Emërim në kundërshtim me ligjin
Situata:	Për vitet 2019-2021 periudhë auditimi, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Strukturave Drejtuese (Këshilli *i Administrimit dhe Administratori),* vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua se Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë është emëruar dhe është pjesë përbërëse e Këshillit të Administrimit me të drejte vote.
Kriteri:	Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008**,** "Për tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Kreun II, Këshilli i Administrimit, sistemi me një nivel, Neni 155, Numri, Emërimi dhe përbërja e Këshillit të Administrimit, Pika 1, Këshilli i Administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratorët e shoqërisë. Gjithashtu veprimi i mësipërm bie në kundërshtim edhe me Nenin 156, Zgjedhshmëria e kufizuar, Pika 2, "Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i Këshillit të Administrimit, nëse ai, njëkohësisht, është", Germa b, "është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë".
Ndikimi:	Ka ndikim në vendimmarrje.
Shkaku	Mos respektimi i akteve ligjore.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Këshilli i administrimit të marrë masa duke i kërkuar aksionarit emërimin e anëtarëve në përputhje me përcaktimet ligjore.

III.2.3. Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiar të shoqërisë.

Këshilli i Administrimit të Shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Sarandë" SHA ka marrë vendimet e mëposhtme për sa i përket planeve të biznesit:

Vendimi nr. 2 datë 24.02.2020 për miratimin e Plan Biznesit të Shoqërisë të vitit 2020;

Vendim nr. 7 datë 24.03.2020 për miratimin e Plan Biznesit 2019-2023;

Vendim nr. 18/1 datë 29.07.2020 për miratimin e Plan Biznesit 2020-2024 si dhe

Vendim nr. 12 datë 30.12.2021 për miratimin e Planit Biznesit për vitin 2022.

Tabela nr. 1 *(në lekë)*

	2019			2020			2021		
Të Ardhura	**Plan**	**Fakt**	**Ndryshimi**	**Plan**	**Fakt**	**Ndryshimi**	**Plan**	**Fakt**	**Ndryshimi**
Shitje Uji	121,731,533	24,192,726	2,461,193	143,567,362	99,981,062	(43,586,300)	154,071,931	136,805,464	(17,266,467)
Shitje Uji Shumica	1,653,450	5,449,350	3,795,900	14,235,000	11,196,600	(3,038,400)	14,235,000	10,750,500	(3,484,500)
Kanalizime	29,676,501	25,213,707	(4,462,794)	43,514,643	21,224,426	(22,290,217)	43,182,099	28,959,833	(14,222,266)
Tarifë Shërbimi	34,752,984	36,464,526	1,711,542	45,502,400	36,053,681	(9,448,719	46,050,400	43,083,935	(2,966,465)
Operacionale	**187,814,468**	**191,320,309**	**3,505,841**	**246,819,405**	**168,455,769**	**(78,363,636)**	**257,539,430**	**219,599,732**	**(37,939,698)**
Pike Lidhje		5,437,631	5,437,631		3,788,375	3,788,375		6,699,439	6,699,439
Shitje Matëse	5,065,564	4,845,345	(220,219)	13,542,552	553,861	(12,988,691)	13,568,156	152,518	(13,415,638)
Lidhje Kontrata		185,600	185,601		104,333	104,333		127,500	127,500
Shitje Libreza		121,633	121,633		33,966	33,966		72,708	72,708
Pastrim Grope		32,730	32,730		36,600	36,600		36,000	36,000
Leje Ndërtimi		83,332	83,332		16,666	16,666			0
Nga Facilitete	**5,065,564**	**10,706,271**	**5,640,708**	**13,542,552**	**4,533,801**	**(9,008,751)**	**13,568,156**	**7,088,165**	**(6,479,991)**
Tot .Operacionale	**92,880,032**	**202,026,580**	**9,146,549**	**260,361,957**	**172,989,570**	**(87,372,387)**	**271,107,586**	**226,687,897**	**(44,419,689)**
Interesa Bankare		795	795		3,895	3,895		35,748	35,748
Amortizim Grande		36,037,305	36,037,305		57,973,914	57,973,914		25,839,252	25,839,252
5% si Agjent Tat		3,785,241	3,785,241		5,119,374	5,119,374		5,064,494	5,064,494
Diferenca Kursi		18,594,798	18,594,798		7,060,805	7,060,805		17,417,336	17,417,336
Gjoba		190,000	190,000		30,000	30,000		17,000	17,000
Sbvecione		936,000	936,000		287,950	287,950		7,542,022	7,542,022
Rimarje Amortiz		36,947,176	36,947,176		78,059	78,059			0
Jo Operacionale	**-**	**96,491,315**	**96,491,315**	**0**	**70,553,997**	**70,553,997**	**0**	**55,915,852**	**55,915,852**
Grand Total	**192,880,032**	**298,517,895**	**105,637,864**	**260,361,957**	**243,543,567**	**(16,818,390)**	**271,107,586**	**282,603,748**	**11,496,162**

Burimi: UK SHA Sarandë

-Totali i të ardhurave që u parashikuan për vitin 2019 ishin *192,880,032 lekë* ku ndahen në të ardhura operacionale në vlerën *192,880,032 lekë* dhe në të ardhura të tjera jo operacionale në vlerën *0 lekë*. Totali i të ardhurave faktike janë në vlerën *298,517,895 lekë*, pra në tepricë *105,637,863 lekë* nga ato që ishin parashikuar të ndara në të ardhura operacionale në vlerën *202,026,580 lekë* dhe të ardhura të tjera jo operacionale prej *96,491,315 lekë*.

-Totali i të ardhurave që u parashikuan për vitin 2020 ishin *260,361,957 lekë* ku ndahen në të ardhura operacionale në vlerën *260,361,957 lekë* dhe në të ardhura të tjera jo operacionale në vlerën *0 lekë*. Totali i të ardhurave faktike janë në vlerën *243,543,567 lekë*, pra në mungesë prej *16,818,390 lekë* ose *93,5%* nga ato që ishin parashikuar të ndara në të ardhura operacionale në vlerën *172,989,570 lekë* dhe të ardhura të tjera jo operacionale prej *70,553,997 lekë.*

-Totali i të ardhurave që u parashikuan për vitin 2021 ishin *271,107,586 lekë* ku ndahen në të ardhura operacionale në vlerën *271,107,586 lekë* dhe në të ardhura jo operacionale në vlerën *0 lekë*. Totali i të ardhurave faktike janë në vlerën *282,603,748 lekë*, pra në tepricë prej 11,496,162 lekë nga ato që ishin parashikuar të ndara në të ardhura operacionale në vlerën *226,687,896 lekë* dhe të ardhura të tjera jo operacionale prej *55,915,851 lekë.*

Tabela nr. 2 *(në lekë)*

Emërtimi	**2019**			**2020**			**2021**		
	Plan 2019-23	**Realizimi**	**Ndryshimi**	**Plan 2020-24**	**Realizimi**	**Ndryshimi**	**Plan 2020-24**	**Realizimi**	**Ndryshimi**
Shpenzime Materiale	11,869,092	13,470,026	(1,600,934)	15,649,374	17,840,796	(2,191,422)	15,962,356	17,251,856	(1,289,500)
Shpenzime Energji	54,410,328	49,784,112	4,626,216	50,995,703	53,559,401	(2,563,698)	50,286,504	72,911,872	(22,625,368)
Paga	67,920,000	67,436,736	483,264	68,469,604	66,005,281	2,464,323	71,208,388	74,706,796	(3,498,408)
Ushqim	13,040,640	13,057,200	(16,560)	12,934,689	12,946,800	(12,111)	13,452,076	13,590,500	(138,424)

Shpërblim	5,705,280	1,681,380	4,023,900	1,660,000	308,000	1,352,000	1,660,000	1,099,000	561,000
Sigurime Shoqërore	11,342,640	13,450,259	(2,107,619)	11,156,268	13,189,597	(2,033,329)	11,602,519	15,727,485	(4,124,966)
1% Përndjekur Politike	679,200	684,354	(5,154)	684,696	660,053	24,643	712,084	735,831	(23,747)
Kontrata Shërbime	7,039,595	6,432,748	606,847	9,517,434	4,714,278	4,803,156	9,709,153	6,027,930	3,681,223
Shpenzime Qira	215,002	557,635	(342,633)	568,788	563,000	5,788	580,164	556,333	23,831
Mirembajtje	8,656,280	10,297,810	(1,641,530)	7,575,032	12,515,659	(4,940,627)	7,726,534	20,762,723	(13,036,189)
Page K/Administrimit	930,000	685,761	244,239	699,476	822,560	(123,084)	713,466	498,160	215,306
Pune Publike								5,611,301.00	(5,611,301)
Shpenzime Operative	**181,808,057**	**177,538,021**	**4,270,036**	**179,911,064**	**183,125,425**	**(3,214,361)**	**183,613,244**	**223,868,487**	**(40,255,243)**
Mos Arkëtim Debitore		1,544,580	(1,544,580)		1,539,859	(1,539,859)		1,798,328	(1,798,328)
Interesa Kredie		10,484,791	(10,484,791)	11,092,183	11,354,054	(261,871)	13,092,183	10,587,116	2,505,067
Amortizimi		93,404,770	(93,404,770)	158,667,832	88,226,070	70,441,762	140,221,669	85,859,092	54,362,577
Taxa Lokale,		5,567,403	(5,567,403)	5,576,761	2,037,283	3,539,478	5,688,296	2,117,272	3,571,024
Diff Kursi Komis		250,515	(250,515)		11,831,906	(11,831,906)		-	
Shpenz Jo Operative	**-**	**111,252,059**	**(111,252,059)**	**175,336,776**	**114,989,172**	**60,347,604**	**159,002,148**	**100,361,808**	**58,640,340**
Grand Total	**181,808,057**	**288,790,080**	**(106,982,023)**	**355,247,840**	**298,114,597**	**57,133,243**	**342,615,392**	**324,230,295**	**18,385,097**
	Ardhurat	**298,517,896**		**Ardhurat**	**243,543,567**		**Ardhurat**	**282,603,748**	
	Rezultati	**9,727,816**		**Rezultati**	**(54,571,030)**		**Rezultati**	**41,626,547**	

Burimi: UK SHA Sarandë

-Shpenzimet e parashikuara për vitin 2019 ishin në shumën *181,808,057 lekë* të ndara në shpenzime operative në vlerën *181,808,057 lekë* dhe në shpenzime jo operative në shumën *0* lekë. Shpenzimet e realizuara ishin në shumën *288,790,080 lekë* të ndara në shpenzime operative në shumën *177,538,021 lekë* dhe në shpenzime jo operative në shumën *111,252,059 lekë* me një diferencë prej *106,982,023 lekë* më shumë se nga ato që ishin parashikuar.

-Shpenzimet e parashikuara për vitin 2020 ishin në shumën *355,247,840 lekë* të ndara në shpenzime operative në shumën *179,911,064 lekë* dhe në shpenzime jo operative në shumën *17,336,776 lekë*. Shpenzimet e realizuara ishin në shumën *298,114,597 lekë* të ndara në shpenzime operative në shumën *183,125,425 lekë* dhe në shpenzime jo operative në shumën *114,989,172 lekë* me një diferencë prej *57,133,243 lekë* më pakë se nga ato që ishin parashikuar.

-Shpenzimet e parashikuara për vitin 2021 ishin në shumën *342,615,392 lekë* të ndara në shpenzime operative në shumën *183,613,244 lekë* dhe në shpenzime jo operative në shumën *159,002,148 lekë.* Shpenzimet e realizuara ishin në shumën *324,230,295 lekë* të ndara në shpenzime operative në shumën *223,868,487 lekë* dhe në shpenzime jo operative në shumën *100,361,808 lekë* me një diferencë prej *18,385,097 lekë* më pakë se nga ato që ishin parashikuar

1. Titulli i gjetjes:	Programimi dhe zbatimi i buxhetit për vitin 2019, 2020 dhe 2021,mungesa e një analize të detajuar mbi debitorët dhe gjendjen e likuidimit nga ana e tyre.
Situata:	Shoqëria UK SHA Sarandë nuk ka hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomiko-financiare, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të paparashikuar të cilët për vitet 2019, 2020 dhe 2021, kanë çuar në tejkalim të investimeve dhe të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar, nuk ka bërë një analizë të detajuar të numrit të operatorëve që janë pajisur ose nuk janë pajisur me matës, një analizë të detajuar mbi humbjet teknike ose ato ekonomike menaxheriale, një analizë të detajuar mbi debitorët dhe gjendjen e likuidimit nga ana e tyre. Mungojnë Programet Ekonomike Afatmesme PBA dhe Programet Ekonomike Afatgjata, mungon plani 5 vjeçar për përmirësimin e

	performancës dhe plani i biznesit, mungojnë raportimet mbi zbatimin e buxhetit për çdo tremujor në AKUM.
Kriteri:	Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, VKM-në Nr.848, datë 07.12.2016 si edhe Udhëzimin nr. 15 datë 02.02.2018 "Mbi programet e zhvillimi ekonomik të shoqërive tregtare me kapital Shtetëror".
Ndikimi/efekti:	Në treguesit e gjendjes ekonomike dhe financiare të UKS-së dhe performancën në përgjithësi.
Shkaku	Zbatimi i legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë së programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor, mos zbatimi i kërkesave ligjore për kontabilitetin dhe rritja e detyrimeve kreditore dhe debitore nga viti në vit, dhe mos programimi si zë më vete në buxhet për shlyerjen e tyre.
Rëndësia:	I lartë.
Rekomandimi:	Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Gjithashtu, të merren masat e nevojshme për programimin në buxhetin e vitit ushtrimor, shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar si dhe mbledhja e të gjitha detyrimeve nga ana e debitorëve.

III.2.4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

1. Titulli i gjetjes:	Shoqëria nuk ka rinovuar kontratën kolektive të punës.
Situata:	Për vitet 2019-2021 UK SHA Sarandë nuk ka rinovuar kontratën kolektive të punës me Sindikatën. Në kushte të tilla punonjësit marrëdhëniet e punës me Shoqërinë i rregullojnë vetëm nëpërmjet kontratave individuale të punës. Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve konkretisht në kontratat individuale të punës citohet se, "Punëmarrësi do të përfitojë shpërblimet që i takojnë sipas legjislacionit në fuqi dhe shpërblimet e tjera të përcaktuara në vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë me kontratën kolektive në fuqi". Kontrata kolektive e punës daton prej vitit 2009 me afat vlefshmërie deri në muajin prill të vitit 2012, pra pas vitit 2012 nuk mund të jetë referencë për kontratat individuale të punës. Kontrata kolektive e punës konsiderohet si një marrëveshje me shkrim që ka të bëjë me kushtet e punës lidhur ndërmjet organizatave sindikale dhe punëdhënësve, në bazë të së cilës duhet të lidhen kontratat individuale të punës. Në lidhje me këtë situatë Shoqëria gjatë fillimit të vitit 2022 ka nisur bisedimet me Sindikatën për lidhjen e kontratës së re kolektive të punës por deri më datën 01.07.2022, rezulton se ende nuk është nënshkruar kontrata midis palëve.
Kriteri:	Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 159, 160 dhe 161.
Ndikimi/Efekti:	Mos rinovimi i kontratës kolektive të punës, sjell mos përfaqësimin e punonjësve të Shoqërisë nga Sindikata në marrëdhëniet dypalëshe punëdhënës-punëmarrës.
Shkaku:	Mos implementim i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të merren masa të menjëhershme për rinovimin e kontratës kolektive të punës.

2. Titulli i gjetjes:	Niveli i pagave të Shoqërisë nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare.
Situata:	Niveli i pagave i cili është aplikuar për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Bashkia Sarandë). Organet drejtuese të Shoqërisë e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Në opinionin e grupit të auditimit ka keq interpretim nga organet drejtuese të Shoqërisë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve" i ndryshuar, neni 6, pika 1.
Kriteri:	Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve" i ndryshuar, neni 6, pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Situatë konfuze dhe e paqartë në shpërblimin e punonjësve të Shoqërisë.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore përkatëse.

Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit në të ardhmen të merren masat e duhura për miratimin e nivelit të pagave nga Asambleja Aksionare (Bashkia Sarandë) duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore në mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucionit.

3. Titulli i gjetjes:	Përfshirja e Njësisë së Auditit të Brendshëm në rregulloren e brendshme jo në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
Situata:	Për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë ka funksionuar rregullorja e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit miratuar me Vendimin nr. 12, datë 28.05.2020, të Këshillit të Administrimit. Në nenin 20, të kësaj rregulloreje është përfshirë si strukturë edhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm. Në opinionin e grupit të auditimit kjo strukturë nuk duhet të jetë e përfshirë në rregulloren e brendshme të Shoqërisë edhe pse kjo strukturë është vakante për arsye se në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, neni 3, germa "a", dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"*, pika 1, germa "b", citohet se, *"Një Shoqëri Aksionare duhet të ketë pjesë të strukturës së saj një Njësi të Auditit të Brendshëm në rast se struktura e institucionit ka përgjatë tre viteve të fundit 300 punonjës"*, ndërkohë që strukturat organizative për periudhën objekt auditimi kanë qenë mesatarisht 165-170 punonjës.
Kriteri:	Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", neni 3, germa "a", dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", pika 1, germa "b".
Ndikimi/Efekti:	Nuk ka.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E ulët.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të merren masa për përditësimin e rregullores së brendshme të institucionit duke hequr nga struktura e UK SHA Sarandë Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.

4. Titulli i gjetjes:	Rekrutime punonjësish mbi strukturën e miratuar.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit mbi organizimin e strukturës organizative të aplikuara për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë të miratuara respektivisht me Vendimin nr. 15/2, datë 20.12.2017 dhe nr. 3, datë 24.02.2020, të Këshillit të Administrimit me numër 170 punonjës për secilin vendim sa më sipër konstatohet se, është tejkaluar numri i fuqisë punëtore në total me 116 punonjës përgjatë periudhës objekt auditimi konkretisht: për vitin 2019 me 41 punonjës, për vitin 2020 me 13 punonjës dhe për vitin 2021 me 62 punonjës. Shuma e likuiduar për punonjësit mbi

	strukturën e miratuar është **3,264,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.** Ky efekt ka ardhur si pasojë e punësimeve të reja por edhe të punonjësve me kontrata tre mujore të cilat janë kryer nga Administratori i Shoqërisë sipas vendimeve përkatëse. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masat e duhura për bashkërendimin e punës mbi zbatimin e strukturës së miratuar mbi të cilën nuk duhej të kalohej numri total i punonjësve, gjithashtu ndërmjet tyre nuk rezulton të ketë patur një komunikim të vazhdueshëm gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj në punë me qëllim marrjen e masave të duhura për respektimin e numrit total të punonjësve të miratuar në strukturën organizative.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika 1, pika 8, germa "d", neni 11, pika 1, dhe strukturës organizative të miratuar respektivisht me Vendimin nr. 15/2, datë 20.12.2017, dhe nr. 3, datë 24.02.2020, të Këshillit të Administrimit.
Ndikimi/Efekti:	Efekt negativ financiar në shumën 3,264,000 lekë.
Shkaku:	Tejkalimi i fuqisë punëtore nga struktura organizative e miratuar.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura që, emërimi i punonjësve të rinj, lëvizja dhe qarkullimi i tyre të bëhet në sinergji me Zyrën e Burimeve Njerëzore, duke marrë informacion të vazhdueshëm në përputhje me kuadrin regullativ ligjor të rekrutimeve në punë.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masat e duhura që, në të ardhmen të respektohet numri i fuqisë punëtore në punë në përputhje me strukturën e miratuar dhe legjislacionin në fuqi, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Sh. L. me detyrë Administrator i Shoqërisë dhe znj. U. Sh. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Burimeve Njerëzore.

5. Titulli i gjetjes:	Dhënie e shpërblimeve për punonjësit e Shoqërisë para daljes së rezultatit financiar.
Situata:	Me Vendimin nr. 3, datë 05.03.2021, të Këshillit të Administrimit është miratuar shpërblimi në shumën 4,500 lekë konkretisht për 42 punonjëse në shumën totale 189,000 lekë me rastin e festës së 8 marsit. Me Vendimin nr. 2, datë 25.02.2022, të Këshillit të Administrimit është miratuar shpërblimi në shumën 5,000 lekë konkretisht për 37 punonjëse në shumën totale 185,000 lekë me rastin e festës së 8 marsit. Ndërkohë që Shoqëria ka detyrime për t'u likuiduar referuar kontratave të kredive dhe huave të lidhura me MFE sipas marrëveshjeve me Bankën Evropiane të Investimeve (BEI) dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfŴ), detyrime dhe kamatëvonesa në likuidimin e energjisë elektrike si dhe është me humbje respektivisht për vitin 2020 në shumën 54,571,029.76 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 47,259,026.62 lekë. Gjithashtu VKA është në

	kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve" i ndryshuar, neni 6, pika 1, germa "b". Për arsye se shpërblimi është përfituar para daljes së rezultatit financiar si dhe në kushtet kur Shoqëria ka detyrime për shlyerjen e kredive ndaj MFE por referuar humbjeve sipas periudhave të sipërpërmendura nuk mund të akordojë shpërblim për punonjësit e saj. Në total ky shpërblim është në **shumën 374,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin** UK SHA Sarandë**.**
Kriteri:	Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve" i ndryshuar, neni 6, pika 1, germa "b".
Ndikimi/Efekti:	Efekt negativ financiar në shumën 374,000 lekë.
Shkaku:	Dhënia e shpërblimeve jo në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të marren masa që dhënia e shpërblimeve për punonjësit e saj të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, duke vlerësuar situatën financiare të institucionit me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet.

6. Titulli i gjetjes:	Emërime të punonjësve pa procedurë.
Situata:	Nga auditimi i procesit të rekrutimit të punonjësve nga UK SHA Sarandë konstatohet se, në tre raste janë punësuar punonjës pa procedurë por vetëm me urdhër të Administratorit të Shoqërisë.
Kriteri:	Vendimi nr. 11/1, datë 24.04.2020, i Administratorit të Shoqërisë me objekt "Miratimin e procedurës për rekrutimin e punonjësve".
Ndikimi/Efekti:	Situatë jo transparente mbi procedurat e rekrutimit të punonjësve.
Shkaku:	Mos implementim i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masat e duhura që rastet e emërimeve të reja të kryhen në përputhje me procedurat dhe rregullat e përcaktuara nga vetë institucioni në lidhje me procesin e rekrutimit të punonjësve.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. Sh. L. me detyrë Administrator i Shoqërisë dhe znj. U. Sh. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës e Burimeve Njerëzore.

III.2.5. Mbi rregullshmërinë e shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtime e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).

1. Titulli i gjetjes:	Parregullsi mbi mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit së bankës.
Situata:	Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se: -Në 10 raste bashkëlidhur dokumentacionit në setin e bankës nuk ndodhen urdhër xhirimet e transaksioneve të kryera për likuidimin e shpenzimeve edhe pse likuidimi i tyre vërtetohet nga dokumentacioni i regjistrimit në ditarin e bankës. -Në 20 raste urdhrat për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzimit të mallrave dhe procesverbalet e marrjes së mallrave apo shërbimeve në dorëzim janë të pa protokolluara. -Në 10 raste konstatohen vonesa në likuidimin e operatorëve ekonomikë duke mos respektuar afatet e parashikuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare"*, neni 7. Kjo situatë ka ndodhur përgjatë vitit 2021, ku likuidimi i tyre është kryer përgjatë tre mujorit të parë të vitit 2022. Mos likuidimi në kohë i faturave pjesore apo përfundimtare ndaj operatorëve ekonomikë shkakton risk për krijimin e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë. -Në 20 raste në setin e dokumentacionit justifikues dhe plotësues të bankës, bashkëlidhur nuk ndodhen autorizimi i shpenzimit, urdhra blerje, kontratat e lidhura ndërmjet palëve si dhe faturat tatimore nuk janë origjinale por fotokopje. Kjo situatë ka të bëjë me keq organizimin e mbajtjes së dokumentacionit për veprimet e kryera me bankë, pasi me zgjedhje u kërkua dokumentacioni origjinal (urdhra blerje, fatura tatimore dhe kontrata) dhe u vendosën në dispozicion të grupit të auditimit.
Kriteri:	Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare", neni 7, pika c, germa "i", Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 19, Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 35, germa "b" dhe Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat".
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrimi i rrjedhës dokumentare mbi mbajtjen e dokumentacionit justifikues së veprimet të kryera me bankë si dhe risqe për krijimin e penaliteteve të mundshme.
Shkaku:	Mos implementimi i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga Drejtoria Tregtare të merren masa në të ardhmen për plotësimin dhe sistemimin në mënyrë kronologjike të dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur veprimeve të kryera me bankë në zbatim të përcaktimeve të dispozitave ligjore përkatëse.

Rekomandimi:	Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të marrë masa për likuidimin në kohë të furnitorëve sipas afateve të përcaktuara në kontratat dypalëshe ndërmjet tyre me qëllim shmangien e penaliteteve të mundshme.

2. Titulli i gjetjes:	Nuk ka rregulla të miratuara për monitorimin e procesit të konsumit të karburantit për mjetet e Shoqërisë.
Situata:	Aktiviteti kryesor i UK SHA Sarandë është shërbimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm për konsumatorët dhe shitja e tij, mirëmbajtja e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm, prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura si dhe impianteve të pastrimit të tyre. Për dhënien e këtyre shërbimeve shoqëria ka në dispozicion 23 mjete të cilat janë në gjendje pune të tipeve autovetura, bote uji, skrepa etj.,. Grupi i auditimit me zgjedhje auditoi shpenzimet për konsumin e karburantit për 9 mjete ose në masën 39.1%. Me Vendimin nr. 8/1, datë 24.03.2020, të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar normativat për konsumin e karburantit. Ky vendim nuk përfshin periudhën nga data 01.01.2019, deri më datën 23.03.2020, pra mjetet e shoqërisë nuk kanë pasur normativa të miratuara mbi konsumin e karburantit. Shoqëria për shpërndarjen e karburantit për mjetet e saj realizohet nëpërmjet sistemit të tollonave duke u bazuar në kërkesat apo autorizimet ditore të çdo drejtorie, bëhet dalja nga magazina sipas fletë-daljeve respektive. Referuar procesit të shpërndarjes që aplikon Shoqëria nuk ka një planifikim mujor apo vjetor ku të ketë një plan shpërndarje për çdo sektor, degë apo drejtori. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to, gjithashtu duhet të jetë e evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj.. Këto shpenzime nuk mund të përllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi për mirëmbajtjen e tyre. Shpenzimet për konsumin e karburantit mbahen në dosjen e mjetit nga drejtuesi i automjetit ku pjesë përbërëse e dosjes janë edhe urdhri për përdorimin e mjetit, siguracioni vjetor, leje qarkullimi, kontrolli teknik (kolaudimi për të gjitha mjetet ndodhet vetëm i vitit 2022), kërkesat dhe autorizimi për lëvizjen e mjetit, fletë-dalja nga magazina dhe fletë-udhëtimi. Mbi dokumentacionin justifikues: -Në rubrikën e parë “Fletë-udhëtimi” përcaktohet tipi i mjetit, personi i cili e ka në ngarkim mjetin (shoferi) nënshkruar prej tij, personi autorizues (drejtori, përgjegjësi i sektorit, përgjegjësi i manovrimit sipas rastit)

	nënshkruar prej tij si dhe sasia e tërhequr e karburantit nga magazina sipas datave përkatëse. -Në rubrikën e dytë "Fletë udhëtimi për nevojat e sektorëve" është pasqyruar lëvizja në total mujore për mjetin të nënshkruara nga drejtuesi i mjetit dhe përgjegjësi i sektorit përkatës. Pjesë e kësaj praktike të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 8/1, datë 24.03.2020, janë edhe të dhënat që duhet plotësuar, pra sa është kilometrazhi në fillim të lëvizjes dhe sa është kilometrazhi në fund të lëvizjes së mjetit. Ndërkohë që, nga drejtuesit e mjeteve regjistrohen në këto rubrikë vetën kilometrat e përshkruara në total. Në lidhje me situatën e konstatuar të sipërpërmendur nga organet drejtuese të Shoqërisë nuk ka të përcaktuar një udhëzim, manual dhe rregulla ku të jetë pjesë e Rregullores së Brendshme në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet e Shoqërisë si dhe në të, të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 19, neni 22, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 5, 10, 19 dhe 36.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrim i saktë dhe transparent i procesit të monitorimit për konsumin e karburantit për mjetet e institucionit.
Shkaku:	Mos implementimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Drejtoria e Tregtare dhe Drejtoria Teknike hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.
Rekomandimi:	Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet e shoqërisë si dhe në të, të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësive respektive sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës.

3. Titulli i gjetjes:	Krijimi i kamatëvonesave si pasojë e mos likuidimit në kohë të faturave mbi konsumin e energjisë elektrike.
Situata:	Për periudhën objekt auditimi ndërmjet UK SHA Sarandë dhe OSHEE janë lidhur 23 kontrata për furnizimin me energji elektrike të vetë shoqërisë si dhe funksionimin e stacioneve të pompimit, pompave apo elektropompave. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, detyrimi i lindur nga mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE deri më datë 31.12.2021, ka arritur në vlerën 114,177,290.87 lekë, si dhe kamatëvonesat mbi këtë detyrim në **shumën 101,626,174.54 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë**.

Kriteri:	Ligji nr. 8662, datë 18.09.2000, "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike" i ndryshuar, neni 1.
Ndikimi/Efekti:	Efekt negativ financiar në shumën 101,626,174.54 lekë.
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për likuidimin e faturave të energjisë elektrike në afatet e përcaktuara nga kuadri rregullator në fuqi, për të mos krijuar kamatëvonesa, të cilat rëndojnë artificialisht buxhetin e institucionit.
Rekomandimi:	Nga Këshilli i Administrimit të merren masa të menjëhershme, ku të hartohet një plan emergjent për shlyerjen detyrimeve dhe kamatëvonesave që ka Shoqëria ndaj OSHEE për 23 kontratat për furnizimin me energji elektrike.

4. Titulli i gjetjes:	Gjoba të akumuluara si pasojë e mos deklarimeve në kohë në sistemin ESIG dhe QKB të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe depozitimin e pasqyrave financiare.
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me arkë dhe bankë konstatohet se, janë likuiduar gjoba në shumën totale 217,006 lekë, si pasojë e vonesës së deklarimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mos depozitim i pasqyrave financiare për mungesë vendimi nga Asambleja Aksionare etj., konkretisht për vitin 2019 në shumën 150,044 lekë, për vitin 2020 në shumën 25,000 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 31,861 lekë. Për sa trajtuar më sipër **shuma 217,006 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.**
Kriteri:	Mos deklarimin brenda afateve në sistemin ESIG dhe QKB.
Ndikimi/Efekti:	Efekt negativ financiar në shumën 217,006 lekë.
Shkaku:	Mos respektimi i afateve për kryerjen e deklarimeve në sistemin ESIG dhe QKB nga UK SHA Sarandë.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga organet drejtuese të Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa që, deklarimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në sistemin ESIG dhe depozitimi i pasqyrave financiare në QKB të kryhet brenda afateve të parashikuara në dispozitat ligjore përkatëse me qëllimin shmangien e gjobave dhe penaliteteve.

5. Titulli i gjetjes:	Detyrime dhe penalitete të krijuara si pasojë e mos likuidimit në kohë të kredive.
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Bankave BEI, IDA dhe KfŴ janë lidhur marrëveshjet e financimit konkretisht:

	1. Marrëveshja me BEI për Projektin "Infrastruktura Ujore Bashkiake Stacioni i trajtimit të ujërave të ndotura" me vlerë financimi në shumën 2,357,251 Euro. 2. Marrëveshja me IDA për Projektin "Projekti Bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime" me vlerë financimi në shumën 2,186,719 USD. 3. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake I" me vlerë financimi në shumën 4,000,000 Euro. 4. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake II" me vlerë financimi në shumën 500,000 Euro. Për likuidimin e këtyre shumave të sipërpërmendura ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si përfaqësues i Qeverisë Shqiptare dhe Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë janë nënshkruar akt marrëveshjet nën huaje respektive, ku ende kanë mbetur detyrimet për t'u shlyer deri më datë 31.12.2021, si më poshtë: 1.1. Marrëveshja me BEI për Projektin "Infrastruktura Ujore Bashkiake Stacioni i trajtimit të ujërave të ndotura" UK SHA Sarandë ka detyrimin ndaj MFE në shumën 1,668,815 euro si dhe penalitete në **shumën 141,223.38 euro e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë,** si pasojë e mos likuidimit në kohë të detyrimeve të parashikuara në akt marrëveshjet nën huaje. 1.2. Marrëveshja me IDA për Projektin "Projekti Bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime" ka detyrimin ndaj MFE në shumën 2,304,419 USD. 1.3. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake I" UK SHA Sarandë ka detyrimin ndaj MFE në shumën 144,959 euro. 1.4. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake II" UK SHA Sarandë nuk ka detyrim ndaj MFE mbi këtë akt marrëveshje nën huaje.
Kriteri:	Mos likuidimi në kohë i detyrimeve të përcaktuara në akt marrëveshjet e nën huas të lidhura e MFE.
Ndikimi/Efekti:	Efekt negativ financiar në shumën 141,223.38 euro.
Shkaku:	Paaftësi paguese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për analizimin e detyrimeve që janë krijuar ndër vite referuar akt marrëveshjeve të nën huas të lidhura me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si pasojë e paaftësisë paguese për shlyerjen e kredive, ku t'i bëjë me dije ministrisë situatën e vështirë ekonomike financiare të institucionit për zgjidhjen e kësaj problematike me qëllim shmangien e penaliteteve të cilat lindin si pasojë e mos likujdimit në kohë të këtyre kredive.

6. Titulli i gjetjes:	Parregullsi në procedurat e prokurimeve me vlera të vogla.
Situata:	Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të blerjeve të vogla konstatohet se:

	-Në 3 raste për vitet 2019-2021 janë realizuar 6 procedura prokurimi me vlera të vogla duke shmangur procedurat normale të prokurimit nga copëzimi i fondin limit, pra këto procedura duhet të kryheshin me procedurë me vlera të larta. -Në 21 raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi. -Në 14 raste nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së këtij fondi. -Në 21 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit. -Në 21 raste urdhri i prokurimit, urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave nuk janë të protokolluara, si dhe dosjet e përzgjedhura për auditim nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 40, pika 3, neni 40, pika 1 dhe 8 dhe 59, pika 2, Udhëzimi nr. 3, datë 08.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike" i ndryshuar, pika 19 si dhe neni 3 dhe 29 të "Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë" miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, "Për arkivat".
Ndikimi/Efekti:	Procedurat e prokurimit paraqesin një shmangie apo neglizhencë duke mos respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik.
Shkaku:	Mos implementimi i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Tregtare dhe Zyra Juridike të merren masa që: -Në hartimin e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve, të shmanget procedura e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh; -Të dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit; -Të argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit; -Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi; - Të bëhet arkivimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për të gjitha rastet e mbylljes së procedurës deri në zbatimin e kontratës.

III.2.6. Mbajtja e evidencave kontabël në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.

Me anë të Vendimit nr. 2 datë 29.12.2020 Asambleja e Përgjithshme e UK SHA Sarandë vendosi:

- Miratimin e pasqyrave Financiare të Shoqërisë për vitin 2019 së bashku me dokumentacionin përkatës
- Përcaktimin e fitimit të Shoqërisë të realizuar gjatë vitit financiar 2019 për shumën 9,727,814 lekë.
- Fitimi i realizuar gjatë vitit 2019 të mbartet për investime të shoqërisë në vitet e ardhshme.
- Miratimin e raportit të audituesve ligjorë kontabël të regjistruar, të Shoqërisë "F. A. ShPK. dhe "S. L." ShPK.
- Të emërojë Ekspertë Kontabël për miratimin e pasqyrave financiare që do të mbyllen me datë 31.12.2020, Shoqërinë "S. L." ShPK. dhe "S. A." ShPK.

Me anë të Vendimit nr.1 datë 29.06.2021 Asambleja e Përgjithshme e UK SHA Sarandë vendosi:

- Miratimin e pasqyrave Financiare të Shoqërisë për vitin 2020 së bashku me dokumentacionin përkatës.
- Shoqëria për vitin 2020 ka rezultuar me humbje në shumën prej 54,571,029 lekë e cila do të kaloje për periudhat e ardhshme.
- Të emërojë për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2021 shoqërinë "S. L." ShPK. dhe "H. A.t C." ShPK.

Për vitin 2021 është dërguar vetëm Vendimi i KA të UK SHA Sarandë ë së bashku me Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin 2021 si dhe Raportin e Auditimit të Ekspertëve Kontabël dhe nuk janë miratuar akoma nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë UK SHA Sarandë.

Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të UK SHA Sarandë për miratimin e pasqyrave financiare 2019 mban datën 29.12.2020 në kundërshtim me Vendimin nr.63 datë 27.01.2016 Neni 6, pika 4 *"Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar".*

Vendimi që fitimi i realizuar gjatë vitit 2019 të mbartet për investim për vitet e ardhshme ku detyrimet e UK SHA Sarandë ndaj të tretëve janë në rritje atëherë subjekti duhet të bëjë shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve sipas VKM nr. 63 datë 27.01.2016 Neni 10, Pika 1.

Tabela nr. 3 (në lekë)

Pasqyra e Pozicionit Financiar	**2019**	**2020**	**2021**
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	29,351,883	15,101,003	23,406,459
Të drejta te arkëtueshme			
Nga aktiviteti i shfrytëzimit	294,648,277	309,013,258	333,835,454
Tatim Fitim Parapagime	2,708,483	2,771,147	2,765,147
Të tjera TVSH për tu rimbursuar	5,853,077	7,857,126	11,269,690
Nga njësite ekonomike ku ka interesa pjesmarrëse	1,041,432		
Të tjera për tu paguar (Staff Debitor + 46701)	540,580	1,967,625	2,203,825
Kërkesa për tu arkëtuar Klientë- UK Finiq)	26,871,536	26,871,536	26,871,536
Inventarët			
Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme	20,091,179	17,570,496	19,145,223
Totali i aktiveve afatshkurtra	**381,106,447**	**381,152,191**	**419,497,335**
Aktive afatgjate			
Aktive materiale			
Toka dhe ndërtesa	206,551,525	212,801,548	202,584,404
Impiante dhe makineri	1,188,825,725	1,149,648,945	1,105,224,630
Të tjera instalime dhe pajisje	51,658,323	41,996,283	37,948,278

AAGJM te mbajtura për investim		15,816,708	60,384,026
Parapagime për aktive materiale dhe ne proces	287,042,569	287,042,569	287,042,569
Aktive jo materiale			
Parapagime për AAJM	11,555,785	11,578,085	10,948,276
Aktivet tatimore te shtyra			
Totali i aktiveve afatgjata	**1,745,633,927**	**1,718,884,138**	**1,704,132,183**
TOTALI I AKTIVEVE	**2,126,740,374**	**2,100,036,329**	**2,123,629,518**
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	57,576,055	102,448,865	163,854,726
Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore	2,245,955	2,194,525	2,405,382
Të pagueshme për detyrimet tatimore		75,,434	
Të tjera të pagueshme		1,438,911	
Totali i detyrimeve afatshkurta	**59,822,010**	**106,157,462**	**166,260,108**
Detyrime afatgjata			
Titujt e huamarrjes	567,374,456	574,258,459	563,771,947
Detyrime ndaj institucioneve të kredisë	88,552,118	88,226,070	88,552,117
Të ardhura të shtyra	637,559,632	579,585,718	622,402,473
Provizione			
Provizione te tjera	1,321,500	2,764,706	4,460,845
Totali i detyrimeve afatgjata	**1,294,807,706**	**1,269,025,037**	**1,274,726,537**
Detyrime totale	**1,353,308,216**	**1,375,182,499**	**1,440,986,645**
Kapitali dhe Rezervat			
Kapitali i nënshkruar	584,304,000	584,304,000	584,304,000
Rezerva të tjera			
Rezerva te tjera	13,442,596	13,442,596	13,442,596
Diferenca nga përkthimi i monedhës në veprimtari të huaja			
Fitimi/(humbja) e pashpërndarë	(122,406,321)	(112,678,507)	(167,249,536)
Fitimi/(humbja) e periudhës	9,727,814	(54,571,029)	(47,237,844)
Totali i kapitalit që i takon pronareve njësisë ekonomike	**485,068,089**	**430,497,060**	**383,259,216**
Totali i kapitalit	**485,068,089**	**430,497,060**	**383,259,216**
Kredi për tu njohur jashtë bilancit	**287,042,569**	**291,592,064**	**299,383,657**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	**2,126,740,374**	**2,100,036,329**	**2,123,629,518**

Burimi: UK SHA Sarandë

Në analizimin e zërit Mjete Monetare vihet re që nga 2019 deri në 2021 kemi një rënie në vlerë e cila pasqyrohet si mos arkëtim me anë të bankës si më poshtë, duke mos dhënë arsyet përkatëse se përse vjen kjo rënie e mos arkëtimeve:

(në lekë)

	2019	2020	2021
Arka	0	267,662	634,067
Banka	29,351,883	14,883,141	22,772,391

-Në analizimin e zërit Të drejta të Arkëtueshme dhe nënkategorisë "nga aktiviteti i shfrytëzimit" vihet re një rritje në vlerë e cila përkon me mos arkëtim në kohë të detyrimeve nga ana e debitorëve që reflektohet dhe në zërin e Mjeteve Monetare si një rënie e arkëtimeve me anë të Bankës dhe Arkës.

-Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë "*kërkesa për të arkëtuar klientë UK Finiq"* përbën vlerë e cila është mbartur në vite në shumën 26,871,536 lekë ku sipas Akt- Marrëveshjes nr. 256 Prot. datë 24.06.2019 bëhet i mundur dorëzimi i klientëve të Ujësjellës Kanalizime Finiq por për vlerën e mësipërme që përbën të drejta të arkëtueshme klientë nuk kanë përfunduar procedurat për çregjistrimin e tyre në librat kontabël.

-Në analizimin e zërit të drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë *"të tjera për të paguar Staf debitor+46701"* në vlerën 540,580 lekë për vitin 2019, në vlerën 1,967,625 lekë për vitin 2020 si dhe në vlerën 2,203,825 lekë për vitin 2021 ku për vitet 2019, 2020 përfshihet dhe shuma prej 1,429,600 lekë si gjobë nga Inspektorati Shtetërorë i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave dega

Rajonale Vlorë. UK SHA Sarandë ka depozituar kërkesë padinë në Gjykatën e Administrative e Shkallës së parë Gjirokastër me objekt *"Shfuqizimi dhe shpalljen e pavlefshme të aktit administrativ, vendim për dënim administrativ nr.05 datë 27.07.2017 të ISHMP dega rajonale Vlorë dhe Vendimit të Komisionit të Ankimit të ISHMPU Tiranë nr. 1303 Prot., datë 29.03.2018"*, ku kjo e fundit ka dhënë vendimin nr.324 datë 30.05.2018 në favor të UK SHA Sarandë I.SH.M.P.U Vlorë ka apeluar çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë me nr.232 Prot. datë 08.06.2018, çështje e cila është në proces. Shuma prej 1,429,600 lekë duhej të ishte llogaritur si provizion për arkëtim pasi nuk mund të llogaritet si e drejtë e arkëtueshme pa një vendim të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Për sa i përket vlerës së mbetur e cila përfaqëson Staf Debitor, vihet re një rritje nga viti në vit duke mos marr masat përkatëse për arkëtimin e detyrimeve nga ana e stafit.

-Në analizimin e zërit Të drejta të Arkëtueshme dhe nënkategorisë "*njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse Bashkia Sarandë*" vihet re vlera prej 1,041,432 lekë, shumë e cila duhet të rimbursohet nga Bashkia Sarandë mbi mbulimin e familjeve që kanë përfituar matësit e ujit falas me anë të vendimit nr.18 datë 12.01.2018 "Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë por që nuk është rimbursuar dhe nuk është pasqyruar si vlerë në dy vitet pasardhëse përkatësisht 2020 dhe 2021.

-Në analizimin e zërit Aktive Afatgjata dhe nënkategorisë *"Parapagime për aktive materiale dhe në proces"* ku përfshihet një investim "Itun" i papërfunduar në vlerën 287,042,569 lekë ku pasqyrohet si investim i papërfunduar.

-Në analizimin e zërit Detyrime Afatshkurtra dhe nënkategorisë "*Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit"* vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri që përbëhet nga detyrime ndaj Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në procedura prokurimi, detyrime ndaj OSHEE përkatësisht gjatë vitit 2019 në vlerën 47,495,662 lekë, gjatë vitit 2020 në vlerën 75,805,518 dhe gjatë vitit 2021 në vlerën 114,177,051 lekë.

-Në analizimin e zërit Detyrime Afatshkurtra dhe nënkategorisë "*Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore"* përfshihen detyrimet e muajit dhjetor.

-Në analizimin e zërit Detyrime Afatgjata dhe në nënkategorinë *"Titujt e huamarrjes"* përfaqësohet nga dy kredi afatgjatat Kredia IDA në vlerën 1,319,059 USD dhe Kredia-KFŴ në vlerën 3,566,840 Euro të konvertuara me kursin e ditës për vitet përkatëse.

-Në analizimin e zërit Detyrime Afatgjata dhe në nënkategorinë *"detyrime ndaj institucioneve të kredisë"* janë interesat e llogaritura dhe të papaguara ndaj dy kredive të mësipërme në përkatësisht për Kredinë IDA në vlerën 303,064 USD dhe për Kredinë KFŴ në vlerën 466,168 Euro të konvertuara me kursin e ditës së mbylljes së bilancit.

Për sa i përket inventarizimit të aktiveve janë ngrit komisionet për inventarizimin e AQT përkatësisht për vitet:

2019 – Urdhër Inventarizimi për AAGJ dhe AASH Materiale nr. 431 Prot. datë 07.11.2019

2020 – Urdhër Inventarizimi për AAGJ dhe AASH Materiale nr. 575 Prot. datë 26.11.2020

2020 – Urdhër Inventarizimi për AAGJ dhe AASH Materiale nr. 380 Prot. datë 18.11.2021

ku komisionet e inventarizimit kanë përpiluar proces-verbalet të shoqëruara me relacion përkatës ku pasqyrohen diferencat dhe problematikat e konstatuara.

Në vitin 2020 është ngritur komisioni për asgjësimin e AAGJ dhe AASH me anë të urdhrit nr. 194 Prot. datë 24.04.2020 ku është dokumentuar asgjësimi i aktiveve sipas procedurave përkatëse.

1. Titulli i gjetjes:	Miratimi i Pasqyrave Financiare nga Asambleja e Përgjithshme e UK SHA Sarandë jashtë afateve të cituara në ligj si dhe alokimi i fitimi të realizuar për investime në vitet e ardhshme.
Situata:	Nga auditimi ka rezultuar se Asambleja e Përgjithshme e UK SHA Sarandë me vendim nr. 2 datë 29.12.2020, ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2019, ku rezultati financiar i këtij vitit paraqitet me fitim në vlerën 9,727,814 lekë. Sipas këtij vendimi, fitimi i shoqërisë do mbartet për investime të shoqërisë në periudhat e ardhshme, veprim i cili duhet të realizohet brenda periudhës së 6 mujorit të parë të vitit ushtrimorë. Nga UK SHA Sarandë (strukturat përgjegjëse), vendimi për alokimin e fitimit nuk është kryer brenda 6 mujorit të parë të vitit ushtrimor, veprim i cili ka çuar në penalizmin me masë gjobe 10,000 lekë nga Drejtoria rajonale Tatimore.
Kriteri:	Në kundërshtim me Vendimin nr.63 datë 27.01.2016 Neni 6, pika 4 "Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar", VKM nr.63 datë 27.01.2016 Neni 10, pika 1 "*Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet Asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;"* si dhe ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 *"Për tatimin mbi të ardhurat"* i ndryshuar Kreu III Neni 33/1 si dhe "Strategjia për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura dhe Plani i Veprimit, Ministria e Financave".
Ndikimi/Efekti:	Ndikimi në performancën e aktivitetit të shoqërisë, në alokomin e burimeve të shoqërisë si dhe në masat që mund të marrë shoqëria mbi investimet si dhe ndryshimet kapitale të shoqërisë.
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, gjatë hartimit dhe miratimit të pasqyrave financiare të marrë për bazë respektimin e afateve sipas dispozitave ligjore në fuqi si dhe në rastet kur shoqëria rezulton me fitim të periudhës duhet që pjesën më të madhe të fitimit ta përdori për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë.

Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi me z. Sh. L. në rolin e Administratorin të Shoqërisë, znj. Zh. M. me detyrë Drejtore Tregtare si dhe Këshilli i Administrimit me përbërje z. Sh. L., z. S. K.i, z. K. K. dhe z. E. Gj.

2. Titulli i gjetjes:	Rënie në arkëtimet me anë të arkës dhe bankës si dhe vlera prej 1,041,432 lekë si e drejtë e arkëtueshme nga Bashkia Sarandë.
Situata:	Pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua që, arkëtimet me anë të bankës dhe arkës kanë ardhur në rënie duke rritur vlerën e zërit *Të drejta të arkëtueshme.* Në analizimin e

	zërit *Të drejta të Arkëtueshme* dhe nënkategorisë *"Njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse Bashkia Sarandë",* vihet re vlera prej 1,041,432 lekë, shumë e cila duhet të rimbursohet nga Bashkia Sarandë mbi mbulimin e familjeve që kanë përfituar matësit e ujit falas me anë të vendimit nr.18 datë 12.01.2018 *"Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë",* por që nuk është rimbursuar dhe nuk është pasqyruar si vlerë në dy vitet pasardhëse përkatësisht 2020 dhe 2021
Kriteri:	Në kundërshtim me Kreun II Neni 95 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"* i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Ndikimi në performancën e aktivitetit të shoqërisë, në akumulimin e borxhit të keq.
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë të marrë masat që të kryejë arkëtimet në kohën e duhur sipas plan veprimit dhe natyrës së arkëtimit duke shmangur faktorët që mund të çojnë në krijimin e borxhit të keq në shoqëri.

Për sa më sipër mbahet akt konstatimi me z. Sh. L. në rolin e Administratorin të Shoqërisë dhe znj. Zh. M. me detyrë Drejtore Tregtare.

3. Titulli i gjetjes:	Çregjistrimi në librat kontabël i llogarisë *"Kërkesat për të arkëtuar klientë UK Finiq".*
Situata:	Në analizimin e zërit të Drejta të Arkëtueshme vihet re që në nënkategorinë "kërkesa për të arkëtuar klientë UK Finiq" përbën vlerë e cila është mbartur në vite në shumën 26,871,536 lekë ku sipas Akt- Marrëveshjes nr. 256 Prot. datë 24.06.2019 bëhet i mundur dorëzimi i klientëve të Ujësjellës Kanalizime Finiq por për vlerën e mësipërme që përbën të drejta të arkëtueshme klientë nuk kanë përfunduar procedurat për çregjistrimin e tyre në librat kontabël.
Kriteri:	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit SKK 08
Ndikimi/Efekti:	Ndikimi në performancën e aktivitetit të shoqërisë, si dhe pasqyrimin jo të saktë të pasqyrave financiare.
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	UKS, të bëjë të mundur çregjistrimin në librat kontabël të vlerës prej 26.871.536 lekë, mbi të cilën nuk ka asnjë të drejtë mbi arkëtimin e kësaj vlere sipas Akt – Marrëveshjes nr. 256 Prot., datë 24.06.2019.

Për sa më sipër mbahet akt konstatimi me z. Sh. L. në rolin e Administratorin të Shoqërisë dhe znj. Zh. M. me detyrë Drejtore Tregtare.

4. Titulli i gjetjes:	Likuidimi i detyrimeve ndaj të tretëve.
Situata:	Në analizimin e zërit *Detyrime Afatshkurtra* dhe nënkategorisë *"Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit"* vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri që përbëhet nga detyrime ndaj Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në procedura prokurimi, detyrime ndaj OSHEE përkatësisht gjatë vitit 2019 në vlerën 47,495,662 lekë, gjatë vitit 2020 në vlerën 75,805,518 dhe gjatë vitit

	2021 në vlerën 114,177,051 lekë. Në analizimin e zërit *Detyrime Afatshkurtra* dhe nënkategorisë "*Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore"* përfshihen detyrimet e muajit dhjetor. Në analizimin e zërit *Detyrime Afatgjata* dhe në nënkategorinë *"Titujt e huamarrjes"* përfaqësohet nga dy kredi afatgjata, Kredia IDA në vlerën 1,390,000 SDR dhe Kredia-KFŴ në vlerën 3,566,840 Euro të konvertuara me kursin e ditës për vitet përkatëse. Sipas Marrëveshjes së nën-huas në UK SHA Sarandë, do të investohej shuma prej 1,390,000 SDR e barabartë me 1,954,443 USD. Ndërsa sipas rakordimit me Ministrinë e Financave në 31.12.2017, vlera e disbursuar paraqitet në shumën 2,530,820.86 USD, ndërsa vlera e kredisë sipas Marrëveshjes së nën-huas e shprehur në dollarë është 1,954,443 USD, me një mos rakordim në shumën 576,377 USD. Me dokumentacion është justifikuar përdorimi i fondeve në vlerën 133,040,349 lekë, ndërsa vlera e financimit e shprehur në lekë në datë 07.07.2003 është 233,408,800 lekë. Për diferencën në 100,368,451 lekë, nga zbatuesi i projektit (DPUK/AKUK) nuk është paraqitur dokumentacion justifikues (pranë UK SHA Sarandë) sipas natyrës së shpenzimeve të kryera në kuadër të këtij projekti. Theksojmë se, kjo problematikë është konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH. Në analizimin e zërit *Detyrime Afatgjata* dhe në nënkategorinë *"Detyrime ndaj institucioneve të kredisë",* janë interesat e llogaritura dhe të papaguara ndaj dy kredive të mësipërme në përkatësisht për Kredinë IDA në vlerën **303,064 USD** dhe për Kredinë KFŴ në vlerën **466,168 Euro** të konvertuara me kursin e ditës së mbylljes së bilancit.
Kriteri:	Strategjia për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura dhe Plani i Veprimit, Ministria e Financave.
Ndikimi/Efekti:	Ndikimi në performancën e aktivitetit të shoqërisë.
Shkaku:	Mos zbatimi i dispozitave ligjore në fuqi.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	-UK SHA Sarandë, të marrë masat mbi likuidimin e detyrimeve të prapambetura ku mund të vazhdojnë të ndjekin grafikun e pagesave sipas planifikimit, duke respektuar parimin e kohës së krijimit të detyrimit sipas natyrës së shpenzimit. -Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a, të marrë masat mbi zgjidhjen e problematikës mbi mos rakordimin e vlerës prej 576,377 USD, midis Akt marrëveshjes së nën-huasë IDA dhe Ministrisë së Financave, gjë e cila ndikon në llogaritjen e interesave dhe në mënyrën se si janë përdorur fondet.

Për sa më sipër mbahet akt konstatimi me z. Sh. L. në rolin e Administratorin të Shoqërisë dhe znj. Zh. M. me detyrë Drejtore Tregtare.

5. Titulli i gjetjes:	Investim "ITUN" i papërfunduar.
Situata:	Në analizimin e zërit *Aktive Afatgjata* dhe nënkategorisë *"Parapagime për aktive materiale dhe në proces"* ku përfshihet një investim "Itun" në vlerën 287,042,569 lekë, ku pasqyrohet si investim i papërfunduar. Kjo vlerë i përket investimit me objekt "Infrastruktura Ujore e Bashkisë", sipas raportit të

	hartuar nga UKS SHA, nuk është marrë në dorëzim për shkak të mosplotësimit të parametrave teknikë të parashikuar në kontratë. Përsa i përket investimit të papërfunduar me objekt "Infrastruktura Ujore e Bashkisë" në vlerën 319,591,667 lekë dhe regjistrimit të tij si llogari jashtë bilanci, është rezultat i faktit se UKS SHA është përfituese e investimit me objekt "Infrastruktura Ujore e Bashkisë". Ky projekt sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (DPUK) sot Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime (AKUK) ka përfunduar më datë 31.12.2011, bazuar në kontratën së lidhur më datë 24.01.2007 ndërmjet Kontraktorit "Putignano & Figli Srl" (Itali) dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) për ndërtimin e tre impianteve të pastrimit, ku është përfshirë edhe Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) Sarandë. Sipas shkresës nr. 1820, datë 24.07.2014 të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (sot Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime) vlera e financimit është në shumën 3,877,126 EUR. Me shkresën nr. 1820, datë 24.07.2014, protokolluar në UKS SHA me nr. 170, datë 10.09.2014 është cilësuar se: - Nga koha e përfundimit të kontratës 31.12.2011 deri në 24.07.2014, UKS SHA është ngarkuar nga ministria e linjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e impiantit deri në përfundim të lidhjes së tyre me rrjetet përkatëse të kanalizimeve. - PIU i Ujit në ministrinë e linjës kërkon nga UKS SHA si përfitues që të marrë në dorëzim objektin. - Me shkresën nr. 170/1, datë 15.09.2014 të Administratorit të UKS SHA, i është kthyer përgjigje Ministrisë, ku është relatuar se objekti nuk mund të merret në dorëzim, pasi mbart problematika të shumta të cilat kanë sjellë mosfunksionimin e tij. - Me shkresat nr. 198, datë 21.06.2016 dhe 230/1, datë 15.07.2016 drejtuar DPUK/AKUK, nga ana e Administratorit, është bërë me dije se "Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura" ITUN, nuk është në funksion për shkaqet të cilat janë bërë prezent me shkresën nr. 170/1, datë 15.09.2014. Theksojmë se vlera totale e financimit për këtë investim është në shumën 3,877,126.92 EUR, nga e cila vlera e kredisë është 2,403,848 EUR (referuar MF). Ky investim nuk është marrë në dorëzim dhe nuk është vënë në përdorim për shkak të mosplotësimit të një sërë komponentësh të kësaj kontrate si: Tubacionet e dërgimit të ujërave kanë rezultuar me çarje; Impianti nuk është vendosur asnjëherë në punë dhe pjesa më e madhe e pajisjeve nuk punojnë; Pompa e furnizimit me ujë të impiantin nuk punon; Pajisjet e pastrimit të grilave nuk punojnë etj. *(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-37, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UKS sh.a., duhet të marrin në analizë këtë situatë, të bëjnë me dije strukturat të cilat kanë përgjegjësinë për këtë investim, si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe PIU Ujit, për mosfunksionimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Sarandë, për

	shkak të dështimit të këtij investimi dhe obligimit të UKS SHA për shlyerjen e detyrimeve të kredisë të marrë për këtë qëllim. UKS sh.a. të kërkojë nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe PIU i Ujit, si kontraktuese me kompaninë zbatuese, të marrin masa të menjëhershme për përfundimin e këtij investimi brenda kostos së parashikuar dhe sipas parametrave teknikë të përcaktuar në kontratë, me qëllim vënien në funksionim të ITUN Sarandë.
Kriteri:	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit SKK 05.
Ndikimi/Efekti:	Ndikimi në performancën e aktivitetit të shoqërisë, si dhe në kapitalin e shoqërisë.
Shkaku:	Investimi është i papërfunduar që çon në mos marrjen në dorëzim të investimit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UKS sh.a., duhet të marrin në analizë këtë situatë, të bëjnë me dije strukturat të cilat kanë përgjegjësinë për këtë investim, si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe PIU Ujit, për mosfunksionimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Sarandë, për shkak të dështimit të këtij investimi dhe obligimit të UKS SHA për shlyerjen e detyrimeve të kredisë të marrë për këtë qëllim. UKS sh.a. të kërkojë nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe PIU i Ujit, si kontraktuese me kompaninë zbatuese, të marrin masa të menjëhershme për përfundimin e këtij investimi brenda kostos së parashikuar dhe sipas parametrave teknikë të përcaktuar në kontratë, me qëllim vënien në funksionim të ITUN Sarandë.

Për sa më sipër mbahet akt konstatimi me z. Sh. L. në rolin e Administratorin të Shoqërisë dhe znj. Zh. M. me detyrë Drejtore Tregtare.

III.2.7. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen e zbatimin e kontratave.

Referuar periudhës së auditimit janë realizuar 39 procedura prokurimi. Për këto procedura, është përllogaritur fondi limit me vlerë 269 milionë lekë dhe janë lidhur kontrata me vlerë 274 milionë lekë, me kursim 22 milionë lekë, ose 8 % të vlerës së fondit limit. Prokurimi për karburante llogaritet mbi bazën e marzhit të fitimit, i cili rezulton i ulët, në procedurat e zhvilluara. Po ashtu, nga përllogaritja si më sipër, nuk del në pah kursimi për procedurat e zhvilluara për marrëveshjet kuadër). Janë audituar 10 procedura prokurimi, me vlerë të fondit limit në shumën 176 milionë lekë, ose 64 % e vlerës së prokuruar. Janë realizuar 8 procedura kërkesë për propozim, 30 procedura të hapura dhe një procedurë me negocim pa shpallje. Procedura e realizuar negocim pa shpallje është realizuar në kushtet e emergjencës, pasi nga ana e Bashkisë Sarandë po realizohej në investim në zonën e bulevardit, nga ku ka rezultuar tubacion tejet i amortizuar dhe realizimi në një fazë të dytë krijonte kosto të larta dhe dëmtim të investimit të realizuar nga bashkia. Për procedurat e audituara, është audituar edhe zbatimi i kontratave përkatëse, përjashtuar kontratën "Ndërtim sistemi KUZ, Ksamil", pasi në momentin e auditimit ishte likuiduar në masën 10 %, kontrata "Mirëmbajtja dhe riparimi i elektropompave të stacioneve të pompimit", si dhe "Ndërtim KUZ Lug i Dardhës", pasi i përket vitit 2022, nga ku kanë rezultuar mangësi në 3 kontrata.
Procedurat e zhvilluara paraqiten në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 4 Procedurat e prokurimit të realizuara për periudhën e auditimit.

Nr.	Procedura	Lloji	Fondi limit	Vlera e kontratës
	Viti 2019			
1	Mirëmbajtja e automjeteve dhe makinerive	Kërkesë për prop.	3,480,109	2,092,400
2	Blerje hipoklorit natriumi	"	2,186,765	2,161,337
3	Rikonstruksion i zyrave të vjetra	"	3,500,000	3,405,420
4	Mirëmbajtje e rrjetit të ujit të pijshëm dhe KUZ	Marr.kuadër	6,000,000	6,000,000
5	Blerje karburanti	"	6,000,000	6,000,000 m.fitimi 5.8 %
6	Përmirësim i rrjetit të ujësjellësit zona gjashtë	"	1,500,000	1,280,000
7	Blerje dy automjete për nevoja të shoqërisë	"	5,187,326	4,820,000
8	Sistemimi i informimit dhe ekspozimit ndaj qytetarit	"	1,780,000	1,680,000
9	Mirëmbajtje e stacioneve të pompimit	Marr.kuader	7,400,000	7,400,000
10	Sporteli elektronik dhe mobile për qytetarin	"	3,000,000	2,900,000
11	Ndërtimi i kafazit të shkallës me vetrat xhami të temperuar	"	4,000,000	2,964,500
	Viti 2020			
12	Blerje hipoklorit Natriumi	Kërk.për propozim	3,160,200	3,022,800
13	Ndërtim sistemi KUZ, Ksamil	E hapur	81,947,188	78,957,625
14	Ndërtim linja ujësjellësi, puseta kontrolli... Bëndenesh	Kerk. Për propozim	2,502,000	2,412,630
15	Zëvendësim linje ujësjellësi në shëtitore DN 280, l = 450 m	Me negocim	6,799,000	6,795,893
16	Blerje pajisje dhe pjesë këmbimi për stacionet e pompimit të ujërave të ndotur	Kërk. Për propozim	4,148,333	4,122,500
17	Ndërtim pus i ri Çukë-Ksamil	"	4,442,930	4,278,938
18	Ndërtim KUZ Blloku mbi Lagjen nr. 5	E hapur	32,039,144	31,821,600

19	Blerje pajisje elektronike	Kërk. Për propozim	1,568,771	1,395,500
20	Mirëmbajtje ITUN Çukë	E hapur (marr. kuad)	11,996,263	11,996,263
21	Përmirësim KUZ Sarandë	“	14,518,689	12,913,075
22	Ndërtim i stacionit të ri pus çpimi në Vrion	Kërk. Për propozim	11,880,279	9,404,900
23	Furnizim me ujë me bot, në periudhën e verës	Marr. Kuadër	1,800,000	1,800,000
24	Blerje karburanti	“	6,000,000	6,000,000 m.fitimi 7.69
25	Rikonstruksion i pusit nr. 1, Vrion	“	1,500,000	1,181,000
26	Blerje materiale elektrike për stacionin e pomp.	“ Marr.kuadër	6,000,000	6,000,000
27	Blerje pompë për largimin e ujërave të ndot.	“	4,600,000	4,100,000
	Viti 2021			
28	Ndërtim rrjeti i kan. të ujër. të ndotur, Lug i Dardhës	E Hapur, e thjeshtëzuar	9,825,084	7,743,400
29	Përmirësim i furnizimit me ujë Lagjia Kamina	E hapur, e thjeshtëzuar	1,274,147	1,044,000
30	Blerje karburanti	“	6,000,000	6,000,000 157.2 lekë/lit
31	Përmirësim rrjet kanalizimi Rr. “13 Bibilenjtë”	“	11,044,530	10,310,233
32	Blerje softŵare për autom. e leximit të konsumit.	“	2,800,000	2,760,000
33	Mirëmbajtja dhe riparimi i elektropompave të stacioneve të pompimit	“	7,960,702	7,868,200
34	Përmirësime të raporteve dhe funks. Të reja të sistemit të faturimit	“	2,000,000	1,910,000
35	Ndërtim i linjës së furnizimit me ujë për ITUN	“	1,467,710	1,202,320
36	Mirëmbajtje dhe riparim të mjeteve dhe automjeteve	Kërkesë për propozim	4,605,111	4,605,111
37	F.V testim i çekiç hidraulik për mjetin volvo BL61	E hapur e thjeshtëzuar	1,365,333	1,302,000
38	Rehabilitim i stacion. Të pomp. Ujë i ndotur Sarandë	Kërk. për propozim	2,000,000	1,820,000
39	Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të ujërave të ndotura	Kërk. Për propozim	1,642,205	1,448,082
	SHUMA		**296,921,819**	**274,618,727**

Burimi: UK SHA Sarandë (sistemi elektronik i prokurimeve)

Në procedurat e audituara kanë rezultuar mangësi kryesisht në përllogaritjen e fondit limit si dhe në hartimin e kërkesave teknike për prokurim, të cilat paraqiten konkretisht sipas procedurave të realizuara. Në zbatimin e kontratave kanë rezultuar punime të pa realizuara dhe të likuiduara, si dhe mos respektim të specifikimeve teknike.

1. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e procedurës së prokurimit “Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial, Ksamil”.

Fondi limit për procedurën e prokurimit është përllogaritur me vlerë 81,947,188 lekë. Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit. Sa i takon vendosjes së kritereve, nga ana e APP janë dhënë disa rekomandime. Tenderi është zhvilluar me datë 05.02.2021, ku kanë marrë pjesë 6

OE, nga të cilët janë s'kualifikuar 3. Është shpallur fitues OE "I. G. & 2. K." me vlerë oferte 78,958,625 lekë. Kontrata është nënshkruar me nr. 73 prot., datë 25.02.2021.
Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

<table>
<tr><th colspan="5">Procedura e Prokurimit: "Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial, Ksamil".</th></tr>
<tr><td colspan="2">1. Urdhër Prokurimi nr. 68, datë 24.12.2020
2. lloji i Procedurës së Prokurimit
(E hapur)</td><td colspan="2">3. njësia e prokurimit
A. V.
F. B.
N. Ç.</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 68/1, datë 24.12.2020.
K. K.
A. Ç.
E. I. (ekonomist)</td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Fondi Limit (pa TVSh)
81,947,188 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa TVSh)
78,958,625 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin Limit (pa TVSh)
2,988,563 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Data e hapjes së ofertave
05.02.2021</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit
Financim nga AKUM</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
1. Shoqëria "R. C." me ofertë me vlerë 81,941,898 lekë.
2. OE "6. P." ShPK me ofertë me vlerë 81,705,555.
3. Shoqëria "B." me ofertë me vlerë 81,401,145 lekë
4. Shoqëria "F.' me vlerë oferte 81,059,459 lekë.
5. Shoqëria "G. K.' me vlerë oferte 81,708,550 lekë.
6. Shoqëria "I. G. & 2. K." me vlerë oferte 78,958,625 lekë.
b. S'kualifikuar –3 OE</td></tr>
<tr><td colspan="2">11. Ankimime
-Nuk ka</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK
-</td><td>13. Përgjigje ankesës nga KPP
-</td></tr>
<tr><th colspan="5">b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</th></tr>
<tr><td colspan="2">14. lidhje e kontratës
Nr. 73, datë 25.02.2021</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me TVSh)
-</td><td>16. Likuiduar
- lekë
Pa likuiduar:
- lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi
Vlera me TVSH.....
Vlera pa TVSH.....</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës në ditë.
Parashikuar 300 ditë
Zbatuar .....ditë</td><td>19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë
-</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
"H. & S." ShPK</td><td>Licencë nr.</td><td>Kontrata nr. 09/04/2021</td><td>Likuiduar .....</td><td>Pa likuiduar ---- lekë</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
-</td><td>Licencë nr.</td><td>Kontrata nr.</td><td>Likuiduar .....</td><td>Pa likuiduar .....</td></tr>
<tr><td colspan="2">22. Aktkolaudimi
S'ka përfunduar objekti</td><td colspan="2">23. Akti i marrjes në dorëzim.
Datë s'ka përfunduar</td><td>24. Fletë Hyrja
Nr..... Datë.....Lekë</td></tr>
</table>

Nga auditimi i kësaj procedure u konstatuan mangësi si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Mangësi në përllogaritjen e fondit limit.

Situata:	Projekt preventivi i punimeve është hartuar nga Shoqëria "M. Ch." SHPK. Fondi limit është përllogaritur me vlerë 81,947,188 lekë, bazuar në manualet e çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre. - Sipas zërit "Pusete kontrolli 1x1x1.5, me kapak gize, çdo 30 m", është aplikuar analiza (2.575), me çmim 80,883 lekë/copë, për 29 puseta. Kjo analizë çmimi i referohet ndërtimit me tulla të plota, ndërsa nga verifikimi i dokumentacionit të projektit të zbatimit rezulton se kemi të bëjmë me ndërtim puseta prej betoni. Nga përllogaritja e kostos për pusetë betoni monolite me kapak gize, rezulton çmimi 74,718 lekë. Sipas këtij zëri, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 177,355 lekë [29 puseta (80,833 lekë – 74,718 lekë)]. Sa më sipër, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 177,355 lekë. Duke marrë në konsideratë faktin se nga konkurrenca në procedurën e prokurimit, kontrata është nënshkruar me vlerë 78,958,625 lekë diferenca në fondin limit konsiderohet se nuk ka dhënë efekt.
Kriteri:	VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Pika 2.
Ndikimi:	Nuk ka patur ndikim, si pasojë e uljes së vlerës së kontratës.
Shkaku	Mos përcaktimi i saktë i çmimit të referencës.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Komisionet e përllogaritjes së fondit limit, duhet të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përafërt, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. F. B., në cilësinë e specialistit të fushës, anëtar i Njësisë së Prokurimit.

2. Titulli i gjetjes:	Janë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.
Situata:	Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësia e prokurimit. Nga ana e APP me e-mail të datës 05.01.2021, janë konstatuar kritere të cilat nuk përmbushin parashikimet e dispozitave ligjore të prokurimit publik. Nga ana e njësisë së prokurimit, pas pezullimit të procedurës, janë bërë disa reflektime të rekomanduara, duke ndryshuar dokumentet e tenderit nëpërmjet shtojcës. Reflektim nuk është bërë në lidhje me sa më poshtë: Disponim licencë sipas pikës N.P 12 "Punime të inxhinierisë mjedisore". Nuk është hequr kërkesa që OE të këtë drejtues teknik për pozicionin inxhinier mjedisi. Nuk është hequr kriteri i cili ka të bëjë me numrin e punonjësve manovrator i cili është përcaktuar 4, si dhe i dy makinistëve. Për këtë kriter, nuk është marrë në konsideratë fakti se OE mund të ketë kontratë qiraje me OE tjetër për mekanizma dhe automjete. Është vendosur kriteri për disponimin e lejes mjedisore me kod III.2.B "Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme, në selinë e

	ushtrimit të aktivitetit". Në preventivin e punimeve është përcaktuar vetëm zëri transport në distancë deri 7 km, i cili mund të kryhet nga kamionë të cilët licencohen për këtë qëllim. Bazuar në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", licenca sipas kodit të mësipërm specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme, veprimtari e cila nuk është objekt i kontratës. Megjithëse nga APP është rekomanduar për t'u rishikuar, pasi kemi të bëjmë me kërkesë drejtuar të tretëve, të cilët nuk janë pjesëmarrës në tender, nuk është reflektuar mbi kriterin: "Për impiantin e asfaltit dhe impiantin e seleksionimit të inertëve duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë, leje mjedisore me Kod III.1.B (lëshuar nga QKB). Nëse nuk është në pronësi duhet të paraqitet kontrata e qira/furnizimit (e lidhur para noterit), shoqëruar me dokumentin e pronësisë, leje mjedisore me Kod III.1.B.
Kriteri:	- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (shfuqizuar), neni 46. - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 26, pika 5.
Ndikimi:	Përcaktimi i kritereve të pa studiuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, mund të ndikojë në pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit.
Shkaku	Përcaktimi i kritereve pa i argumentuar ato.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Njësia e prokurimit apo komisioni i ngarkuar, duhet të argumentojnë kriteret e kualifikimit që vendosen në procedurat e prokurimit, duke patur në konsideratë natyrën dhe volumin e kontratës, me synim shmangien e kritereve që krijojnë kufizime për pjesëmarrësit, si dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të lartë të biznesit të vogël e të mesëm.

Ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit znj. A. V., z. F. B. dhe z. N. Ç..

2. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit "Ndërtim i KUZ Lugu i Dardhës".

Fondi limit për këtë procedurë është përllogaritur me vlerë 9,825,084 lekë. Çmimet e aplikuara kanë si referencë manualet e çmimeve të ndërtimit. Dokumentet e tenderit janë miratuar nga Njësia e Prokurimit me datë 14.12.2021, për të cilat janë dhënë disa rekomandime nga ana e APP. Në tender kanë marrë pjesë 4 OE, nga të cilët janë s'kualifikuar 2 OE. Është shpallur fitues dhe është nënshkruar kontrata me OE "M./S" SHPK me vlerë 7,743,400 lekë.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: "Ndërtim i KUZ Lugu i Dardhës".		
1. Urdhër Prokurimi nr. 55, datë 14.12.2021	**3. Njësia e prokurimit** A. V. (juriste) F. B. (inxhinier) E. Ll.	**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 47/1, datë 16.09.2020.** K. K. E. I.
2. L**loji i Procedurës së Prokurimit** (E hapur, e thjeshtëzuar)		

			N. Ç.	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,825,084 lekë	6. **Oferta Fituese (pa TVSh)** 7,743,400 lekë		**7. Diferenca me fondin Limit (pa TVSh)** 2,081,684 lekë	
8. Data e hapjes së ofertave 12.01.2022	**9. Burimi i Financimit** Buxheti i shoqërisë		**10. Operatorët Ekonomikë** 1. OE "M./S" ShPK me ofertë me vlerë 7,743,400 lekë. 2. BOE I. & 2. K. me vlerë oferte 7,760,950 lekë. 3. Shoqëria "J. C." me vlerë oferte 7,715,850 lekë. 4. A.-2. CO me vlerë oferte 9,825,000 lekë. b. S'kualifikuar –2 OE	
11. Ankimime -	**12. Përgjigje e ankesës nga AK**		**13. Përgjigje ankesës nga KPP** -	
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. lidhje e kontratës Nr. 44, datë 01.02.2022	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)** - 9,292,080 lekë		**16. Likuiduar** - lekë Pa likuiduar: - lekë	
17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi` Vlera me TVSH Vlera pa TVSH	**18. Afati i kontratës në ditë.** Parashikuar 90 ditë Zbatuar: 90 ditë		**19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë** -	
20. Mbikëqyrësi i punimeve "N. T. S." ShPK	**Licencë nr. MK 1.**	Kontrata nr. 63, datë 24.02.2022	**Likuiduar .....**	**Pa likuiduar lekë**
21. Kolaudatori i punimeve -	**Licencë nr.** -	**Kontrata -**	**Likuiduar .....**	**Pa likuiduar .....**
22. Aktkolaudimi -	**23. Akti i marrjes në dorëzim.** -		**24. Fletë Hyrja** Nr..... Datë.....Lekë	

Mangësitë e konstatuara nga auditimi i kësaj procedure paraqiten si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Mangësi në përllogaritjen e fondit limit.
Situata:	Fondi limit është bazuar në preventivin e hartuar nga z. F. B.. Çmimet janë referuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre". Miratimi i realizimit të investimit është bërë nga Këshilli i Administrimit të UK Sarandë me nr. 11, datë 24.11.2021. Nga verifikimi i çmimit të aplikuar për disa zëra punimesh konstatohet: -Sipas zërit (2.48/an) "Gërmim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhirë është aplikuar çmimi 3,965 lekë/m^3, për sasinë 423 m^3, me vlerë 1,675,000 lekë. Nga verifikimi i manualit përkatës rezulton se ky çmim i përket gërmimit në shkëmb të fortë dhe jo mesatar. Çmimi i referencës për shkëmb mesatar është sipas analizës 2.47/an, me çmim 1,770 lekë/m^3. Vlera për këtë zë punimi duhet të ishte 748,710 lekë (423 m^3 x 1,770 lekë/m^3). Sa më sipër, fondi limit është përllogaritur më shumë në vlerën 926,290 lekë (1,675,000 lekë – 748,710 lekë). - Sipas zërit "Pusete kontrolli 1x1x1.5, me kapak gize, çdo 30 m", është aplikuar analiza (2.575), me çmim 80,883 lekë/copë, për 17 puseta. Kjo

	analizë çmimi i referohet ndërtimit me tulla të plota, ndërsa nga verifikimi i dokumentacionit të projektit të zbatimit rezulton se kemi të bëjmë me ndërtim puseta prej betoni. Nga përllogaritja e kostos për pusetë betoni monolite me kapak gize, rezulton çmimi 74,718 lekë. Sipas këtij zëri, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 103,940 lekë [17 copë (80,833 lekë – 74,718 lekë)]. Sa më sipër, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 1,030,230 lekë. Duke marrë në konsideratë faktin se nga konkurrenca në procedurën e prokurimit, kontrata është nënshkruar me vlerë 7,743,400 lekë diferenca në fondin limit konsiderohet se nuk ka dhënë efekt.
Kriteri:	VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Pika 2.
Ndikimi:	Nuk ka patur ndikim, si pasojë e uljes së vlerës së kontratës.
Shkaku	Mos përcaktimi i saktë i çmimit të referencës.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Komisionet e përllogaritjes së fondit limit, duhet të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përafërt, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. F. B., në cilësinë e specialistit të fushës, anëtar i Njësisë së Prokurimit.

2. Titulli i gjetjes:	Janë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.
Situata:	Procesverbali mbi hartimin e dokumenteve të tenderit është hartuar nga Njësia e Prokurimit me datë 14.12.2021. Për kriteret e vendosura është bërë ankesë nga OE "A." SHPK, me shkresë nr. 63 prot., datë 20.11.2021. Po ashtu nga ana e APP me e-mail datë 22.12.2021, janë rekomanduar disa ndryshime në kriteret e veçanta. Pas reflektimeve, janë hartuar shtojca 1 dhe shtojca 2. Pavarësisht reflektimeve të bëra rezulton se në kriteret e veçanta janë kërkuar licenca dhe makineri të cilat nuk përputhen me llojin e punimeve të parashikuara si më poshtë: Është vendosur kriteri për disponimin e lejes mjedisore me kod III.2.B "Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme, në selinë e ushtrimit të aktivitetit". Në preventivin e punimeve është përcaktuar vetëm zëri transport në distancë deri 7 km, i cili mund të kryhet nga kamionë të cilët licencohen për këtë qëllim. Bazuar në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", licenca sipas kodit të mësipërm specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme, veprimtari e cila nuk është objekt i kontratës.

	- Ekskavator me goma dhe fadromë me goma, ndërkohë që në preventivin e punimeve ka vetëm punime me ekskavator me zinxhirë.
Kriteri:	Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 77, pika 1.
Ndikimi:	Përcaktimi i kritereve të pa studiuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, mund të ndikojë në pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit.
Shkaku	Përcaktimi i kritereve pa i argumentuar ato.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Njësia e prokurimit apo komisioni i ngarkuar, duhet të argumentojnë kriteret e kualifikimit që vendosen në procedurat e prokurimit, duke patur në konsideratë natyrën dhe volumin e kontratës, me synim shmangien e kritereve që krijojnë kufizime për pjesëmarrësit, si dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të lartë të biznesit të vogël e të mesëm.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. F. B., në cilësinë e specialistit të fushës, anëtar i Njësisë së Prokurimit.

3. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit "Përmirësim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, Rr. 13 Bibilenjtë, Rr. Abedin Dino, …".

Fondi limit për këtë procedurë prokurimi është përllogaritur me vlerë 11,044,530 lekë. Si referencë janë marrë çmimet e manualeve të punimeve të ndërtimit. Dokumentet e tenderit janë hartuar nga njësi e prokurimit, miratuar me datë 14.12.2021. tenderi është zhvilluar me datë 06.08.2021 dhe ka marrë pjesë vetëm një operator ekonomik, i cili është shpallur fitues me vlerë të ofertës 10,310,233 lekë. Kontrata është nënshkruar me numër 274 prot., datë 20.08.2021.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: "Përmirësim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, Rr. 13 Bibilenjtë, Rr. Abedin Dino, …"		
1. Urdhër Prokurimi nr. 35, datë 09.07.2021 2. **Lloji i Procedurës së Prokurimit** (E hapur, e thjeshtëzuar)	**3. njësia e prokurimit** A. V. (juriste) F. B. (inxhinier) E. Ll.	**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 35/1, datë 09.07.2021.** K. K. E. I. N. Ç.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 11,044,530 lekë	6. **Oferta Fituese (pa TVSh)** 10,310,233 lekë	**7. Diferenca me fondin Limit (pa TVSh)** 734,297 lekë
8. Data e hapjes së ofertave 06.08.2021	**9. Burimi i Financimit** Buxheti i shoqërisë	**10. Operatorët Ekonomikë** 1. BOE "I./D & N. 86" ShPK me ofertë me vlerë 10,310,233 lekë. b. S'kualifikuar –0 OE
11. Ankimime -	**12. Përgjigje e ankesës nga AK**	**13. Përgjigje ankesës nga KPP** -
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. lidhje e kontratës Nr. 274, datë 20.08.2021	**15. Vlera e kontratës (me TVSh)** - 12,372,279 lekë	**16. Likuiduar** - lekë Pa likuiduar: - lekë

17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi` Vlera me TVSH Vlera pa TVSH	**18. Afati i kontratës në ditë.** Parashikuar 90 ditë Zbatuar: 90 ditë		**19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë** -	
20. Mbikëqyrësi i punimeve "M. S." ShPK	**Licencë nr. MK 1.**	Kontrata nr. 276, datë 25.08.2021	**Likuiduar .....**	**Pa likuiduar lekë**
21. Kolaudatori i punimeve -	**Licencë nr.** -	**Kontrata -**	**Likuiduar .....**	**Pa likuiduar .....**
22. Aktkolaudimi -	**23. Akti i marrjes në dorëzim.** -		**24. Fletë Hyrja** Nr..... Datë.....Lekë	

Nga auditimi i kësaj procedure janë konstatuar mangësi, të cilat paraqiten si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Mangësi në përllogaritjen e fondit limit.
Situata:	Fondi limit është bazuar në preventivin e hartuar nga z. F. B.. Çmimet janë referuar në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre". Miratimi i realizimit të investimit është bërë nga Këshilli i Administrimit të UK Sarandë me nr. 11, datë 24.11.2021. Nga verifikimi i çmimit të aplikuar për disa zëra punimesh konstatohet: - Sipas zërit "Pusete kontrolli 1x1x1.5, me kapak gize, çdo 30 m", është aplikuar analiza (2.575), me çmim 80,883 lekë/copë, për 29 puseta. Kjo analizë çmimi i referohet ndërtimit me tulla të plota, ndërsa nga verifikimi i dokumentacionit të projektit të zbatimit rezulton se kemi të bëjmë me ndërtim puseta prej betoni. Nga përllogaritja e kostos për pusetë betoni monolite me kapak gize, rezulton çmimi 74,718 lekë. Sipas këtij zëri, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 177,355 lekë [29 copë (80,833 lekë – 74,718 lekë)]. Duke marrë në konsideratë faktin se nga konkurrenca në procedurën e prokurimit, kontrata është nënshkruar me vlerë 10,310,233 lekë, krahasuar me fondin limit me vlerë 11,044,530 lekë, diferenca në fondin limit konsiderohet se nuk ka dhënë efekt.
Kriteri:	VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Pika 2.
Ndikimi:	Nuk ka patur ndikim, si pasojë e uljes së vlerës së kontratës.
Shkaku	Mos përcaktimi i saktë i çmimit të referencës.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Komisionet e përllogaritjes së fondit limit, duhet të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përafërt, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. F. B., në cilësinë e specialistit të fushës, anëtar i Njësisë së Prokurimit.

4. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit "Përmirësim i KUZ Sarandë (Sarandë ITUN, Bypas dhe vendosje saraçineska manovrimi, ajrues)".

Fondi limit për këtë procedurë është përllogaritur me vlerë 14,518,689 lekë. Si referencë janë marrë çmimet e manualeve të punimeve të ndërtimit. Dokumentet e tenderit janë miratuar me datë 15.05.2020. Për dokumentet e tenderit ka patur ankimim nga një OE. Hapja e ofertave është bërë me datë 10.07.2020. Në tender kanë marrë pjesë 6 OE, nga të cilët janë s'kualifikuar 5 OE. Është shpallur fitues dhe është lidhur kontrata nr. 348 prot., datë 10.08.2020 OE "H.", me vlerë të ofertës 12,913,075 lekë.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

<table>
<tr><th colspan="5">Procedura e Prokurimit: "Përmirësim I KUZ Sarandë (Sarandë ITUN, Bypas dhe vendosje saraçineska manovrimi, ajrues)".</th></tr>
<tr><td colspan="2">1. Urdhër Prokurimi nr. 25, datë 15.05.2020
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit
(E hapur, e thjeshtëzuar)</td><td colspan="2">3. njësia e prokurimit
A. V.(juriste)
F. B. (inxhinier)
N. Ç. (inxhinier)</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 25/1, datë 15.05.2020.
K. K.
E. I.
A. B.</td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Fondi Limit (pa TVSh)
14,518,689 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa TVSH)
12,913,075 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin Limit (pa TVSh)
1,605,614 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Data e hapjes së ofertave
10.07.2020</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit
Buxheti i shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
1. BOE "T.-D & 6. P." ShPK me ofertë me vlerë 7,509,800 lekë.
2. OE "M./S", me ofertë me vlerë 9,399,999 lekë.
3. OE "H.", me ofertë me vlerë 12,913,075 lekë.
4. OE "K.", me ofertë me vlerë 13,025,000 lekë.
5. OE "S. 2000", me ofertë me vlerë 13,025,000 lekë.
6. OE "K.", me ofertë me vlerë 13,814,200 lekë.
b. S'kualifikuar –5 OE</td></tr>
<tr><td colspan="2">11. Ankimime
-</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK</td><td>13. Përgjigje ankesës nga KPP
-</td></tr>
<tr><td colspan="5">b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td colspan="2">14. lidhje e kontratës
Nr. 348, datë 10.08.2020</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me TVSh)
- 15,945,690 lekë</td><td>16. Likuiduar
- lekë
Pa likuiduar:
- lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi`
Vlera me TVSH 15,476,700 lekë
Vlera pa TVSH 12,897,250 lekë</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës në ditë.
Parashikuar 30 ditë
Zbatuar: 60 ditë</td><td>19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë
-Nr. 348/1 prot., datë 24.08.2020</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
"F. S." ShPK</td><td>Licencë nr. MK 3.</td><td>Kontrata nr. 361, datë 20.08.2020</td><td>Likuiduar .....</td><td>Pa likuiduar lekë</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve -A. T.</td><td>Licencë nr. -MK 1.</td><td>Kontrata – Nr. 361/1 prot., datë 20.08.2020</td><td>Likuiduar .....</td><td>Pa likuiduar .....</td></tr>
</table>

22. Aktkolaudimi -datë 01.12.2020	23. Akti i marrjes në dorëzim (i përkohshëm). - datë 01.12.2020	24. Fletë Hyrja Nr..... Datë.....Lekë

Nga auditimi i kësaj kontrate janë konstatuar mangësi, të cilat paraqiten si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Janë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.
Situata:	Procesverbali për miratimin e dokumenteve të tenderit është mbajtur me datë 15.05.2020. Për kriteret e vendosura është paraqitur ankesë nga OE "I." SHPK, me shkresë nr. _, datë 22.05.2020. Për përmirësimin e kritereve është hartuar shtojca nr. 1, e cila është ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimeve. Në këtë shtojcë janë marrë në konsideratë disa çështje, por jo në lidhje me vendosjen e disponimit të ngjeshësit hidroelektrik, apo të kriterit që pjesëmarrësit janë të detyruar të marrin pjesë në një takim që zhvillohet ngë shoqëria, në lidhje me projektin. Ndër të tjera janë vendosur kritere si më poshtë: - Disponimi ose marrja me qira e një ngjeshësi hidroelektrik (ndërkohë që është kërkuar edhe rrul ngjeshës). - Kërkohet disponimi ose marrja me qira ekskavator me zinxhir si dhe skrep/fadromë, ndërkohë që punimet e gërmimit i përkasin vetëm ekskavatorit me goma. - Është kërkuar pjesëmarrja në takim në ambientet e shoqërisë. Mos pjesëmarrja është përcaktuar si kriter s'kualifikues, ndërkohë që nuk kemi të bëjmë me një kontratë të ndërlikuar për të cilën është domosdoshmëri njohja me objektin.
Kriteri:	-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (shfuqizuar), neni 46 - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 26, pika 5.
Ndikimi:	Përcaktimi i kritereve të pa studiuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, mund të ndikojë në pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit.
Shkaku	Përcaktimi i kritereve pa i argumentuar ato.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Njësia e prokurimit apo komisioni i ngarkuar, duhet të argumentojnë kriteret e kualifikimit që vendosen në procedurat e prokurimit, duke patur në konsideratë natyrën dhe volumin e kontratës, me synim shmangien e kritereve që krijojnë kufizime për pjesëmarrësit, si dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të lartë të biznesit të vogël e të mesëm.

Ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. A. V., z. F. B. dhe z. N. Ç..

5. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e procedurave të prokurimit "Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë".

Fondi limit për këtë procedurë është përllogaritur me vlerë 32,039,144 lekë. Çmimet kanë si referencë manualet e punimeve të ndërtimit. Për dokumentet e tenderit hartuar nga njësia e prokurimit, APP ka rekomanduar disa përmirësime për kriteret e vendosura. Ofertat janë hapur me

datë 05.11.2020. Në tender kanë marrë pjesë 5 OE, nga të cilët janë s'kualifikuar 4. Është shpallur fituese oferta e OE "I. G. & 2.", me vlerë 31,821,600 lekë. Për procesin e vlerësimit ka patur ankimime të cilat janë shqyrtuar dhe u është kthyer përgjigje. Kontrata është nënshkruar me nr. 590 prot., datë 03.12.2020.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

<table>
<tr><th colspan="5">Procedura e Prokurimit: "Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë".</th></tr>
<tr><td colspan="2">1. Urdhër Prokurimi nr. 47/1, datë 16.09.2020
2. lloji i Procedurës së Prokurimit
(E hapur)</td><td colspan="2">3. njësia e prokurimit
A. V. (juriste)
F. B. (inxhinier)
N. Ç. (inxhinier)</td><td>4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 47/1, datë 16.09.2020.
K. K.
A. C. (AKUM)
A. B.</td></tr>
<tr><td colspan="2">5. Fondi Limit (pa TVSh)
32,039,144 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa TVSh)
31,821,600 lekë</td><td>7. Diferenca me fondin Limit (pa TVSh)
217,544 lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">8. Data e hapjes së ofertave
05.11.2020</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit
Financim nga AKUM</td><td>10. Operatorët Ekonomikë
1. Shoqëria "Sh." me ofertë me vlerë 22,204,150 lekë.
2. OE "M./S" ShPK me ofertë me vlerë 25,169,020.
3. Shoqëria "F.' me vlerë oferte 22,204,150 lekë.
4. Shoqëria "I. G. & 2. K." me vlerë oferte 31,821,600 lekë.
5. England (nuk ka paraqitur ofertë ekonomike)
b. S'kualifikuar –4 OE</td></tr>
<tr><td colspan="2">11. Ankimime
- M./S SHPK me shkresë nr. 521 prot., datë 12.11.2020</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK
- Shkrese 521/1, datë 16.11.2020</td><td>13. Përgjigje ankesës nga KPP
-</td></tr>
<tr><td colspan="5">b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td colspan="2">14. lidhje e kontratës
Nr. 590, datë 03.12.2020</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me TVSh)
- 38,185,920</td><td>16. Likuiduar
- lekë
Pa likuiduar:
- lekë</td></tr>
<tr><td colspan="2">17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi`
Vlera me TVSH 31,790,600
Vlera pa TVSH.....</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës në ditë.
Parashikuar 180 ditë
Zbatuar: 280</td><td>19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë
100 ditë. Amendament nr. 174/1 prot., datë 09.06.2020.</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
"N.T. S." ShPK</td><td>Licencë nr. MK 1.</td><td>Kontrata nr. 921, datë 09.12.2020</td><td>Likuiduar .....</td><td>Pa likuiduar lekë</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve -M. S.</td><td>Licencë nr. MK 1.</td><td>Kontrata nr.410, datë 20.12.2021</td><td>Likuiduar .....</td><td>Pa likuiduar .....</td></tr>
<tr><td colspan="2">22. Aktkolaudimi
21.12.2021</td><td colspan="2">23. Akti i marrjes në dorëzim.
21.12.2021</td><td>24. Fletë Hyrja
Nr..... Datë.....Lekë</td></tr>
</table>

Nga auditimi i kësaj procedure prokurimi, janë konstatuar mangësi të cilat paraqiten si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Mangësi në përllogaritjen e fondit limit.
Situata:	Miratimi i financimit dhe vënia në dispozicion të fondit është bërë sipas shkresës së AKUM nr. 1866 prot., datë 23.07.2020. Fondi limit për procedurës së prokurimit "Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë" është përcaktuar me vlerë 32,039,144 lekë, mbi bazën e preventivit të paraqitur nga Shoqëria "I./D" SHPK. Çmimet e zërave të punimeve janë bazuar në manualet e çmimeve të punimeve të ndërtimit të vitit 2015. Nga analizimi i preventivit konstatohet se sipas zërit 3.An/1t "F.V tubo të brinjëzuar HDPE SN-8, DN 315", është hartuar analizë e veçantë me çmim të përcaktuar 1,960 lekë për ml. Në këtë analizë nuk është përfshirë furnizimi dhe vendosja e rërës për mbrojtjen e tubove. Bazuar në manualin përkatës, me zbritjen e rërës (llogaritur zë më vehte), çmimi do të ishte 1,806 lekë/ml. Sasia e tubacionit të parashikuar sipas këtij zëri është 1057 ml. Sa më sipër, në fondin limit është përfshirë më shumë vlera 162,778 lekë [1057 ml x (1960 lekë – 1806 lekë)]. Nga auditimi i zbatimit të kontratës së punimeve për këtë objekt, nuk rezultoi se zëri shtresë rëre për mbrojtjen e tubit është likuiduar më vehte, duke mos prodhuar efekte financiare.
Kriteri:	VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Pika 2.
Ndikimi:	Nuk ka patur ndikim, si pasojë e uljes së vlerës së kontratës.
Shkaku	Mos përcaktimi i saktë i çmimit të referencës.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Komisionet e përllogaritjes së fondit limit, duhet të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përafërt, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. F. B., në cilësinë e specialistit të fushës, anëtar i Njësisë së Prokurimit.

2. Titulli i gjetjes:	Janë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.
Situata:	Për dokumentet e tenderit të hartuar nga Njësia e Prokurimit, APP ka dërguar e-mail të datës 02.10.2020, për përmirësimin e kritereve të vendosura për kualifikimin e operatorëve ekonomikë. Disponim licencë sipas pikës N.P 12 "Punime të inxhinierisë mjedisore". <u>Nuk është hequr kërkesa që OE të këtë drejtues teknik për pozicionin inxhinier mjedisi.</u> Nuk është hequr kriteri për disponim licence sipas kategorisë NP.12, klasifikimi A, "Punime të inxhinierisë së mjedisit". Është vendosur kriteri për disponimin e lejes mjedisore me kod III.2.B "Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme, në selinë e ushtrimit të aktivitetit". Në preventivin e punimeve është përcaktuar vetëm zëri transport në distancë deri 7 km, i cili mund të kryhet nga kamionë të

	cilët licencohen për këtë qëllim. Bazuar në VKM nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta", licenca sipas kodit të mësipërm specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme, veprimtari e cila nuk është objekt i kontratës. Nuk është hequr kriteri i cili ka të bëjë me numrin e punonjësve manovrator i cili është modifikuar. Është përcaktuar, nëse mjetet janë me qira, atëherë për manovratorët që janë jashtë shoqërisë që mund të kontraktohen të paraqesin listë pagesat e tyre personale. Nuk është hequr përcaktimi për mekanizimin bobcat, me përcaktimin thjesht të një mekanizmi që kryen të njëjta procese pune. Sa i përket makineri pajisje janë kërkuar që OE të kenë në pronësi ose me qira skrep, 2 ekskavator me goma, një sharrë për punim metali, depozitë për grumbullim materiale, pirun dhe helikopter nivelimi. Punimet e gërmimit janë parashikuar me ekskavator me zinxhirë dhe në asnjë rast me ekskavator me goma. Punimet e realizimit të sipërfaqeve të lëmuara me helikopter nuk janë parashikuar në preventiv, madje seksionet tërthore të punimeve të betonit, nuk i përkasin dimensioneve të parashikuara për përdorimin e këtij mjeti.
Kriteri:	-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (shfuqizuar), neni 46. - VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 26, pika 5.
Ndikimi:	Përcaktimi i kritereve të pa studiuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, mund të ndikojë në pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit.
Shkaku	Përcaktimi i kritereve pa i argumentuar ato.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Njësia e prokurimit apo komisioni i ngarkuar, duhet të argumentojnë kriteret e kualifikimit që vendosen në procedurat e prokurimit, duke patur në konsideratë natyrën dhe volumin e kontratës, me synim shmangien e kritereve që krijojnë kufizime për pjesëmarrësit, si dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të lartë të biznesit të vogël e të mesëm.

Ngarkohet me përgjegjësi specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit znj. A. V., z. F. B. dhe z. N. Ç.

3. Titulli i gjetjes:	Vlerësimi i ofertave nuk është bërë duke patur në konsideratë kriterin "çmimi më i ulët".
Situata:	Në tender kanë marrë pjesë 5 OE nga të cilët një OE nuk ka paraqitur ofertë financiare. Janë s'kualifikuar 4 OE. OE "M./S" SHPK është s'kualifikuar me arsyetimin si më poshtë:

	-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE rezulton se mungon 1 (një) kamionçinë, pasi mjeti SR. B i mbaronte kontrata në datë 11.12.2020 në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.8 a). Për përmbushjen e kësaj pike është paraqitur dhe dokumentacion për mjetin AA. TE me të cilin OE ka kontratë qiraje të vlefshme me shoqërinë "A.-B. 2.", por rezulton se ky mjet është me tonazh mbi 1.5 ton dhe në të gjithë dokumentacionin shoqërues ky mjet figuron si mjet i llojit "Kamion" dhe jo mjet i llojit "ATP" me të cilën përcaktohet kamionçina. Sa më sipër, konstatohet se OE e ka përmbushur kriterin pasi ka paraqitur dy automjete kamionçinë si dhe dy të tjera që pavarësisht përcaktimit kamionçinë apo jo, kanë tonazh të vogël. Kontrata për njërën kamionçinë përfundon 1 muaj pas vlerësimit të ofertave <u>dhe nuk ishte vendosur kriter që kontrata duhet të mbulonte gjithë periudhën e realizimit të punimeve</u>. Kontrata përkatëse parashikon ripërtëritjen e saj nëse kërkohet nga palët. Gjithsesi nga ana e KVO për këtë rast duhet të kërkoheshin sqarime. - "*Për mjetin Autobot shoqëria ka paraqitur dokumentacionin si certifikatë pronësie, SGS, siguracion, lejeqarkullimi, certifikatë transporti në të cilat ky mjet nuk figuron i llojit "ATV", por mjetet autobot shoqërohen dhe me pasaporte verifikimi lëshuar nga drejtoria e përgjithshme e meteorologjisë për konfirmimin e llojit të mjetit dhe ngarkesës që mban ky mjet, për më tepër në foto ky mjet rezulton të jetë një autovinç ngarkuar në karroceri një depozite uji*". Sa më sipër konstatohet se OE ka paraqitur një automjet i cili referuar dokumentacionit nuk konsiderohet autobot. Gjithsesi, theksojmë se <u>përdorimi i autobotit për zbatimin e punimeve të kësaj kontrate është vetëm për procesin e lagies së rrugëve për eliminimin e pluhurave në ajër</u> dhe jo për punime të cilat kërkojnë hedhje të ujit me presion, kështu që procesin e kërkuar e realizon në mënyrën e duhur. Nga ana e KVO, mund konsiderohej devijim i vogël, pasi diferenca e vlerës së ofertave ndërmjet këtij OE me atë fitues është e konsiderueshme dhe kriteri kryesor i procedurës së prokurimit është "Çmimi më i ulët". -"*Për mjetin Ekskavator me Goma, shoqëria ka dorëzuar kontratën e qirasë që ka me z. M. Q. dhe faturat e zhdoganimit. Kërkohet në legjislacionin shqiptar që të gjitha mjete qe janë me goma dhe lëvizin në rruge automobilistike të regjistrohen në regjistrat publik dhe të pajisen me dokumentacionin përkatës. Objekti që është prokuruar do të realizohet në lagje ekzistuese të qytetit të Sarandës ku shume pjesë që do të kryhet ndërhyrja ka rrugë automobilistike. Pra mjeti i kërkuar është pa certifikatë pronësi, kontroll teknik, taksa dhe siguracion*". Sa më sipër, konstatohet se OE e ka përmbushur kriterin pasi ekskavatori i paraqitur është me goma dhe nuk ka patur kërkesa të tjera të veçanta. Sa i takon dokumentacionit, ekskavatori i paraqitur konsiderohet mekanizëm dhe nuk i nënshtrohet regjistrimit dhe pajisjes më dokumentacion qarkullimi. Sa i përket argumentit se punimet realizohen në lagje të Qytetit të Sarandës argumenti nuk qëndron për faktin se në kërkesat përkatëse është edhe disponimi i mekanizmit ekskavator me zinxhirë i cili po ashtu

	është i dëmshëm për shtresat rrugore asfaltike. Pavarësisht fakteve të mësipërme, OE "M./S" SHPK ka paraqitur edhe një ekskavator tjetër me goma me targë A. -"*Për mjetin "Sharrë për Punim metali" për këtë mjet OE nuk ka dorëzuar dokumentacion. Në kontratën e qirasë që OE ka me shoqërinë "E. C." figuron mjeti të jetë makineri prerëse metalesh me kontroll numerik e cila sipas fotos të paraqitur është e stacionuar në ambiente dhe jo sharrë punimi metali e cila është e lëvizshme dhe përdorshme në terren ku do të realizohet objekti*". Sa më sipër sqarojmë se, në dokumentet e tenderit nuk ka përcaktim nëse sharra do të jetë e lëvizshme apo jo. Nuk është marrë në konsideratë pajisja tranxhë prerëse e paraqitur nga OE sipas faturës datë 26.12.2008. Gjithsesi proceset e punës së kontratës nuk përfshijnë punime me prerje hekurash dhe kërkesa është e pa argumentuar. Edhe nëse do të kishte procese të tilla, është në organizimin e punës së kontraktorit gjatë zbatimit të kontratës, ku do e realizojë një proces të tillë, në kantierin e ndërtimit, apo në vendndodhjen e sharrës. Nëse marrim në konsideratë dokumentacionin e paraqitur nga BOE ofertues, sipas kontratës së qirasë me "I. M." SHPK, nuk mund të identifikohet nëse mjeti prerës i metaleve është i lëvizshëm apo jo. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, pas shqyrtimit të dokumentacionit, ka marrë vendimin e datës 16.11.2020, për mos pranimin e ankimimit, duke konsideruar të realizuar vetëm kriterin e disponimit të automjeteve kamionçinë. Argumentimi për mos pranimin e plotësimit të kriterit për disponim autobot, ekskavator me goma dhe sharrë prerëse, janë pothuajse të njëjta me ato të paraqitura nga KVO. OE është njoftuar mbi vendimin për mospranimin e ankesës me shkresë nr. 521/1 prot., datë 16.11.2020.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (shfuqizuar), neni 46. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 26, pika 5. Ligji nr. 9643, datë 20.12.2006 "Për prokurimin publik", (i shfuqizuar) Neni 53, pika 4.
Ndikimi:	Realizim i procedurës pa marrë në konsideratë parimin e ekonomicitetit.
Shkaku	Mos marrja në konsideratë e kriterit të çmimit më të ulët, si dhe mos shfrytëzimit të mundësisë për konsiderimin e disa shmangieve si devijim i vogël.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	UK SHA Sarandë, duhet të marrë masa për trajnim të vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen në realizimin e procedurave të prokurimit, si sa i takon procesit të përllogaritjes së fondit limit, hartimin e kritereve kualifikuese, ashtu dhe shqyrtimin e vlerësimin e ofertave, me synim realizimin e procedurave të prokurimit, duke respektuar parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

Ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga z. K. K., znj. A. C. (AKUM) dhe z. A. B., si dhe KSHA i përbërë nga znj. L. Gj., z. E. I. dhe z. C. A.

6. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit "Mirëmbajtje dhe riparime të elektropompave të stacioneve të pompimit të UK Sarandë").

Fondi limit për këtë procedurë është përllogaritur me vlerë 7,960,702 lekë. Çmimet janë bazuar në kontratat e ngjashme, por dhe na ato të tregut. Ofertat janë hapur me datë 30.07.2021. Në tender kanë marrë pjesë 2 OE, nga të cilët është s'kualifikuar 1 OE, i cili nuk ka paraqitur ofertë financiare. Është shpallur fitues oferta e OE "A." SHPK, me vlerë 7,868,200 lekë. Kontrata është nënshkruar me nr. 271 prot., datë 13.08.2021.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

<table>
<tr><th colspan="5">Procedura e Prokurimit: "Mirëmbajtje dhe riparime të elektropompave të stacioneve të pompimit të UK Sarandë".</th></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi nr. 27, datë 09.06.2021
2. lloji i Procedurës së Prokurimit
(E hapur, e thjeshtë)
Marrëveshje kuadër</td><td colspan="2">3. njësia e prokurimit
A. V. (juriste)
A. K.
A. M. (inxhinier)</td><td colspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 27/1, datë 09.06.2021.
K. K.
E. I.
N. Ç.</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)
7,960,702 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa TVSh)
7,868,200 lekë</td><td colspan="2">7. Diferenca me fondin Limit (pa TVSh)
92,502 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së ofertave
30.07.2021</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit
Buxheti i shoqërisë</td><td colspan="2">10. Operatorët Ekonomikë
1. OE "A." ShPK me ofertë me vlerë 7,868,200 lekë.
2. OE "A." nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
b. S'kualifikuar –1 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime
-</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK</td><td colspan="2">13. Përgjigje ankesës nga KPP
-</td></tr>
<tr><td colspan="5">b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td>14. lidhje e kontratës
Nr. 271, datë 13.08.2021</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me TVSh)
- 9,441,840 lekë</td><td colspan="2">16. Likuiduar
- lekë
Pa likuiduar:
- lekë</td></tr>
<tr><td>17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi`
Vlera me TVSH
Vlera pa TVSH</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës në ditë.
Parashikuar 365 ditë
Zbatuar: 365 ditë</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë
-</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve
-</td><td>Licencë nr.
-</td><td>Kontrata nr.
-</td><td>Likuiduar
.....</td><td>Pa likuiduar
lekë</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve
-</td><td>Licencë nr.
-</td><td>Kontrata -</td><td>Likuiduar
.....</td><td>Pa likuiduar
.....</td></tr>
<tr><td>22. Aktkolaudimi
-</td><td colspan="2">23. Akti i marrjes në dorëzim.
-</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja
Nr..... Datë.....Lekë</td></tr>
</table>

Nga auditimi i kësaj procedure janë konstatuar mangësi të cilat paraqiten si më poshtë:

1. Titulli i gjetjes:	Janë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me volumin e kontratës.

Situata:	Për këtë procedurë prokurimi, nga APP është kërkuar rishikimi i kriterit të disponimit të licencës profesionale "NP-7A, Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje". Ky kriter është ndryshuar duke e cilësuar "NP-7A, Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje". Nga APP cilësohet se kjo licencë nuk lidhet ngushtë me objektin e kontratës. Theksojmë se licencimi i përket realizimit të punimeve në sisteme dhe linja të ujësjellësave, veprave të kullimit etj., për të cilat kërkohet një kualifikim i veçantë. Sa i përket riparimit pompave, ato mund të riparohen edhe nga kompani të cilat ushtrojnë aktivitet vetëm në këtë fushë dhe jo në atë të punimeve civile. Bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, licencimi sipas pikës NP7, përcakton: "*Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura".*
Kriteri:	- Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 77, pika 1. - VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 45.
Ndikimi:	Përcaktimi i kritereve të pa studiuara dhe jo në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, mund të ndikojë në pjesëmarrjen e OE në procedurën e prokurimit.
Shkaku	Përcaktimi i kritereve pa i argumentuar ato.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Njësia e prokurimit apo komisioni i ngarkuar, duhet të argumentojnë kriteret e kualifikimit që vendosen në procedurat e prokurimit, duke patur në konsideratë natyrën dhe volumin e kontratës, me synim shmangien e kritereve që krijojnë kufizime për pjesëmarrësit, si dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të lartë të biznesit të vogël e të mesëm.

Ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga znj. A. V., z. A. M. dhe z. A. K..

7. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit "Blerje dy automjete për nevojat e shoqërisë".

Për blerjen e automjeteve është përllogaritur fondi limit me vlerë 5,187,326 lekë. Tenderi është zhvilluar me datë 10.06.2019. Në tender kanë marrë pjesë 3 OE, nga të cilët është s'kualifikuar 1. Automjetet e kërkuara janë kamionçina, me vit prodhimi jo më herët se viti 2014. Procedura e aplikuar është kërkesë për propozim.

1. Titulli i gjetjes:	Nuk është bërë ftesë për numrin e duhur të OE.

Situata:	Procedura e prokurimit, për blerjen e dy automjeteve kamionçina është aplikuar "Kërkesë për propozim". Janë bërë ftesa për pjesëmarrje në procedurën e auditimit për tre OE, të cilët operojnë në fushën e tregtimit të automjeteve. Bazuar në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i shfuqizuar, neni 34, pika 1, kërkohet që për pjesëmarrje në procedura të tilla duhen bërë ftesa për të paktën 5 operatorë ekonomikë.
Kriteri:	-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (shfuqizuar), neni 46, neni 34, pika 1.
Ndikimi:	Nuk konsiderohet se ka patur ndikim, pasi pavarësisht numrit të ftesave, pjesëmarrja e operatorëve të tjerë është e lire, si dhe në tender kanë marrë pjesë 4 OE.
Shkaku	Mos respektimi i kërkesave ligjore.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Njësia e prokurimit, sipas rastit dhe procedurave, të respektojë kërkesat ligjore për njoftimin e operatorëve ekonomikë minimalisht në numrin e përcaktuar, me synim sigurimin e një pjesëmarrje sa më të gjerë. Operatorët ekonomikë që ftohen të marrin pjesë në këto procedura, duhet të ndryshohen sa më shumë të jetë e mundur.

Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. A. V., z. A. M. dhe z. F. B.

2. Titulli i gjetjes:	Kualifikim i OE, pa plotësuar dokumentacionin e kërkuar.
Situata:	Në specifikimet teknike të automjeteve, pjesë e dokumenteve të tenderit përcaktohet se ofertuesi duhet të paraqesë dokumente të automjeteve si, libër makine, leje qarkullimi, fotografi në të cilat të shikohen qartë të dhënat e mjetit dhe gjendja e tij estetike. Nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, konstatohet se operatori ekonomik shpallur fitues, nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentacioni i kërkuar si më sipër. Në kushtet e mos plotësimit të këtyre kërkesave, operatori ekonomik duhet të ishte s'kualifikuar.
Kriteri:	-Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (shfuqizuar), neni 46.
Ndikimi:	Kualifikimi i OE, me mangësi të tilla nuk jep garanci se OE ka mundësi për realizimin e kontratës, sipas specifikimeve teknike.
Shkaku	Mos analizimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE në procedurën e prokurimit.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Komisionet e vlerësimit të ofertave duhet të analizojnë me detaje dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, jo vetëm sa i takon sigurimit se ka aftësitë teknike për të realizuar kontratën, por edhe nëse produkti i paraqitur i plotëson specifikimet teknike të parashikuara, me synim shmangien e riskut të dështimit të kontratave dhe mos realizimit në kohë të tyre.

Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga z. K. K., z. A. B. dhe z. E. I.

8. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e kontratës "Ndërtim i kanalizimeve të ujërave të zeza në Bllokun mbi rrugën nr.5, Lagje nr. 3, Sarandë".

Kontrata e punimeve civile "Ndërtim i kanalizimeve të ujërave të zeza në Bllokun mbi rrugën nr.5, Lagje nr. 3, Sarandë", është nënshkruar me nr. 590 prot., datë 03.12.2020, me Kontraktorin "JV I. G. & 2. K.", me vlerë 31,821,600 lekë. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 180 ditë kalendarike. Kontrata bazë është amenduar me nr. 174/1 prot., datë 09.06.2021, sipas të cilit është shtyrë afati i fillimit të punimeve për një periudhë 100 ditë. Shtyrja e afatit është argumentuar bazuar në vonesat e shkaktuara për shkak të problemeve me pronat në të cilat kalojnë linjat e tubacioneve, si dhe me administrimin e kuotave/disniveleve midis pusetave sipas skemës funksionale që ka dhënë projekti. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur shoqëria "N. S." SHPK me të cilin është nënshkruar kontrata me nr. 921 prot., datë 09.12.2020.
Bazuar në njoftimin përkatës, procesverbalin e piketimit, aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, punimet kanë filluar me datë 09.12.2020.

Bazuar në procesverbalin mbi preventivin e përmirësuar, janë bërë ndryshime të volumeve në shtesa dhe pakësime, disa nga të cilat paraqiten si më poshtë:
Tabela nr. 5

Analiza	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia kontratë	Sasia e rishikuar	Çmimi (lekë)	Diferenca plu/minus (Lekë)
2.426/3	Prishje shtresë betoni	m^3	54	332	3,500	973,000
2.47/an	Gërmim shkëmb mesatar me ekskavator me zinxhirë	"	3339	3480	1,900	267,000
3.An1t	F.V tubo të brinjëzuar HDPE SN 8, DN 315	ml	1057	1230	2,000	346,000
	F.V tubo të brinjëzuar HDPE SN 8, DN 250	"	1783	930	1,300	-1,108,900
	F.V tubo të brinjëzuar HDPE SN 8, DN 200	"	1274	980	1,000	-294,000
An	Kapak gize d 62.5 version i rëndë	kg	4320	8380	300	1,218,000
An	Kapak gize 0.9 x 0.9, version mesatar	"	1160	525	300	-190,500
3.244	Struktura monolite betoni C 20/25 (shtresë në rrugë)	m^3	56	268	11,000	2,332,000
	Struktura monolite betoni C 20/25 (intersektimet)	"	66	14	11,000	-572,000
3.29	F.V hekur betoni Ø 3-5 mm	ton	1	16.7	170,000	2,669,000
3.288	F.V hekur betoni Ø > 12 mm	"	19	0.89	11,000	-199,210
An	F.V tubo të brinjëzuar HDPE SN 8 DN 160	ml	3407	1704	850	-1,447,550

Burimi: UK SHA Sarandë

Punimet që shtohen janë llogaritur me vlerë 8,796,400 lekë, ndërsa punimet që hiqen janë llogaritur me vlerë 8,765,400 lekë. Nga verifikimi i zërave të punimeve konstatohet se është zbritur shtim linje në sasinë 2677 ml. Është shtuar sasia e tubacioneve DN 315 me 173 ml, është zbritur sasia e DN 250 me 853 ml, është zbritur sasia e tubacionit DN 200 me 294 ml si dhe është zbritur sasia e tubacionit DN 160 me 1703 ml.
Gjatë zbatimit të kontratës janë likuiduar dy situacione të pjesshme dhe situacioni përfundimtar, i cili është certifikuar me vlerë 31,790,600 lekë pa TVSH.
Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur me datë 06.12.2021. Njoftimi i përfundimit të punimeve është bërë po në këtë datë.

Procesverbali i kolaudimit të punimeve është hartuar me datë 21.12.2021, nga shoqëria M. S., përfaqësuar nga z. T. S..
Procesverbali i marrjes së përkohshme në dorëzim është nënshkruar nga komisioni përkatës i përbërë nga z. A. C., z. F. B. dhe z. N. Ç.

1. Titulli i gjetjes:	Punime të pa realizuara dhe likuiduar, si dhe mos respektim I specifikimeve teknike.
Situata:	-Referuar dokumentacionit të dosjes teknike, në shtresën e betonit e cila është vendosur në rrugë, është vendosur zgarë hekuri me dimensione të hekurit 3-5 mm, me kuadratë (plegma) 15 cm x 15 cm. Ky dimension i hekurit është verifikuar vetëm në dy seksione anash shtresës së betonit. - Nga verifikimi i dokumentacionit teknik, kokat e pusetave në rrjetin me tubacion 315 mm, ishin parashikuar të ndërtoheshin prej betoni monolit, me dimensione 1.65 m x 1.65 m, me trashësi të mureve 20 cm. Nga verifikimi në objekt rezulton se nuk janë respektuar këto dimensione. Rreth kapakut prej gize është hedhur beton i pa armuar (armimi nuk është përfshirë në peshën e hekurit në situacion), me gjerësi rreth 30 cm rreth kapakut. Sasia e betonit për përgatitjen e tyre është më e vogël se ajo e parashikuar. Në lidhje me realizimin e pusetave si më sipër, ishte parashikuar që ato të ndërtoheshin me formë drejtkëndore me beton të derdhur në objekt. Nga verifikimi në terren rezulton që ato janë vendosur të parapërgatitura si dhe në formë rrethore. Sasia e betonit për përgatitjen e tyre është më e vogël se ajo e parashikuar, për të cilën nuk mund të përcaktohet diferenca për arsye se kemi të bëjmë me punime të cilat janë bërë të pa dukshme në elementët kryesor të tyre. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve nuk është reflektuar ky fakt, për miratimin e ndryshimit nëse ka qenë e nevojshme si dhe përcaktimin e çmimit për zë të ri punimi, duke qenë se vendosja e pusetave të parapërgatitura nuk është pjesë e preventivit.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7. Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17. Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 8.2 dhe 8.3.
Ndikimi:	Mund të ndikojë në qëndrueshmërinë e shtresave dhe funksionimin e kanalizimeve.
Shkaku	Mos zbatimi i projektpreventivit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	UK SHA Sarandë, të ngrejë një komision të veçantë për analizimin e kostos së tombinove rrethore të vendosura nga kontraktori duke reflektuar diferencën në vlerë krahasuar me tombinot e projektuara dhe vlera e diferencës të zbritet nga vlera e garancisë së kontratës së punimeve të bashkimit të operatorëve "JV I. G. & 2. K."SHPK. Po ashtu, të verifikohet dimensioni i zgarave të vendosura në shtresën e betonit.

Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve "N. S." SHPK, më përfaqësues ligjor z. E.N.

9. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e kontratës "Ndërtim stacioni i ri pus-çpimi në Vrion dhe lidhja me rrjetin kryesor transmetues".

Kontrata "Ndërtim stacioni i ri pus-çpimi në Vrion dhe lidhja me rrjetin kryesor transmetues", është nënshkruar me nr. 442 prot., datë 20.10.2020, me Kontraktorin "M./S" SHPK, me vlerë 9,404,900 lekë pa TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 45 ditë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria "K. C.", me të cilën është nënshkruar Kontrata datë 29.10.2020.
Bazuar në dokumentacionin në dispozicion fillimi i punimeve mban datën 12.11.2020. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe akti i piketimit janë mbajtur po në të njëjtën datë. Dosja teknike e objektit është plotësuar me dokumentacionin tekniko-ligjor. Bazuar në ditarin përkatës, punimet kanë filluar me datë 12.11.2020 dhe kanë përfunduar me datë 25.12.2020, brenda afatit të parashikuar në kontratë.
Njoftimi për përfundimin e punimeve mban datën 26.12.2020. Situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 9,404,900 lekë.
Akt kolaudimi është hartuar po në këtë datë nga z. A. P.. Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është hartuar me datë 26.12.2020, nga komisioni i përbërë nga z. F. B., z. A. C. dhe z. A. K.

1. Titulli i gjetjes:	Punime të likuiduara por të pa realizuara.
Situata:	Bazuar në dokumentacionin përkatës rezulton se për zërin b.1.14 "Pjesë speciale çeliku, Ø ~ 200 mm", është preventivuar dhe certifikuar sasia 950 kg. Në librezën e masave nuk është detajuar kjo sasi sipas elementëve përkatës, për përcaktimin e saktë të peshës. Nga verifikimi i disa zërave të punimeve në objekt, rezulton se për vendosjen e tubacionit Ø ~ 200 mm, janë parashikuar: - F.V brryl 90^0, 45^0 Ø – 200 mm. - F.V saraçineska çeliku me fllanxha Ø – 200. - F.V Valvula moskthimi Ø – 200. - F.V distancor. - F.V Nyje bashkuese. - F.V ventila çeliku me fllanxha (shkarkues + kontroll). I vetmi element i cili konsiderohet pjesë speciale çeliku, janë dado bullonet të cilat janë përdorur për lidhjen e fllanxhave, të cilët janë në sasi 48 copë me peshë 50 kg. Sasia 900 kg është certifikuar pa përcaktuar se cilëve elementë i përkasin. ***Vlera 270,000 lekë*** (900 kg x 300 lekë/kg) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik. Nga verifikimi i disa zërave të punimeve rezulton se është vendosur tubacion Ø – 200, në sasinë 28 ml ose 1,078 kg (3 ml është i pa vendosur, por gjendje në objekt). Sasia e certifikuar për këtë zë punimi është 43 ml, ose me peshë 1667.1 kg, nga ku rezulton diferenca 15 ml, ose 589 kg. ***Vlera 176,700 lekë*** (589 kg x 300 lekë/kg), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori M./S SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

	Në sheshin e stacionit të pompimit (pusit të cpimit), janë realizuar punime të shtrimit me çakëll, punime të cilat pretendohet se janë realizuar nga kontraktori. Nga verifikimi i dokumentacionit, nuk rezulton i reflektuar në ndonjë dokument realizimi i një procesi të tillë. Po ashtu, sa i përket lidhjes së tubacionit me ankerat e betonit, janë vendosur profile metalike, të cilat nuk përbëjnë pjesë speciale çeliku.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7. Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17. Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 8.2 dhe 8.3.
Ndikimi:	Është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 446,700 lekë.
Shkaku	Mos përllogaritje e saktë të peshës së pjesëve speciale dhe mos reflektim të duhur të gjatësisë së tubacionit të vendosur.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	UK SHA Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **446,000 lekë**, nga Kontraktori "M./S" SHPK**,** për punime të likuiduara port të pa realizuara.

Ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria "K. C.".

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar UK SHA Sarandë (M./S SHPK) është paraqitur observacioni me shkresë nr. 248/3 prot., të datës 15.08.2022, protokolluar në KLSH me nr. 384/5, datë 19.08.2022, ku janë paraqitur objeksionet si më poshtë:

<u>Pretendimi i subjektit:</u>
-Në lidhje me tubacionin Ø 200 mm, i cili rezulton i pa vendosur në sasinë 15 ml, nga ana e subjektit është paraqitur një dokument i datës 25.12.2020, i cili theson se sasia e tubacionit tëbetur do të merret në dorëzim nga UK SHA Sarandë. Ky dokument është nënshkruar nga sipërmarrësi, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi i shoqërisë z. A. C.
- Në lidhje me zërin b.1.14 "Pjesë speciale çeliku, Ø ~ 200 mm", pretendohet se sasia e rezultuar e pa vendosur i përket fiksimit të tubit në ankerat e betonit. Po ashtu theksohet se janë realizuar punime shtesë shtresë çakulli, në ambientet e stacionit të pompimit.

<u>Qëndrimi i Grupit të Auditimit:</u>
-Në lidhje me tubacionin në sasinë 15 ml, sqarojmë se dokumenti i paraqitur nuk përfaqëson dokument marrje në dorëzim, pasi nuk është paraqitur faturë e magazinimit. Gjithashtu theksojmë se, në pagesën e realizuar nuk përfshihet vetëm materiali, por edhe punëtoria për montimin, transporti etj. Në këto kushte nuk mund të konsiderohet se është argumentuar diferenca e tubacionit e konstatuar nga grupi i auditimit.
- Në lidhje me pjesët speciale, sqarojmë se profilet metalike të vendosura janë prej hekuri dhe jo pjesë speciale. Po ashtu sasia e vendosur është e pa konsiderueshme. Sa i përket punimeve të realizuara për shtresë çakulli, ato janë evidentuar nga grupi i auditimit gjatë verifikimit në objekt,

por ky punim nuk është evidentuar në asnjë dokument nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nuk është përshkruar në asnjë relacion, as sa i përket sasisë si dhe vendshtrimit, për të vërtetuar nëse këto punime janë kryer nga kontraktori.

10. Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e kontratës "Ndërtim i kafazit të shkallës me vetrata xhami të temperuar".

Kontrata "Ndërtim i kafazit të shkallës me vetrata xhami të temperuar" është nënshkruar me nr. 185prot., datë 06.05.2019, me Kontraktorin "2." SHPK, me vlerë 3,557,400 lekë. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 45 ditë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria "I." SHPK.

Kontrata përfshin punime për ndërtimin e kafazit të shkallëve me vetrata xhami si e temperuar ashtu edhe xham struktural i pa thyeshëm, veshje me alukobond, F.V dyer duralumin plastike me dopjo xham si dhe mbulesë me panel sandŵiç.

Punimet kanë filluar me datë 07.05.2019 dhe kanë përfunduar me datë 14.06.2019, në afatin e përcaktuar në kontratë.

Nga verifikimi i disa zërave të punimeve u konstatuan diferenca të punimeve të realizuara krahasuar me ato të certifikuara si më poshtë:

- Mbulim çatie me panele sandŵiç, certifikuar dhe likuiduar në sasinë 40 m^2. Nga verifikimi në objekt rezulton se është realizuar sasia 32 m^2, me një diferencë 8 m^2. ***Vlera 40,000 lekë*** (8 m^2 x 5,000 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "2." dhe përbën dëm ekonomik.

Punimet janë marrë në dorëzim të përkohshëm me datë 20.06.2019, nga komisioni i përbërë nga z. F. B., z. A. C. dhe z. E. B., i ngritur sipas Urdhrit nr. 185/1 prot., datë 20.06.2019.

Për kolaudimin e punimeve është përzgjedhur z. K. K.. Aktkolaudimi është hartuar me datë 25.06.2019.

1. Titulli i gjetjes:	Punime të likuiduara por të pa realizuara.
Situata:	Nga verifikimi i disa zërave të punimeve u konstatuan diferenca të punimeve të realizuara krahasuar me ato të certifikuara si më poshtë: - Mbulim çatie me panele sandŵiç, certifikuar dhe likuiduar në sasinë 40 m^2. Nga verifikimi në object rezulton se është realizuar sasia 32 m^2, me një diferencë 8 m^2. ***Vlera 40,000 lekë*** (8 m^2 x 5,000 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "2." dhe përbën dëm ekonomik.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7. Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17. Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 8.2 dhe 8.3.
Ndikimi:	Është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **40,000 lekë.**
Shkaku	Mos raportimi i saktë i sipërfaqes së realizuar.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	UK SHA Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **40,000 lekë**, nga Kontraktori "2." SHPK**,** për punime të likuiduara port të pa realizuara.

Ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i Punimeve Shoqëria "I." SHPK.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e kaluar, janë rekomanduar gjithsej 43 masa organizative, nga të cilat janë zbatuar 16 masa, janë zbatuar pjesërisht 2 masa, janë në proces zbatimi 18 masa dhe të pa realizuara janë 7 masa. Janë rekomanduar 5 masa shpërblim dëmi me vlerë 711,556 lekë, nga të cilat janë zbatuar 2 masa me vlerë 78,106 lekë, 1 masë me vlerë 60,169 lekë është në proces zbatimi dhe 2 masa me vlerë 194,480 lekë janë realizuar pjesërisht duke arkëtuar vlerën 143,189 lekë. Janë rekomanduar 4 masa për eliminimin e efekteve negative me vlerë 15,933,150 lekë, nga të cilat janë zbatuar 2 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa të tjera. Janë rekomanduar 9 masa disiplinore, nga të cilat janë zbatuar 8 masa dhe nuk është zbatuar 1 masë. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, neni 15, germa "j".
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 1, faqe 13-15, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: UK SHA Sarandë, të marrë masa për realizimin e plotë të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, për 27 masa organizative, 3 masa shpërblim dëmi, 2 masa për eliminimin e efekteve negative si dhe një masë disiplinore, me synim përmirësimin e situatës dhe rritjen e performancës së shoqërisë.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019-2021 UK SHA Sarandë nuk ka rinovuar kontratën kolektive të punës me Sindikatën. Në kushte të tilla punonjësit marrëdhëniet e punës me Shoqërinë i rregullojnë vetëm nëpërmjet kontratave individuale të punës. Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të punonjësve konkretisht në kontratat individuale të punës citohet se, *"Punëmarrësi do të përfitojë shpërblimet që i takojnë sipas legjislacionit në fuqi dhe shpërblimet e tjera të përcaktuara në vendimet e organeve drejtuese të shoqërisë me kontratën kolektive në fuqi"*. Kontrata kolektive e punës daton prej vitit 2009 me afat vlefshmërie deri në muajin prill të vitit 2012, pra pas vitit 2012 nuk mund të jetë referencë për kontratat individuale të punës. Kontrata kolektive e punës konsiderohet si një marrëveshje me shkrim që ka të bëjë me kushtet e punës lidhur ndërmjet organizatave sindikale dhe punëdhënësve, në bazë të së cilës duhet të lidhen kontratat individuale të punës. Në lidhje me këtë situatë Shoqëria gjatë fillimit të vitit 2022 ka nisur bisedimet me Sindikatën për lidhjen e kontratës së re kolektive të punës por deri më datën 01.07.2022, rezulton se ende nuk është nënshkruar kontrata midis palëve, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 159, 160 dhe 161.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të merren masa për rinovimin e kontratës kolektive të punës.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Niveli i pagave i cili është aplikuar për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë nuk është miratuar specifikisht nga Asambleja Aksionare (Bashkia Sarandë). Organet drejtuese të Shoqërisë e kanë quajtur të ezauruar miratimin e nivelit të pagave vetëm me miratimin e programit ekonomik ku pjesë e tij është edhe fondi i pagave. Rezulton se ka keq interpretim nga

organet drejtuese të Shoqërisë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve" i ndryshuar, neni 6, pika 1.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit në të ardhmen të merren masa për miratimin e nivelit të pagave nga Asambleja Aksionare (Bashkia Sarandë) duke zbatuar në këtë mënyrë detyrimet ligjore në mirë organizimin dhe mirëfunksionimin e institucionit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë ka funksionuar rregullorja e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit miratuar me Vendimin nr. 12, datë 28.05.2020, të Këshillit të Administrimit. Në nenin 20, të kësaj rregulloreje është përfshirë si strukturë edhe Drejtoria e Auditit të Brendshëm. Kjo strukturë nuk duhet të jetë e përfshirë në rregulloren e brendshme të Shoqërisë edhe pse kjo strukturë është vakante për arsye se në Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, *"Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"*, neni 3, germa "a", dhe VKM nr. 83, datë 03.02.2016, *"Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"*, pika 1, germa "b", citohet se, *"Një Shoqëri Aksionare duhet të ketë pjesë të strukturës së saj një Njësi të Auditit të Brendshëm në rast se struktura e institucionit ka përgjatë tre viteve të fundit 300 punonjës"*, ndërkohë që strukturat organizative për periudhën objekt auditimi kanë qenë mesatarisht 165-170 punonjës.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të merren masa për përditësimin e rregullores së brendshme të institucionit duke hequr nga struktura e UK SHA Sarandë Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të rekrutimit të punonjësve nga UK SHA Sarandë konstatohet se, në tre raste janë punësuar punonjës pa procedurë por vetëm me urdhër të Administratorit të Shoqërisë, veprime këto në kundërshtim me Vendimin nr. 11/1, datë 24.04.2020, të Administratorit të Shoqërisë me objekt "Miratimin e procedurës për rekrutimin e punonjësve".
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masat e duhura që rastet e emërimeve të reja të kryhen në përputhje me procedurat dhe rregullat e përcaktuara nga vetë institucioni në lidhje me procesin e rekrutimit të punonjësve.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se Asambleja e Përgjithshme e UK SHA Sarandë me vendim nr. 2 datë 29.12.2020, ka miratuar pasqyrat financiare të vitit 2019, ku rezultati financiar i këtij viti paraqitet me fitim në vlerën 9,727,814 lekë.
Sipas këtij vendimi, fitimi i shoqërisë do mbartet për investime të shoqërisë në periudhat e ardhshme, veprim i cili duhet të realizohet brenda periudhës së 6 mujorit të parë të vitit ushtrimorë.
Nga UK SHA Sarandë (strukturat përgjegjëse), vendimi për alokimin e fitimit nuk është kryer brenda 6 mujorit të parë të vitit ushtrimor, veprim i cili ka çuar në penalizmin me masë gjobe 10,000 lekë nga Drejtoria rajonale Tatimore.

Sa më sipër është në kundërshtim me Vendimin nr. 63 datë 27.01.2016, neni 6, pika 4 *"Asambleja e Përgjithshme thirret në mbledhje të paktën një herë në vit, brenda 6 muajve që pasojnë mbylljen e vitit financiar"*, VKM nr.63 datë 27.01.2016 Neni 10, pika 1 "*Nëse shoqëria zotërohet nga një aksionar, të drejtat dhe detyrimet Asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga aksionari i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:*
b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;", si dhe ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 *"Për tatimin mbi të ardhurat"* i ndryshuar Kreu III Neni 33/1 si dhe "Strategjia për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura dhe Plani i Veprimit, Ministria e Financave".
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
6.1. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë gjatë hartimit dhe miratimit të pasqyrave financiare të marrë për bazë respektimin e afateve sipas dispozitave ligjore në fuqi, si dhe në rastet kur shoqëria rezulton me fitim të periudhës duhet që pjesën më të madhe të fitimit ta përdorë për shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Pas verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua që, arkëtimet me anë të bankës dhe arkës kanë ardhur në rënie duke rritur vlerën e zërit *Të drejta të arkëtueshme.* Në analizimin e zërit *Të drejta të Arkëtueshme* dhe nënkategorisë *"Njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse Bashkia Sarandë",* vihet re vlera prej 1,041,432 lekë, shumë e cila duhet të rimbursohet nga Bashkia Sarandë mbi mbulimin e familjeve që kanë përfituar matësit e ujit falas me anë të vendimit nr.18 datë 12.01.2018 *"Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë",* por që nuk është rimbursuar dhe nuk është pasqyruar si vlerë në dy vitet pasardhëse përkatësisht 2020 dhe 202, veprime në kundërshtim me Kreun II Neni 95 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"* i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
7.1. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë të marrë masat që të kryejë arkëtimet në kohën e duhur sipas plan veprimit dhe natyrës së arkëtimit, duke shmangur faktorët që mund të çojnë në krijimin e borxhit të keq në shoqëri.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në analizimin e zërit *Të Drejta të Arkëtueshme* vihet re që në nënkategorinë *"Kërkesa për të arkëtuar klientë UK Finiq"* përbën vlerë e cila është mbartur në vite në shumën 26,871,536 lekë ku sipas Akt- Marrëveshjes nr. 256 prot. datë 24.06.2019 bëhet i mundur dorëzimi i klientëve të Ujësjellës Kanalizime Finiq por për vlerën e mësipërme që përbën *Të drejta të arkëtueshme* klientët nuk kanë përfunduar procedurat për çregjistrimin e tyre në librat kontabël. Sa më sipër është në kundërshtim me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit SKK 08.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
8.1. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, të bëjë të mundur çregjistrimin në librat kontabël të vlerës prej 26,871,536 lekë, mbi të cilën nuk ka asnjë të drejtë mbi arkëtimin e kësaj vlere sipas Akt – Marrëveshjes nr. 256 prot., datë 24.06.2019.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në analizimin e zërit *Detyrime Afatshkurtra* dhe nënkategorisë *"Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit"* vihet re një rritje në vlerë e këtij zëri që përbëhet nga detyrime ndaj Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës në procedura prokurimi, detyrime ndaj OSHEE përkatësisht gjatë vitit 2019 në vlerën 47,495,662 lekë, gjatë vitit 2020 në vlerën 75,805,518 dhe gjatë vitit 2021 në vlerën 114,177,051 lekë. Në analizimin e zërit *Detyrime Afatshkurtra* dhe nënkategorisë "*Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore"* përfshihen detyrimet e muajit dhjetor.
Në analizimin e zërit *Detyrime Afatgjata* dhe në nënkategorinë *"Titujt e huamarrjes"* përfaqësohet nga dy kredi afatgjata, Kredia IDA në vlerën 1,390,000 SDR dhe Kredia-KFŴ në vlerën 3,566,840 Euro të konvertuara me kursin e ditës për vitet përkatëse.
Sipas Marrëveshjes së nën-huas në UK SHA Sarandë, do të investohej shuma prej 1,390,000 SDR e barabartë me 1,954,443 USD. Ndërsa sipas rakordimit me Ministrinë e Financave në 31.12.2017, vlera e disbursuar paraqitet në shumën 2,530,820.86 USD, ndërsa vlera e kredisë sipas Marrëveshjes së nën-huas e shprehur në dollarë është 1,954,443 USD, me një mos rakordim në shumën 576,377 USD. Me dokumentacion është justifikuar përdorimi i fondeve në vlerën 133,040,349 lekë, ndërsa vlera e financimit e shprehur në lekë në datë 07.07.2003 është 233,408,800 lekë. Për diferencën në 100,368,451 lekë, nga zbatuesi i projektit (DPUK/AKUK) nuk është paraqitur dokumentacion justifikues (pranë UK SHA Sarandë) sipas natyrës së shpenzimeve të kryera në kuadër të këtij projekti. Theksojmë se, kjo problematikë është konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm të zhvilluar nga KLSH.
Në analizimin e zërit *Detyrime Afatgjata* dhe në nënkategorinë *"Detyrime ndaj institucioneve të kredisë",* janë interesat e llogaritura dhe të papaguara ndaj dy kredive të mësipërme në përkatësisht për Kredinë IDA në vlerën **303,064 USD** dhe për Kredinë KFŴ në vlerën **466,168 Euro** të konvertuara me kursin e ditës së mbylljes së bilancit. Sa më sipër është në kundërshtim me Strategjinë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura dhe Plani i Veprimit, Ministria e Financave.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
9.1. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, të marrë masat mbi likuidimin e detyrimeve të prapambetura ku mund të vazhdojnë të ndjekin grafikun e pagesave sipas planifikimit, duke respektuar parimin e kohës së krijimit të detyrimit sipas natyrës së shpenzimit.

Në vijimësi

9.2. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime Sarandë sh.a, të marrë masat mbi zgjidhjen e problematikës mbi mos rakordimin e vlerës prej 576,377 USD, midis Akt marrëveshjes së nën-huasë IDA dhe Ministrisë së Financave, gjë e cila ndikon në llogaritjen e interesave dhe në mënyrën se si janë përdorur fondet.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në analizimin e zërit *Aktive Afatgjata* dhe nënkategorisë *"Parapagime për aktive materiale dhe në proces"* ku përfshihet një investim "Itun" në vlerën 287,042,569 lekë, ku pasqyrohet si investim i papërfunduar. Kjo vlerë i përket investimit me objekt "Infrastruktura Ujore e Bashkisë", sipas raportit të hartuar nga UKS SHA, nuk është marrë në dorëzim për shkak të mosplotësimit të parametrave teknikë të parashikuar në kontratë. Përsa i përket investimit të papërfunduar me objekt "Infrastruktura Ujore e Bashkisë" në vlerën 319,591,667 lekë dhe regjistrimit të tij si llogari jashtë bilanci, është rezultat i faktit se UKS SHA është përfituese e investimit me objekt "Infrastruktura Ujore e Bashkisë". Ky projekt sipas Drejtorisë së

Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (DPUK) sot Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime (AKUK) ka përfunduar më datë 31.12.2011, bazuar në kontratën së lidhur më datë 24.01.2007 ndërmjet Kontraktorit "P. & F. Srl" (Itali) dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë) për ndërtimin e tre impianteve të pastrimit, ku është përfshirë edhe Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) Sarandë. Sipas shkresës nr. 1820, datë 24.07.2014 të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizime (sot Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizime) vlera e financimit është në shumën 3,877,126 EUR.
Me shkresën nr. 1820, datë 24.07.2014, protokolluar në UKS SHA me nr. 170, datë 10.09.2014 është cilësuar se:
- Nga koha e përfundimit të kontratës 31.12.2011 deri në 24.07.2014, UKS SHA është ngarkuar nga ministria e linjës për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e impiantit deri në përfundim të lidhjes së tyre me rrjetet përkatëse të kanalizimeve.
- PIU i Ujit në ministrinë e linjës kërkon nga UKS SHA si përfitues që të marrë në dorëzim objektin.
- Me shkresën nr. 170/1, datë 15.09.2014 të Administratorit të UKS SHA, i është kthyer përgjigje Ministrisë, ku është relatuar se objekti nuk mund të merret në dorëzim, pasi mbart problematika të shumta të cilat kanë sjellë mosfunksionimin e tij.
- Me shkresat nr. 198, datë 21.06.2016 dhe 230/1, datë 15.07.2016 drejtuar DPUK/AKUK, nga ana e Administratorit, është bërë me dije se "Impianti i trajtimit të ujërave të ndotura" ITUN, nuk është në funksion për shkaqet të cilat janë bërë prezent me shkresën nr. 170/1, datë 15.09.2014.
Theksojmë se vlera totale e financimit për këtë investim është në shumën 3,877,126.92 EUR, nga e cila vlera e kredisë është 2,403,848 EUR (referuar MF). Ky investim nuk është marrë në dorëzim dhe nuk është vënë në përdorim për shkak të mosplotësimit të një sërë komponentësh të kësaj kontrate si: Tubacionet e dërgimit të ujërave kanë rezultuar me çarje; Impianti nuk është vendosur asnjëherë në punë dhe pjesa më e madhe e pajisjeve nuk punojnë; Pompa e furnizimit me ujë të impiantin nuk punon; Pajisjet e pastrimit të grilave nuk punojnë etj.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 6, faqe 31-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
10.1. Rekomandimi: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UKS sh.a., duhet të marrin në analizë këtë situatë, të bëjnë me dije strukturat të cilat kanë përgjegjësinë për këtë investim, si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe PIU Ujit, për mosfunksionimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Sarandë, për shkak të dështimit të këtij investimi dhe obligimit të UKS SHA për shlyerjen e detyrimeve të kredisë të marrë për këtë qëllim.
UKS sh.a. të kërkojë nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe PIU i Ujit, si kontraktuese me kompaninë zbatuese, të marrin masa të menjëhershme për përfundimin e këtij investimi brenda kostos së parashikuar dhe sipas parametrave teknikë të përcaktuar në kontratë, me qëllim vënien në funksionim të ITUN Sarandë.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: UK SHA Sarandë nuk ka hartuar apo miratuar ndryshime të programeve ekonomiko-financiare, shoqëruar me relacion shpjegues të faktorëve të paparashikuar të cilët për vitet 2019, 2020 dhe 2021, kanë çuar në tejkalim të investimeve dhe të disa zërave të shpenzimeve, krahasuar me programin e miratuar, nuk ka bërë një analizë të detajuar të numrit të operatorëve që janë pajisur ose nuk janë pajisur me matës, një analizë të detajuar mbi humbjet teknike ose ato ekonomike menaxheriale, një analizë të detajuar mbi debitorët dhe gjendjen e likuidimit nga ana e

tyre. Mungojnë Programet Ekonomike Afatmesme PBA dhe Programet Ekonomike Afatgjata, mungon plani 5 vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plani i biznesit, mungojnë raportimet mbi zbatimin e buxhetit për çdo tremujor në AKUM. Nga sa më sipër rezulton se është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. Nr. 9901, datë 14.04.2008 *"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"*, si dhe Udhëzimin nr. 15 datë 02.02.2018 *"Mbi programet e zhvillimi ekonomik të shoqërive tregtare me kapital Shtetëror"*.

(Më hollësisht trajtuar në Pikën 3, faqe 18-20, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, të marrë masat për programimin e buxheteve afat mesëm sa më real, bazuar në radhë të parë me burimet e veta të financimit, duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore. Gjithashtu, të merren masat e nevojshme për programimin në buxhetin e vitit ushtrimor, shlyerja e të gjitha detyrimeve kreditore të trashëguar si dhe mbledhja e të gjitha detyrimeve nga ana e debitorëve.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se:

-Në 20 raste urdhrat për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzimit të mallrave dhe procesverbalet e marrjes së mallrave apo shërbimeve në dorëzim janë të pa protokolluara.

-Në 10 raste konstatohen vonesa në likuidimin e operatorëve ekonomikë duke mos respektuar afatet e parashikuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare"*, neni 7. Kjo situatë ka ndodhur përgjatë vitit 2021, ku likuidimi i tyre është kryer përgjatë tre mujorit të parë të vitit 2022. Mos likuidimi në kohë i faturave pjesore apo përfundimtare ndaj operatorëve ekonomikë shkakton risk për krijimin e detyrimeve ndaj operatorëve ekonomikë.

-Në 20 raste në setin e dokumentacionit justifikues dhe plotësues të bankës, bashkëlidhur nuk ndodheshin autorizimi i shpenzimit, urdhra blerje, kontratat e lidhura ndërmjet palëve si dhe faturat tatimore nuk janë origjinale por fotokopje, si dhe urdhër xhirimet e transaksioneve të kryera për likuidimin e shpenzimeve. Dokumentacioni i mësipërm u plotësua gjatë auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, *"Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare"*, neni 7, pika c, germa "i", ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 19, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* i ndryshuar, pika 35, germa "b" dhe Normën Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.

(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria Tregtare të merren masa në të ardhmen për plotësimin dhe sistemimin në mënyrë kronologjike të dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur veprimeve të kryera me bankë në zbatim të përcaktimeve të dispozitave ligjore përkatëse.

12.2. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të marrë masa për likuidimin në kohë të furnitorëve sipas afateve të përcaktuara në kontratat dypalëshe ndërmjet tyre me qëllim shmangien e penaliteteve të mundshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i shpenzimeve për konsumin e karburantit për 9 mjete ose në masën 39.1% të konsumit, konstatohet se me Vendimin nr. 8/1, datë 24.03.2020, të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar normativat për konsumin e karburantit. Ky vendim nuk

përfshin periudhën nga data 01.01.2019, deri më datën 23.03.2020, pra mjetet e shoqërisë nuk kanë pasur normativa të miratuara mbi konsumin e karburantit. Shpërndarjen e karburantit për mjetet e saj Shoqëria e realizon nëpërmjet sistemit të tollonave duke u bazuar në kërkesat apo autorizimet ditore të çdo drejtorie, përmes daljes nga magazina sipas fletë-daljeve respektive. Referuar procesit të shpërndarjes që aplikon Shoqëria rezulton se nuk ka një planifikim mujor apo vjetor ku të ketë një plan shpërndarje për çdo sektor, degë apo drejtori. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për këto mjete nuk janë mbajtur kartelat përkatëse në të cilat regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to, gjithashtu nuk është i evidentuar kilometrazhi i tyre në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra, karburant, riparime etj. Këto shpenzime nuk mund të përllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi për mirëmbajtjen e tyre. Shpenzimet për konsumin e karburantit mbahen në dosjen e mjetit nga drejtuesi i automjetit ku pjesë përbërëse e dosjes janë edhe urdhri për përdorimin e mjetit, siguracioni vjetor, leje qarkullimi, kontrolli teknik (kolaudimi për të gjitha mjetet ndodhet vetëm i vitit 2022), kërkesat dhe autorizimi për lëvizjen e mjetit, fletë-dalja nga magazina dhe fletë-udhëtimi.

Mbi dokumentacionin justifikues:

-Në rubrikën e parë "Fletë-udhëtimi" përcaktohet tipi i mjetit, personi i cili e ka në ngarkim mjetin (shoferi) nënshkruar prej tij dhe autorizuesit (drejtori, përgjegjësi i sektorit, përgjegjësi i manovrimit sipas rastit) nënshkruar prej tij si dhe sasia e tërhequr e karburantit nga magazina sipas datave përkatëse.

-Në rubrikën e dytë "Fletë udhëtimi për nevojat e sektorëve" është pasqyruar lëvizja në total mujore për mjetin të nënshkruara nga drejtuesi i mjetit dhe përgjegjësi i sektorit përkatës. Pjesë e kësaj praktike të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës me vendimin nr. 8/1, datë 24.03.2020, janë edhe të dhënat që duhet plotësuar, pra sa është kilometrazhi në fillim të lëvizjes dhe sa është kilometrazhi në fund të lëvizjes së mjetit. Ndërkohë që, nga drejtuesit e mjeteve regjistrohen në këtë rubrikë vetëm kilometrat e përshkruara në total.

Në lidhje me situatën e konstatuar të sipërpërmendur nga organet drejtuese të Shoqërisë nuk ka të përcaktuar një udhëzim, manual dhe rregulla ku të jetë pjesë e Rregullores së Brendshme në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet e Shoqërisë si dhe në të, të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive dhe sektorëve, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 19, neni 22, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pika 5, 10, 19 dhe 36.

(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Tregtare dhe Drejtoria Teknike të merren masa për të hartuar kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

13.2. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për hartimin e rregullave në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të procesit së shpërndarjes dhe konsumit/realizimit të karburantit për mjetet e shoqërisë si dhe të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësive respektive sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të blerjeve të vogla konstatohet se:
-Në 3 raste për vitet 2019-2021 janë realizuar 6 procedura prokurimi me vlera të vogla duke shmangur procedurat normale të prokurimit nga copëzimi i fondin limit, pra këto procedura duhet të kryheshin me procedurë me vlera të larta.
-Në 21 raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.
-Në 14 raste nuk argumentohet mënyra e përllogaritjes së këtij fondi.
-Në 21 raste fatura tatimore nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit.
-Në 21 raste urdhri i prokurimit, urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave nuk janë të protokolluara, si dhe dosjet e përzgjedhura për auditim nuk janë të inventarizuara dhe të arkivuara, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar, neni 40, pika 3, neni 40, pika 1 dhe 8 dhe 59, pika 2, Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018, *"Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike"* i ndryshuar, pika 19 si dhe neni 3 dhe 29 të *"Normën Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë"* miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, *"Për arkivat"*.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
<u>14.1. Rekomandimi:</u> Nga Administratori i Shoqërisë, Drejtoria Tregtare dhe Zyra Juridike të merren masa që:
-Në hartimin e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve, të shmanget procedura e copëzimit të fondeve për të njëjtin grup mallrash apo shërbimesh;
-Të dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit;
-Të argumentohet dhe dokumentohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit;
-Për çdo rast faturat tatimore të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e komisionit në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi;
- Të bëhet arkivimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për të gjitha rastet e mbylljes së procedurës deri në zbatimin e kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimit *"Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial, Ksamil"* fondi limit është përllogaritur me vlerë 81,947,188 lekë. Nga verifikimi i çmimeve të aplikuara krahasuar me manualet e çmimeve të ndërtimit rezulton se ka mangësi. Nga rillogaritja, rezulton se fondi limit duhet të ishte me vlerë 81,769,833 lekë. Për procedurën e prokurimit *"Ndërtim i KUZ Lugu i Dardhës"*, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 103,940 lekë. Për procedurën e prokurimit *"Përmirësim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, Rr. 13 Bibilenjtë, Rr. Abedin Dino, ..."* fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 177,355 lekë. Për procedurën e prokurimit *"Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë"*, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 162,778 lekë. Kontratat përkatëse janë nënshkruar me vlera më të vogla se fondi limit i rillogaritur.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 *"Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
15.1. Rekomandimi: Komisionet e përllogaritjes së fondit limit, duhet të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përafërt, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e procedurës së prokurimit *"Blerje e dy automjeteve për nevoja të shoqërisë"*, është aplikuar lloji i procedurës *"Kërkesë për propozim"*. Janë bërë ftesa për pjesëmarrje në procedurën e auditimit për tre OE, të cilët operojnë në fushën e tregtimit të automjeteve dhe jo në pesë OE sa duhet të ishin ftuar sipas kuadrit ligjor e rregullator të prokurimit publik. Konkretisht ky veprim është në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (shfuqizuar), neni 46, neni 34, pika 1.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
16.1. Rekomandimi: Njësia e prokurimit, sipas rastit dhe procedurave, të respektojë kërkesat ligjore për njoftimin e operatorëve ekonomikë minimalisht në numrin e përcaktuar, me synim sigurimin e një pjesëmarrje sa më të gjerë. Operatorët ekonomikë që ftohen të marrin pjesë në këto procedura, duhet të ndryshohen sa më shumë të jetë e mundur.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit *"Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial, Ksamil"*, janë përcaktuar si kritere s'kualifikuese:
Disponim licencë sipas pikës N.P 12 "Punime të inxhinierisë mjedisore".
Është kërkuar që OE të ketë drejtues teknik për pozicionin inxhinier mjedisi.
Janë kërkuar 4 manovratorë dhe 2 makinistëve, pa marrë në konsideratë faktin se OE mund të ketë kontratë qiraje me OE tjetër për mekanizma dhe automjete.
Është vendosur kriteri për disponimin e lejes mjedisore me kod III.2.B "Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme, në selinë e ushtrimit të aktivitetit".
Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit "Ndërtim KUZ Lugu i Dardhës", janë përcaktuar si kritere s'kualifikuese:
-Disponimin e lejes mjedisore me kod III.2.B "Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme, në selinë e ushtrimit të aktivitetit"
- Është kërkuar disponim ose marrje me qira ekskavator me goma dhe ekskavator me zinxhirë, ndërkohë që punimet janë përcaktuar të realizohen vetëm me ekskavator me zinxhirë.
Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit "Përmirësim i KUZ Sarandë (Sarandë ITUN, Bypas dhe vendosje saraçineska manovrimi, ajrues)", janë përcaktuar si kritere s'kualifikuese:
- Disponimi ose marrja me qira e një ngjeshësi hidroelektrik (ndërkohë që është kërkuar edhe rul ngjeshës).
- Kërkohet disponimi ose marrja me qira ekskavator me zinxhir si dhe skrep/fadromë, ndërkohë që punimet e gërmimit i përkasin vetëm ekskavatorit me goma.
- Është kërkuar pjesëmarrja në takim në ambientet e shoqërisë. Mos pjesëmarrja është përcaktuar si kriter s'kualifikues, ndërkohë që nuk kemi të bëjmë me një kontratë të ndërlikuar për të cilën është domosdoshmëri njohja me objektin.
Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit "Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë", janë përcaktuar si kritere s'kualifikuese:

-Disponim licence sipas kategorisë NP.12, klasifikimi A, "Punime të inxhinierisë së mjedisit".
- Disponimin e lejes mjedisore me kod III.2.B "Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme, në selinë e ushtrimit të aktivitetit".
- Është kërkuar disponimi i mekanizimit bobcat, ndërkohë që ka disa lloje mekanizmash që kryejnë të njëjtën punë dhe kanë të njëjtat specifika, por që nuk janë të markës bobcat.
- Është kërkuar që OE të kenë në pronësi ose me qira skrep, 2 ekskavator me goma, një sharrë për punim metali, depozitë për grumbullim materiale, pirun dhe helikopter nivelimi. Punimet e gërmimit janë parashikuar me ekskavator me zinxhirë dhe në asnjë rast me ekskavator me goma. Punimet e realizimit të sipërfaqeve të lëmuara me helikopter nuk janë parashikuar në preventiv, madje seksionet e betonit, nuk duhet të jenë të lëmuara, pasi paraqet rrezikshmëri për qarkullimin e automjeteve.
Në dokumentet e tenderit sipas procedurës së prokurimit "Mirëmbajtja dhe riparimi i elektropompave të stacioneve të pompimit", janë përcaktuar si kritere s'kualifikues disponimit të licencës profesionale "NP-7A, Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje", kriter i cili nuk lidhet ngusht me natyrën dhe volumin e kontratës. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 26, pika 5, ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 77, pika 1.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
17.1. Rekomandimi: Njësia e prokurimit apo komisioni i ngarkuar, duhet të argumentojnë kriteret e kualifikimit që vendosen në procedurat e prokurimit, duke patur në konsideratë natyrën dhe volumin e kontratës, me synim shmangien e kritereve që krijojnë kufizime për pjesëmarrësit, si dhe krijimin e mundësisë për pjesëmarrje sa më të lartë të biznesit të vogël e të mesëm.

Në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit *"Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë"*, rezulton se nga 5 OE të paraqitur janë s'kualifikuar 4 OE. OE "M./S" SHPK është s'kualifikuar me arsyetimin se:
-I mungon 1 (një) kamionçinë, pasi mjeti SR. B i mbaronte kontrata në datë 11.12.2020 në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.8 a), ndërkohë që OE ka paraqitur një kamionçinë më shumë.
- Ka paraqitur mekanizëm ekskavator me goma i cili nuk ka dokumentacion qarkullimi, ndërkohë që nuk është përcaktuar se duhet të jetë ekskavator me goma i cili qarkullon në rrugë dhe pajiset me dokumentacion si leje qarkullimi etj.
- Ka paraqitur mjetin "Sharrë për Punim metali" për të cilin OE nuk ka dorëzuar dokumentacion. Në kontratën e qirasë që OE ka me shoqërinë "E. C." figuron mjeti të jetë makineri prerëse metalesh me kontroll numerik e cila sipas fotos të paraqitur është e stacionuar në ambiente dhe jo sharrë punimi metali e cila është e lëvizshme dhe përdorshme në terren ku do të realizohet objekti". Procesi i prerjes së hekurave (në punimet e kësaj kontrate nuk është parashikuar proces i tillë), mund të realizohet edhe jashtë kantierit.
Nga ana e KVO dhe KSHA, shmangiet e mësipërme mund të konsideroheshin devijim i vogël, pasi diferenca e vlerës së ofertave ndërmjet këtij OE me atë fitues është e konsiderueshme dhe kriteri kryesor i procedurës së prokurimit është "Çmimi më i ulët".
Në procedurën e prokurimit "Blerje e dy automjeteve për nevoja të shoqërisë", në specifikimet teknike të automjeteve, pjesë e dokumenteve të tenderit përcaktohet se ofertuesi duhet të paraqesë dokumente të automjeteve si, libër makine, leje qarkullimi, fotografi në të cilat të shikohen qartë të dhënat e mjetit dhe gjendja e tij estetike. Nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, konstatohet se operatori ekonomik shpallur fitues, nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentacioni i

kërkuar si më sipër. Në kushtet e mos plotësimit të këtyre kërkesave, operatori ekonomik duhet të ishte s'kualifikuar. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (shfuqizuar), neni 46.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
18.1. Rekomandimi: Komisionet e vlerësimit të ofertave duhet të analizojnë me detaje dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit, jo vetëm sa i takon sigurimit se ka aftësitë teknike për të realizuar kontratën, por edhe nëse produkti i paraqitur i plotëson specifikimet teknike të parashikuara, me synim shmangien e riskut të dështimit të kontratave dhe mos realizimit në kohë të tyre.

Në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Regjistri për pjesëmarrjen në mbledhje të anëtarëve të Këshillit të Administrimit) për Këshillin e Administrimit dhe Administratori, konstatohet se anëtaret nuk janë mbledhur të paktën 1 (një) herë në muaj, veprim në kundërshtim me VKM nr. 63, date 27/01/2016, Neni 14, Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit, Pika 1.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 2, faqe 16-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
19.1. rekomandimi: Këshilli i administrimit të marrë masa për zhvillimin e mbledhjeve, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.

Vazhdimisht

20. Gjetje nga auditimi: Kontrata e punimeve civile "Ndërtim i kanalizimeve të ujërave të zeza në Bllokun mbi rrugën nr.5, Lagje nr. 3, Sarandë", është nënshkruar me nr. 590 prot., datë 03.12.2020, me Kontraktorin "JV I. G. & 2. K.", me vlerë 31,821,600 lekë. Referuar dokumentacionit të dosjes teknike, në shtresën e betonit e cila është vendosur në rrugë, është vendosur zgarë hekuri me dimensione të hekurit 3-5 mm, me kuadratë (plegma) 15 cm x 15 cm, kjo e konstatuar vetëm në dy seksione dhe anash shtresës së betonit.
- Nga verifikimi i dokumentacionit teknik, kokat e pusetave në rrjetin me tubacion 315 mm, ishin parashikuar të ndërtoheshin prej betoni monolit, me dimensione 1.65 m x 1.65 m, me trashësi të mureve 20 cm. Nga verifikimi në objekt rezulton se nuk janë respektuar këto dimensione. Rreth kapakut prej gize është hedhur beton i pa armuar (armimi nuk është përfshirë në peshën e hekurit në situacion), me gjerësi rreth 30 cm rreth kapakut. Sasia e betonit për përgatitjen e tyre është më e vogël se ajo e parashikuar.
Në lidhje me realizimin e pusetave si më sipër, ishte parashikuar që ato të ndërtoheshin me formë drejtkëndore me beton të derdhur në objekt. Nga verifikimi në terren rezulton që ato janë vendosur të parapërgatitura si dhe në formë rrethore. Sasia e betonit për përgatitjen e tyre është më e vogël se ajo e parashikuar, për të cilën nuk mund të përcaktohet diferenca për arsye se kemi të bëjmë me punime të cilat janë bërë të pa dukshme në elementët kryesor të tyre. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve nuk është reflektuar ky fakt, për miratimin e ndryshimit nëse ka qenë e nevojshme si dhe përcaktimin e çmimit për zë të ri punimi, duke qenë se vendosja e pusetave të parapërgatitura nuk është pjesë e preventivit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, pika 8.2 dhe 8.3.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

20.1. Rekomandimi: UK SHA Sarandë, të ngrejë një komision të veçantë për analizimin e kostos së tombinove rrethore të vendosura nga kontraktori duke reflektuar diferencën në vlerë krahasuar me tombinot e projektuara dhe vlera e diferencës të zbritet nga vlera e garancisë së kontratës së punimeve të bashkimit të operatorëve "JV I. G. & 2. K." SHPK. Po ashtu, të verifikohet dimensioni i zgarave të vendosura në shtresën e betonit.

Deri me datë 31.12.2022

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Kontrata *"Ndërtim stacioni i ri pus-çpimi në Vrion dhe lidhja me rrjetin kryesor transmetues"*, është nënshkruar me nr. 442 prot., datë 20.10.2020, me Kontraktorin "M./S" SHPK, me vlerë 9,404,900 lekë pa TVSH. Bazuar në dokumentacionin përkatës rezulton se për zërin b.1.14 "Pjesë speciale çeliku, Ø ~ 200 mm", është preventivuar dhe certifikuar sasia 950 kg. Në librezën e masave nuk është detajuar kjo sasi sipas elementëve përkatës, për përcaktimin e saktë të peshës. Nga verifikimi i disa zërave të punimeve në objekt, rezulton se për vendosjen e tubacionit Ø ~ 200 mm, janë parashikuar: F.V brryl 90^0, 45^0 Ø – 200 mm, F.V saraçineska çeliku me fllanxha Ø – 200, F.V Valvula moskthimi Ø – 200, F.V distancor, F.V Nyje bashkuese dhe F.V ventila çeliku me fllanxha (shkarkues + kontroll).
I vetmi element i cili konsiderohet pjesë speciale çeliku, janë dado bullonet të cilat janë përdorur për lidhjen e fllanxhave, të cilët janë në sasi 48 copë me peshë 50 kg. Sasia 900 kg është certifikuar pa përcaktuar se cilëve elementë i përkasin. ***Vlera 270,000 lekë*** (900 kg x 300 lekë/kg) është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.
Nga verifikimi i disa zërave të punimeve rezulton se është vendosur tubacion Ø – 200, në sasinë 28 ml ose 1,078 kg (3 ml është i pa vendosur, por gjendje në objekt). Sasia e certifikuar për këtë zë punimi është 43 ml, ose me peshë 1667.1 kg, nga ku rezulton diferenca 15 ml, ose 589 kg. ***Vlera 176,700 lekë*** (589 kg x 300 lekë/kg), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori M./S SHPK dhe përbën dëm ekonomik.
Në sheshin e stacionit të pompimit (pusit të çpimit), janë realizuar punime të shtrimit me çakëll, punime të cilat pretendohet se janë realizuar nga kontraktori. Nga verifikimi i dokumentacionit, nuk rezulton i reflektuar në ndonjë dokument realizimi i një procesi të tillë.
Po ashtu, sa i përket lidhjes së tubacionit me ankerat e betonit, janë vendosur profile metalike, të cilat nuk përbëjnë pjesë speciale çeliku. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 8.2 dhe 8.3.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
1.1. Rekomandimi: UK SHA Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **446,000 lekë**, nga Kontraktori **"M./S" SHPK,** për punime të likuiduara port të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2022

2. Gjetje nga auditimi: Kontrata "Ndërtim i kafazit të shkallës me vetrata xhami të temperuar" është nënshkruar me nr. 185 prot., datë 06.05.2019, me Kontraktorin "2." SHPK, me vlerë 3,557,400 lekë. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 45 ditë. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria "I." SHPK. Nga verifikimi i disa zërave të punimeve u konstatuan diferenca të punimeve të realizuara krahasuar me ato të certifikuara rezulton se për

zërin "Mbulim çatie me panele sandŵiç", është certifikuar dhe likuiduar në sasinë 40 m^2, ndërkohë që nga verifikimi në objekt rezulton se është realizuar sasia 32 m^2, me një diferencë 8 m^2. ***Vlera 40,000 lekë*** (8 m^2 x 5,000 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "2." dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 *"Për zbatimin e punimeve të ndërtimit"*, pika 8.2 dhe 8.3.

(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: UK SHA Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **40,000 lekë**, nga Kontraktori "2." SHPK, për punime të likuiduara port të pa realizuara.

Brenda datës 31.12.2022

C. MASA PËR ELEMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Nga auditimi i veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Ujësjellës Kanalizime Sarandë, kanë rezultuar shkelje të kuadrit ligjor dhe rregullator me pasojë efekt negativ financiar me vlerë 122,427,934 lekë, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi ndërmjet UK SHA Sarandë dhe OSHEE janë lidhur 23 kontrata për furnizimin me energji elektrike të vetë shoqërisë si dhe funksionimin e stacioneve të pompimit, pompave apo elektropompave. Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, detyrimi i lindur nga mos pagesa e faturave të energjisë elektrike ndaj OSHEE deri më datë 31.12.2021, ka arritur në vlerën 114,177,290.87 lekë, si dhe kamatëvonesat mbi këtë detyrim në **shumën 101,626,174.54 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë,** veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 8662, datë 18.09.2000, *"Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike"* i ndryshuar, neni 1.

(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për likuidimin e faturave të energjisë elektrike në afatet e përcaktuara nga kuadri rregullator në fuqi, për të mos krijuar kamatëvonesa, të cilat rëndojnë artificialisht buxhetin e institucionit.

1.2. Rekomandimi: Nga Këshilli i Administrimit të merren masa të menjëhershme, ku të hartohet një plan emergjent për shlyerjen detyrimeve dhe kamatëvonesave që ka Shoqëria ndaj OSHEE për 23 kontratat për furnizimin me energji elektrike.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me bankë konstatohet se, ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Bankave BEI, IDA dhe KfŴ janë lidhur marrëveshjet e financimit konkretisht:

1. Marrëveshja me BEI për Projektin "Infrastruktura Ujore Bashkiake Stacioni i trajtimit të ujërave të ndotura" me vlerë financimi në shumën 2,357,251 Euro.

2. Marrëveshja me IDA për Projektin "Projekti Bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime" me vlerë financimi në shumën 2,186,719 USD.
3. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake I" me vlerë financimi në shumën 4,000,000 Euro.
4. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake II" me vlerë financimi në shumën 500,000 Euro.
Për likuidimin e këtyre shumave të sipërpërmendura ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si përfaqësues i Qeverisë Shqiptare dhe Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë janë nënshkruar akt marrëveshjet nën huaje respektive, ku ende kanë mbetur detyrimet për t'u shlyer deri më datë 31.12.2021, si më poshtë:
1.1. Marrëveshja me BEI për Projektin "Infrastruktura Ujore Bashkiake Stacioni i trajtimit të ujërave të ndotura" UK SHA Sarandë ka detyrimin ndaj MFE në shumën 1,668,815 euro si dhe penalitete në **shumën 141,223.38 euro e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë,** si pasojë e mos likuidimit në kohë të detyrimeve të parashikuara në akt marrëveshjet nën huaje.
1.2. Marrëveshja me IDA për Projektin "Projekti Bashkiak i furnizimit me ujë dhe kanalizime" ka detyrimin ndaj MFE në shumën 2,304,419 USD.
1.3. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake I" UK SHA Sarandë ka detyrimin ndaj MFE në shumën 144,959 euro.
1.4. Marrëveshja me KfŴ për Projektin "Infrastruktura ujore Bashkiake II" UK SHA Sarandë nuk ka detyrim ndaj MFE mbi këtë akt marrëveshje nën huaje.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 5, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për analizimin e detyrimeve që janë krijuar ndër vite referuar akt marrëveshjeve të nën huas të lidhura me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si pasojë e paaftësisë paguese për shlyerjen e kredive, ku t'i bëjë me dije ministrisë situatën e vështirë ekonomike financiare të institucionit për zgjidhjen e kësaj problematike me qëllim shmangien e penaliteteve të cilat lindin si pasojë e mos likujdimit në kohë të këtyre kredive.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi organizimin e strukturës organizative të aplikuara për vitet 2019-2021, nga UK SHA Sarandë të miratuara respektivisht me Vendimin nr. 15/2, datë 20.12.2017 dhe nr. 3, datë 24.02.2020, të Këshillit të Administrimit me numër 170 punonjës për secilin vendim sa më sipër konstatohet se, është tejkaluar numri i fuqisë punëtore në total me 116 punonjës përgjatë periudhës objekt auditimi konkretisht: për vitin 2019 me 41 punonjës, për vitin 2020 me 13 punonjës dhe për vitin 2021 me 62 punonjës. Shuma e likuiduar për punonjësit mbi strukturën e miratuar është **3,264,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.** Ky efekt ka ardhur si pasojë e punësimeve të reja por edhe të punonjësve me kontrata tre mujore të cilat janë kryer nga Administratori i Shoqërisë sipas vendimeve përkatëse. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masat e duhura për bashkërendimin e punës mbi zbatimin e strukturës së miratuar mbi të cilën nuk duhej të kalohej numri total i punonjësve, gjithashtu ndërmjet tyre nuk rezulton të ketë patur një komunikim të vazhdueshëm gjatë rekrutimit të punonjësve të rinj në punë me qëllim marrjen e masave të duhura për respektimin e numrit total të punonjësve të miratuar në strukturën organizative, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* i ndryshuar, neni 8, pika 1,

pika 8, germa "d", neni 11, pika 1, dhe strukturës organizative të miratuar respektivisht me Vendimin nr. 15/2, datë 20.12.2017, dhe nr. 3, datë 24.02.2020, të Këshillit të Administrimit.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 25-30, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
3.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masat e duhura që, emërimi i punonjësve të rinj, lëvizja dhe qarkullimi i tyre të bëhet në sinergji me Zyrën e Burimeve Njerëzore, duke marrë informacion të vazhdueshëm në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator të rekrutimeve në punë.
3.2. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të merren masat e duhura që, në të ardhmen të respektohet numri i të punësuarve sipas strukturës së miratuar dhe legjislacionit në fuqi, me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Me Vendimin nr. 3, datë 05.03.2021, të Këshillit të Administrimit është miratuar shpërblimi në shumën 4,500 lekë konkretisht për 42 punonjëse në shumën totale 189,000 lekë me rastin e festës së 8 marsit. Me Vendimin nr. 2, datë 25.02.2022, të Këshillit të Administrimit është miratuar shpërblimi në shumën 5,000 lekë konkretisht për 37 punonjëse në shumën totale 185,000 lekë me rastin e festës së 8 marsit. Ndërkohë që Shoqëria ka detyrime për t'u likuiduar referuar kontratave të kredive dhe huave të lidhura me MFE sipas marrëveshjeve me Bankën Evropiane të Investimeve (BEI) dhe Bankës Gjermane për Zhvillim (KfŴ), detyrime dhe kamatëvonesa në likuidimin e energjisë elektrike si dhe është me humbje respektivisht për vitin 2020 në shumën 54,571,029.76 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 47,259,026.62 lekë.
Gjithashtu Vendimi i KA është në kundërshtim me ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve" i ndryshuar, neni 6, pika 1, germa "b" për arsye se shpërblimi është përfituar para daljes së rezultatit financiar si dhe në kushtet kur Shoqëria ka detyrime për shlyerjen e kredive ndaj MFE por referuar humbjeve sipas periudhave të sipërpërmendura nuk mund të akordojë shpërblim për punonjësit e saj. Në total ky shpërblim është në **shumën 374,000 lekë e cila përbën efekt negativ financiar për buxhetin Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.**
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli i Administrimit të marren masa që dhënia e shpërblimeve për punonjësit e saj të kryhet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, duke vlerësuar situatën financiare të institucionit me qëllim përdorimin e fondeve publike me ekonomicitet, efiçencë dhe efektivitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me arkë dhe bankë konstatohet se, janë likuiduar gjoba në shumën totale 217,006 lekë, si pasojë e vonesës së deklarimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mos depozitim i pasqyrave financiare për mungesë vendimi nga Asambleja Aksionare etj., konkretisht për vitin 2019 në shumën 150,044 lekë, për vitin 2020 në shumën 25,000 lekë dhe për vitin 2021 në shumën 31,861 lekë. Për sa trajtuar më sipër **shuma 217,006 lekë përbën efekt negativ financiar për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.**
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 4, faqe 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
5.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa që, deklarimi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në sistemin ESIG dhe depozitimi i pasqyrave

financiare në QKB të kryhet brenda afateve të parashikuara në dispozitat ligjore përkatëse me qëllimin shmangien e gjobave dhe penaliteteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA ADMINISTRATIVE

E. I - Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar, me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme"*, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Sarandë, **të vlerësojë shkeljet e konstatuara**:

1. Subjektit *"N. S." SHPK* me përfaqësues ligjor z. E. N., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.1., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin "Ndërtim i kanalizimeve të ujërave të zeza në Bllokun mbi rrugën nr.5, Lagje nr. 3, Sarandë", për certifikimin e punimeve në kundërshtim me specifikimet teknike**.**
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Subjektit "K. C." SHPK, me përfaqësues ligjor z. E. C., me nr. Licence MK.2., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin "Ndërtim stacioni i ri pus-çpimi në Vrion dhe lidhja me rrjetin kryesor transmetues", për certifikimin e punimeve të pakryera me pasojë dëm ekonomik në vlerën **446,000 lekë pa TVSH**.
(Më hollësisht trajtuar në Pikën 7, faqe 39-63, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

E. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2, kontratave individuale të punës, neni 13, pika 2.c dhe 2.d, për shkeljet e evidentuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i kërkojmë Administratorit, fillimin e procedurave për dhënie masë disiplinore, si më poshtë:

I. "Vërejtje me paralajmërim", për:

1. z. F. B., me detyrë Kryetar i Degës Teknike, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:
- Nuk ka verifikuar preventivin e punimeve si dhe ka përllogallitur fondin limit me magësi, por pa pasoja financiare, për procedurat: "Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial, Ksamil", "Ndërtim i KUZ Lugu i Dardhës", "Përmirësim i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të ndotura, Rr. 13 Bibilenjtë, Rr. Abedin Dino…", "Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë".
-Në bashkëpunim me njësitë e prokurimit përkatëse, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore për procedurat e prokurimit: "Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial,

Ksamil", "Ndërtim i KUZ Lugu i Dardhës", "Përmirësim i KUZ Sarandë (Sarandë ITUN, Bypas dhe vendosje saraçineska manovrimi, ajrues)", "Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë",

II. "Vërejtje" për:

1. znj. A. V., Juriste, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:
Në bashkëpunim me njësitë e prokurimit përkatëse, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore për procedurat e prokurimit: "Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial, Ksamil", "Përmirësim i KUZ Sarandë (Sarandë ITUN, Bypas dhe vendosje saraçineska manovrimi, ajrues)", "Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë", "Mirëmbajtje dhe riparime të elektropompave të stacioneve të pompimit të UK Sarandë". S*ipas procedurës së prokurimit* "Blerje dy automjete për nevojat e shoqërisë", nuk është bërë ftesë për ofertë për 5 OE por për 3.

2. z. N. Ç., Inxhinier terreni, Dega Teknike, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:
Në bashkëpunim me njësitë e prokurimit përkatëse, ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me aktet ligjore për procedurat e prokurimit: "Ndërtim i sistemit të KUZ, rrjet sekondar dhe tercial, Ksamil", "Përmirësim i KUZ Sarandë (Sarandë ITUN, Bypas dhe vendosje saraçineska manovrimi, ajrues)", "Ndërtim rrjet kanalizimi të ujërave të zeza mbi rrugën nr. 5, Lagje nr. 3, Sarandë"

3. z. A. M., inxhinier mekanik, Sektori Elektromekanik,
4. z. A. K., Inxhinier Elektrik, Sektori Elektromekanik, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, për arsye se:
Sipas procedurës së prokurimit "Mirëmbajtje dhe riparime të elektropompave të stacioneve të pompimit të UK Sarandë", kanë hartuar kritere jo në përputhje me aktet ligjore. *Sipas procedurës së prokurimit* "Blerje dy automjete për nevojat e shoqërisë", nuk është bërë ftesë për ofertë për 5 OE por për 3.

5. z. K. K., Drejtor Teknik,
6. z. A. B., Përgjegjës i ITUN,
7. z. E. I., Ekonomist Dega e Shitjes, në cilësinë e anëtarëve të KVO, për arsye se:
Pasi sipas procedurës së prokurimit "Blerje dy automjete për nevojat e shoqërisë", është kualifikuar një OE, pa plotësuar dokumentacionin tekniko ligjor të parashikuar në dokumentet e tenderit.

8. znj. Zh. M., Drejtor Tregtar, për arsye se:
- Në 10 raste nuk ka plotësuar dokumentacionin për veprimet e kryera me bankë me urdhër xhirimet e transaksioneve.
- Për mos likuidimin në 10 raste të furnitorëve brenda afateve të parashikuara në kontratat dy palëshe.
- Për deklarim me vonesë në sistemin ESIG të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore duke marrë gjoba institucioni në shumën 76,437 lekë.

V. ANEKSE

Aneksi 1.

- Nga Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë nuk është respektuar afati 20 ditor nga data e njoftimit të Raportit të Auditimit, në lidhje me raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", neni 15, germa "j", ku përcaktohet që:

> j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës

- Me shkresën nr. 242 prot., datë 11.06.2019, Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë ka respektuar afatin 6 mujor nga data e njoftimit të Raportit të Auditimit, në lidhje me raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.
- Me shkresën nr. 794/6 prot., datë 03.12.2018, protokolluar në UKS SHA me nr. 738 prot., datë 24.12.2018, si dhe shkresën me objekt "Për një ndryshim në shkresën përcjellëse të KLSH-së prot., datë 794/6 prot., datë 03.12.2018, mbi raportin përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike-financiare të UKS SHA".
- Me shkresën nr. 429/30 prot., datë 14.08.2019, janë dërguar në Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë rekomandimet dhe Raporti Përfundimtar në zbatim të programit të auditimit nr. 429 prot., datë 10.06.2019, me objekt "Për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të ushtruar në Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë", ku janë lënë rekomandimet si më poshtë:

> -Në lidhje me Masa Organizative, rekomanduar 43 (dyzetë e tre) masa, 43 (dyzetë e tre) masa janë pranuar, nga të cilat 16 (gjashtëmbëdhjetë) masa janë zbatuar, 2 (dy) masa janë zbatuar pjesërisht, 18 (tetëmbëdhjetë) masa janë në proces zbatimi dhe 7 (shtatë) masa nuk janë zbatuar.
> - Në lidhje me Masa për Shpërblim Dëmi, rekomanduar 5 (pesë) masa në vlerën 711,556 lekë, 5 (pesë) masa janë pranuar nga të cilat 2 (dy) masa janë zbatuar pjesërisht, 1 (një) masë është në proces zbatimi dhe 2 (dy) masa janë zbatuar. **Në total është arkëtuar shuma 221,495 lekë.**
> -Në lidhje me Masa për Eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efiçençë dhe efektivitet të fondeve publike, rekomanduar 4 (katër) masa: 4 (katër) masa janë pranuar, 2 (dy) masa janë zbatuar dhe 2 (dy) masa nuk janë zbatuar.
> -Në lidhje me Masat Disiplinore, rekomanduar 9 (nëntë) masa: 9 (nëntë) masa janë pranuar nga të cilat 1 (një) masë nuk është zbatuar dhe 8 (masa) janë zbatuar.

Rekomandime	Rekomanduar	Pranuar	Të papranuara	Të zbatuara	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pazbatuara
Masa organizative	43	43	0	16	2	18	7
Masa shpërblim dëmi	5	5	0	2	2	1	0
Masa për përdorimin me EEE	4	4	0	2	0	0	2
Masa disiplinore	9	9	0	8	0	0	1
Totali	**61**	**61**		**28**	**4**	**19**	**10**
Totali në %	**61 masa në 100%**	**100%**	**0%**	**45.9%**	**6.5%**	**31.1%**	**16.5%**

B. MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, Përgjegjësja e Zyrës së Financës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të saktësojnë vlerën e nën-huas, referuar vlerës së nënshkruar sipas Marrëveshjes së nën-huas, datë 04.05.2003, bazuar në Marrëveshjen e kredisë.

1.2. Rekomandimi: Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit dhe Administratori i UKS SHA, duhet të marrin në analizë këtë situatë, të bëjnë me dije strukturat të cilat kanë përgjegjësinë për këtë investim, si Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe PIU Ujit, për mosfunksionimin e Impiantit të Trajtimit të Ujërave të Ndotura Sarandë, për shkak të dështimit të këtij investimi dhe obligimit të UKS SHA për shlyerjen e detyrimeve të kredisë të marrë për këtë qëllim.

UKS SHA të kërkojë nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve që në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe PIU i Ujit, si kontraktuese me kompaninë zbatuese, të marrin masa të menjëhershme për përfundimin e këtij investimi brenda kostos së parashikuar dhe sipas parametrave teknikë të përcaktuar në kontratë, me qëllim vënien në funksionim të ITUN Sarandë.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi 1.1 dhe 1.2, është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 13 prot., datë 11.01.2019, USK SHA është drejtuar MIE, AKUM, PIU dhe MFE për vënie në dispozicion të të gjithë dokumentacionit kredinë e Bakës Botërore.

2.1.Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, Përgjegjësja e Zyrës së Financës në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të saktësojnë vlerën e nën-huas, referuar vlerës së nënshkruar sipas Marrëveshjes së nën-huas, datë 07.07.2003.

2.2.Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizime (ish DPUK), PIU e Ujit, Ministrinë e linjës dhe Ministrinë e Financave, të marrin masa të menjëhershme për analizimin e situatës, të saktësojnë edhe njëherë vlerën e shpenzimeve sipas natyrës dhe dokumentacionit justifikues përkatës, të kryer në kuadër të këtij projekti, si dhe të **evidentojnë statusin e vlerës prej 100,368,451 lekë**, për të cilat UKS SHA, nuk disponon dokumentacionin përkatës dhe destinacionin e përdorimit e kësaj vlere.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi 2.1 dhe 2.2, është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Referuar e-mail-it të datës 03.11.2019, mbi komunikimin me MFE dhe e-mail-it i datës 04.02.2019, AKUM mbi rakordimin e shumës të kredisë.

3.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit, Administratori dhe Përgjegjësi i Zyrës së Financës të marrin masa të menjëhershme për regjistrimin në kontabilitet në shpenzimeve të akumuluara deri në 31.12.2018, për koston e kredive në total në shumën 427,911.42 EUR dhe 367,125.75 USD.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga ana e UKS SHA janë bërë kontabilizimet, duke futur në shpenzimet e vitit ushtrimor 2018 të gjitha interesat, komisionet dhe penalitetet përkatëse që nuk janë njohur si të tilla qysh prej vitit 2003 deri në vitin 2017 në shumën 427,911.42 euro dhe 367,125.75 USD të cilat nga ana fiskale janë shpenzime të pa zbritshme.

4.1. Rekomandimi: Administratori dhe Përgjegjësi i Zyrës së Financës, të marrin masa për korrigjimin e veprimeve kontabël, përllogaritjen e diferencave nga konvertimi në fund të çdo viti ushtrimor, duke filluar nga viti 2008-2018, me kursin e këmbimit të fund vitit përkatës, si dhe reflektimin e rezultatit, në pasqyrat financiare të vitit 2018.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: UKS SHA në vitin 2018 ka bërë rivlerësimin me kursin e datës 31.12.2018. Kredia e BEU në shumën 2,432,187 euro. Ky rivlerësim nuk është bërë për periudhën 2008 deri 2017, për faktin efekti do të ishte i njëjtë.

5.1. Rekomandimi: Administratori dhe Përgjegjësi i zyrës së Financës të marrin masa për kryerjen e zhvlerësimit të zërit të kërkesave të arkëtueshme, me qëllim që të sigurohet një pasqyrim i vërtetë e i besueshëm i pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të parasë së njësisë ekonomike.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 10, datë 24.04.2020, të Këshillit të Administrimit është miratuar norma e provizionit të detyrimeve në masën 0.5% mbi totalin e këtyre detyrimeve.

6.1. Rekomandimi: Këshilli i Administrimit, Administratori dhe Zyra Financës, të marrin masa për përllogaritjen dhe derdhjen në vijimësi në favor të të përndjekurve politikë të shumës prej 2,285,600 lekë.

Menjëherë dhe vijimësi

Statusi: Rekomandimi është realizuar pjesërisht.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhër xhirimin e datës 31.12.2019, në Raiffesein Bankë është derdhur detyrimi në shumën 1,722,680 lekë për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë.

7.1. Rekomandim: Administratori, Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme të marrin masa të menjëhershme, për shqyrtimin dhe miratimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2017, si dhe zbatimin e afateve të miratimit dhe dorëzimit e tyre në organet përkatëse (Drejtori Tatimore dhe Qendrën Kombëtare të Biznesit), të Pasqyrave Financiare për periudhat ushtrimore në vazhdim.

Menjëherë dhe vijimësi

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Nga ana e UKS SHA me Vendimin nr. 2, datë 25.04.2019, të Asamblesë së Përgjithshme është bërë miratimi i pasqyrave financiare të vitit 2017, i cili është depozituar në QKB dhe në Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Sarandë.

8.1. Rekomandim: Këshilli i Administrimit dhe Sekretari i Këshillit të Administrimit, të marrin masa për plotësimin e regjistrit të mbledhjeve, si dhe nënshkrimin mbi pjesëmarrjen në këto mbledhje të secilit anëtar të Këshillit të Administrimit.

Menjëherë dhe vijimësi

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga ana e UKS SHA janë kryer të plota regjistrimet e mbledhjeve të KA, si edhe nënshkrimet përkatëse.

9.1. Rekomandim: Anëtarët e Këshillit të Administrimit të marrin masa të menjëhershme për lidhjen e kontratës me UKS SHA, ku të përcaktojë në mënyrë të qartë indikatorët e performancës që duhet të realizojnë në terma vjetorë, në përputhje me biznes-planin e shoqërisë, si dhe miratimin e tyre në ministrinë e linjës.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Me kontratën e datës 04.02.2021, është lidhur kontrata e performancës ndërmjet Asamblesë Aksionare (Bashkia Sarandë) dhe AKUM. Si dhe më datën 24.02.2020, dhe 01.03.2021, janë lidhur kontratat individuale të punës me anëtarët e Këshillit të Administrimit konkretisht, z. K. K dhe z. E. GJ.

10.1.Rekomandim: Administratori duhet të kërkojë mbledhjen e menjëhershme të Asamblesë së Përgjithshme të UKS SHA, me qëllim zgjedhjen e anëtarit të tretë të Këshillit të Administrimit, plotësimin e kuorumit të domosdoshëm për marrjen e vendimeve.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme nr. 1, datë 28.02.2019, është miratuar si zëvendësues i z. A. L i cili është larguar me kërkesë për dorëheqje të parevokueshme dhe është vendosur z. D. B.

11.1. Rekomandim: Administratori, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Administrimit, duhet të sigurojë mbledhjen e Këshillit të Administrimit çdo muaj, me qëllim ndjekjen e problematikave, ecurisë së UKS SHA dhe marrjen e vendimeve në kohën e duhur.

Menjëherë dhe vijimësi

Statusi: Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

Koment i grupit të auditimit: Gjatë vitit 2019, Këshilli i Administrimit është mbledhur vetëm për muajt janar, qershor dhe korrik. Për vitin 2020, nuk është mbledhur vetëm në muajin janar ndërsa për muajt e tjerë të vitit KA është mbledhur rregullisht. Për vitin 2021, KA është mbledhur rregullisht. Të dhënat mbi mbledhjet e KA janë marrë duke u bazuar në regjistrin për pjesëmarrjen në mbledhje të anëtarëve të KA.

.

12.1. Rekomandim: Administratori dhe Këshilli i Administrimit i UKS SHA Sarandë, duhet të marrin masa të menjëhershme, për përcaktimin e klasave sipas pozicioneve të punës, nivelit të pagave sipas klasave, shqyrtimin dhe miratimin e tyre në Këshillin e Administrimit si dhe miratimin e tyre nga Asambleja e Përgjithshme.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Në lidhje me këtë rekomandim nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e tij.

13.1. Rekomandimi: Administratori duhet të marrë masa për paraqitjen në Këshillin e Administrimit për shqyrtim, kontroll dhe miratim të pasqyrave financiare, pas auditimit nga eksperti kontabël.

Në vijimësi

Statusi: Rekomandimi është zbatuar deri në momentin e auditimit.

Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 13, datë 25.06.2020, të Këshillit të Administrimit janë miratuar pasqyrat financiare për vitin 2019. Me Vendimin nr. 4, datë 12.04.2021, të Këshillit të Administrimit janë miratuar pasqyrat financiare për vitin 2020. Me Vendimin nr. 5, datë 15.06.2022, të Këshillit të Administrimit janë miratuar pasqyrat financiare për vitin 2021. Së bashku me relacionin përkatës.

14.1. Rekomandimi: Administratori, Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme duhet të marrin masa për emërimin në kohën e duhur të Ekspertit Kontabël, me qëllim auditimin e pasqyrave financiare të UKS SHA, përpara publikimit të tyre.

Në vijimësi

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga ana e UKS SHA me vendimin nr. 2, të Asamblesë së Përgjithshme është bërë caktimi i ekspertëve ligjor të studiove "F. F" ShPK "C." përfaqësuar nga z. F. S dhe "L. A" ShPK përfaqësuar nga znj. L. A.

15.1. Rekomandim: Administratori, Juristi i UKS SHA dhe Zyra e Financës, të marrin masa të menjëhershme për ndjekjen e procedurave për pajisjen me dokumente të pronësisë të të gjitha pasurive të paluajtshme të cilat janë në inventar, si dhe të përfshira në pasqyrat financiare të UKS SHA.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Ka ende raste të pasurive të paluajtshme të pa pajisura me certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor.

16.1. Rekomandim: Administratori i UKS SHA, Zyra e Financës, Këshilli i Administrimit të marrin masa për fillimin e procedurave të rivlerësimit të pasurive të paluajtshme, të cilat rezultojnë me vlerë të pa përditësuar me vlerën aktuale të tregut, duke mos pasqyruar drejtë vlerën reale të tyre në aktiv të bilancit.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 754 prot., datë 28.12.2018, të Administratorit të Shoqërisë është ngritur grupi i punës për hartimin dhe miratimin në organet kolegjiale të nisjes së procedurave, të rivlerësimit të pasurive të paluajtshme të cilat rezultojnë me vlera të pa përditësuara me vlerën aktuale të tregut.

17.1. Rekomandimi: Përgjegjësja e Zyrës së Financës të marrë masa të menjëhershme, për dokumentimin e veprimeve të kryera me bankë në dy aspekte, konkretisht: dokumentacionin autorizues dhe dokumentacionin justifikues të shpenzimeve, duke bashkëngjitur dokumentacionit origjinal për çdo transaksion të kryer.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Deri më datën 31.12.2021, kjo problematikë është konstatuar përsëri.

18.1. Rekomandimi: Administratori të marrë masa të menjëhershme për rishikimin e draftit ekzistues mbi normativat e karburantit, shqyrtimin dhe miratimin e tyre, nxjerrjen e urdhrit përkatës për zbatim nga përdoruesit e mjeteve të UKS SHA.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 8/1, datë 24.03.2020, të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar normativat për konsumin e karburantit. Ky vendim nuk përfshin periudhën nga data 01.01.2019, deri më datën 23.03.2020, pra mjetet e shoqërisë nuk kanë pasur normativa të miratuara mbi konsumin e karburantit.

19.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, të marrë masa të menjëhershme për ngritjen e grupit të punës i cili duhet të hartojë udhëzimin mbi mënyrën e administrimit të karburantit për nevoja të shoqërisë, ku të përcaktohet personi urdhërues dhe arsyeja e lëvizjes së mjetit, drejtuesi i mjetit, personi udhëtues/specialistë, si dhe personi përgjegjës i cili duhet të konfirmojë prezencën e mjetit dhe kryerjen e shërbimit. Të përcaktojë formatin tip të urdhër i shërbimit, fletës së udhëtimit dhe fletës së punës dhe personin përgjegjës për administrimin e shpenzimeve të karburantit dhe rakordimin nga ana e tij me Zyrën e Financës. Pas paraqitjes nga grupi i punës dhe shqyrtimit të këtyre dokumenteve, Administratori duhet të nxjerrë urdhër për miratimin e tyre.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: UKS SHA me Vendimin nr. 755, datë 28.12.2018, ka krijuar komisionin për hartimin dhe monitorimin e përdorimit të karburantit.

20.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e strukturës organizative të UKS SHA, me postin e Departamentit/Drejtorisë Teknike dhe Departamentit/Drejtorisë Tregtare.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Rregullorja e Brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit të miratuar me Vendimin nr. 12, datë 28.05.2020, të Këshillit të Administrimit konkretisht në nenin 14, dhe neni 16, janë bërë pjesë e strukturës së Shoqërisë pozicioni Drejtori Teknik dhe Drejtori Tregtar.

21.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli i Administrimit, të marrin masa të menjëhershme për hartimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të UKS SHA, menjëherë pas miratimit të strukturës organizative, ku të pasqyrohet mënyra e organizimit, funksionimit të UKS, përshkrimi i punës sipas pozicioneve përkatëse, ndarja e detyrave, përgjegjësive dhe të drejtave për secilin post pune.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 12, datë 28.05.2020, të Këshillit të Administrimit është miratuar Rregullorja e Brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e institucionit.

22.1. Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli i Administrimit, të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e procedurave të rregullta për emërimet në punë, duke zhvilluar një proces transparent, i cili fillon me përcaktimin e kritereve, shpalljen dhe publikimin e vendeve vakante, si dhe përzgjedhjen e tyre.

Menjëherë dhe vijimësi

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Vendimin nr. 11/1, datë 24.04.2020, të Këshillit të Administrimit është miratuar procedura e rekrutimit të punonjësve. Me Vendimin nr. 738/8 prot., datë 28.12.2018, të Administratorit të Shoqërisë është ngritur komisioni për vlerësimin e kanditaurave.

23.1. Rekomandimi: Zyra e Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin e duhur (origjinal/ose fotokopje të noterizuara), inventarizimin e tyre, si dhe indeksimin e tyre sipas regjistrit të personelit.

23.2. Rekomandimi: Administratori dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa të menjëhershme për plotësimin e kontratave individuale të punës me të gjithë elementët e duhur për sa i përket pagës së punonjësve.

Menjëherë dhe vijimësi

Statusi: Rekomandimi 23.1 dhe 23.2, nuk është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Për vitet 2019-2021, kjo problematikë është konstatuar përsëri.

24.1. Rekomandimi: Administratori, Këshilli i Administrimit dhe Zyra e Burimeve Njerëzore të marrin masa të menjëhershme për rishikimin dhe miratimin e "Kontratës kolektive të punës".

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Me shkresën nr. 1663 prot., datë 23.05.2022, dhe nr. 1620 prot., datë 17.05.2022, ka nisur bisedimet me Sindikatën për lidhjen e kontratës kolektive të punës.

25.1. Rekomandimi: Administratori dhe Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa të menjëhershme për ndërprerjen e praktikave të tilla dhe zbatimin e nivelit të njëjtë të pagave për pozicione të njëjta pune.

Menjëherë dhe vijimësi

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Deri më datën 31.12.2021, kjo problematikë është konstatuar përsëri.

26.1. Rekomandimi: Administratori, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Financës të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin e drejtë të pagës bazë, mbi të cilën do të përllogariten elementët shtesë (pagës bruto) dhe mbi këtë elementët pakësues (paga neto).

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Deri më datën 31.12.2021, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

27.1. Rekomandimi: Administratori dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, të marrin masa të menjëhershme për përcaktimin e indikatorëve/kritereve, mbi vlerësimin e rezultateve në punë të stafit, përcaktimin e rregullave të procesit të vlerësimit, si dhe lëvizjen e stafit (ngritje/ulje në detyrë) në bazë të rezultateve dhe performancës së tyre në punë.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: UKS SHA me vendimin nr. 738/7, datë 28.12.2018, të Administratorit të Shoqërisë është krijuar komisioni për vlerësimin e performancës në punë sipas kritereve ligjore. Ky vendim është shoqëruar me të gjithë dokumentacionin justifikues.

28.1. Rekomandimi: Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra Financës, të marrin masa të menjëhershme për dokumentimin e gjithë procedurave të nevojshme për identifikimin dhe kërkesën sipas nevojave, argumentimin, kryerjen, prezencën e punonjësve dhe masën shpërblimit, në rastet e kryerjes së punës jashtë orarit zyrtar të saj.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar deri më datën 31.12.2021.

Koment i grupit të auditimit: Referuar listë pagesave dhe listë prezencave të punonjësve kjo problematikë nuk është konstatuar përgjatë viteve 2019-2021.

29.1 Rekomandimi: Administratori dhe Këshilli i Administrimit të UKS SHA, duhet të marrin masa të menjëhershme për rishikimin e Plan-biznesit, si dhe diskutimin dhe miratimin e tij në Këshillin e Administrimit dhe më tej në Asamblenë e Përgjithshme të UKS SHA.

29.2.Rekomandimi: Administratori i UKS duhet të marrë masa të menjëhershme për hartimin e Programeve ekonomike, miratimin e tyre në organet kolegjiale, për vitet në vijim, në përputhje me Plan-Biznesin e shoqërisë, me qëllim përcaktimin e treguesve ekonomiko-financiarë, si të ardhurat dhe shpenzimet e shoqërisë, fitimi/humbjen, kapitalin, likuiditetet etj., me qëllim marrjen e vendimeve bazuar në analizën e tyre.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi 29.1, dhe 29.2, është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Vendimin nr. 2, datë 24.2..2020, nr. 7, datë 24.03.2020, dhe nr. 18/1, datë 29.07.2020, të Këshillit të Administrimit, është miratuar plani i biznesit për vitin 2020, vitet 2019-2023 dhe 2020-2024.

30.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, duhet të marrë në analizë shkaqet e nivelit të lartë të mos faturimit, nxjerrjen e përgjegjësive si dhe marrjen e masave të menjëhershme për identifikimin e të gjithë përdoruesve të ujit të prodhuar nga UKS SHA, me qëllim rritjen e nivelit të faturimit dhe arkëtimeve/të ardhurave të shoqërisë.

30.2. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, duhet të marrë në analizë shkaqet e mos shlyerjes së detyrimeve nga klientët (familjarë, shtetërorë, biznese etj.) nxjerrjen e përgjegjësive si dhe marrjen e masave të menjëhershme detyruese dhe shtrënguese për arkëtimin e detyrimeve.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi 30.1, dhe 30.2, është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Referuar të dhënave nga Drejtoria Teknike humbjet prodhim-faturim për vitin 52%.

31. Gjetje nga auditimi: Analiza e ujit sipas të dhënave të laboratorit të shoqërisë bëhet për 19 prej 67 analizash të specifikuara në VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "*Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm*" shtojca I "*Kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm, parametrat, vlerat e tyre dhe metodat standarde të analizave*". Analizat bëhen me metoda instrumentale që japin një siguri të arsyeshme se rezultatet e tyre janë të pranueshme.
Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe nr. 20-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
31.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, duhet të marrë masa për kryerjen të gjithë spektrit të analizave të ujit sipas rregullores *"Cilësia e ujit të pijshëm*", shtojca I "*Kërkesat e cilësisë për ujin e pijshëm, parametrat, vlerat e tyre dhe metodat standarde të analizave*".

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

32.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, duhet të marrë masa për ndërprerjen e praktikës së faturimit afro-fe, si dhe pajisjen e abonentëve me matës uji.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: UKS SHA për vitin 2018 kanë kaluar faturimin "afrofe" dhe tarifë shërbimi 3,146 abonentë tek të cilët janë vendosur matës të rinj nga të cilët 2,963 tek abonentët familjarë dhe 183 tek abonentët biznesi, pra të gjithë këta abonentë u hoqën nga faturimi afrofe dhe kaluan në faturimin me matës. Për periudhën deri në fund të muajit maj 2019 numri i abonentëve me faturim afrofe me tarifë shërbimi është ulur në 1,271 abonentë nga 4,635 që ishte më herët pra një zbritje prej 3,364 abonentë. Nga 1,271 abonentë, 541 janë me faturim afrofe dhe 730 me tarifë shërbimi.

33.1.Rekomandim: Administratori dhe Zyra e Financës të marrin masa për kartelizimin dhe regjistrimin në kartelat përkatëse të të gjitha ndryshimeve (shtesa/pakësime) të ndodhura gjatë periudhave ushtrimore.
33.2. Rekomandim: Të merren masa që në të ardhmen kryerja e inventarizimit të bëhet nga komisionet përkatëse, në përputhje me llojet e aktiveve (afatgjatë dhe afatshkurtra).

Menjëherë dhe vijimësi

Statusi: Rekomandimi 33.1, dhe 33.2, është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga ana e UKS SHA për inventarizimin e AASH dhe AAGJM është ngritur komisioni i inventarizimeve me urdhër të administratorit nr. 696, datë 19.11.2018. Ku është kryer inventarizimi sipas dispozitave ligjore përkatëse.

34.1. Rekomandimi: UKS SHA, si Autoritet Kontraktor duhet të marrë masa të menjëhershme, që për procedurat e finalizuara të prokurimit në vlerën mbi 100,000 lekë të lidhë kontratat përkatëse me OE të shpallur fitues, me qëllim ndjekjen e tyre dhe krijimin e kushteve për nxjerrjen e përgjegjësive dhe vendosjen e penaliteteve, në rast të mosplotësimit të kushteve kontraktuale.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

35.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor UKS SHA, të marrë masa për të negociuar me kontraktuesin "L" SHPK, për ndryshimin e vlerës totale të kontratës "Marrëveshje kuadër" nga 11,974,500 lekë pa TVSH, vlerë e cila përkon me vlerën limit të kontratës, në vlerën 10,890,000 lekë vlerë e cila përkon me ofertën fituese (sasi*çmim për njësi), të paraqitur nga kontraktori "L" SHPK në Dokumentet e Tenderit.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: UKS SHA ka marrë masa për implementimin e këtij rekomandimi. Në kuadër të marrëveshjes Shoqëria nuk ka kaluar detyrimin prej 10,890,000 lekë.

36.1. Rekomandimi: UKS SHA, si Autoritet Kontraktor duhet të marrë masa, për ndërprerjen e praktikave të copëzimit të fondeve, në rast të prokurimit të mallrave apo grup mallrave të së njëjtës natyrë, të shërbimeve apo punëve publike, me qëllim zhvillimin e procedurave të prokurimit në përputhje me fondin limit të përllogaritur për to dhe kufijtë monetarë të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik.

Në vijimësi

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe përgjatë viteve 2019-2021, konkretisht në procedurat e materiale të kancelarisë.

37.1. Rekomandimi: Administratori, në cilësinë e Titullarit të njësisë, duhet të marrë masa për njohjen dhe zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm nga i gjithë stafi i UKS SHA, me qëllim funksionimin e të gjithë komponentëve të tij përbërës, Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informacioni dhe komunikimi dhe Monitorimi.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces.

Koment i grupit të auditimit: Me kontratën nr. 188 prot., datë 30.05.2022, është hartuar kontrata shërbime me objekt hartimi dhe zbatimi i dokumentit të vlerësimit të riskut.

C.1 MASA SHPËBLIM DËMI:

Nga Administratori i Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **711,556 lekë,** përfituar më tepër, si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Administratori i UKS SHA, Zyra e Financës marrë masa për zhdëmtimin nga secili prej përdoruesve të mjetit (sipas aneksit bashkëngjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit pas përllogaritjes së vlerës në lekë sipas çmimit përkatës), të sasisë së karburantit prej 2745 litra, afërsisht **në vlerën 378,810 lekë**, të pajustifikuar me dokumentacionin përkatës.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

Koment i grupit të auditimit: Deri më datën 31.05.2022, është mbajtur shuma në total 133,389 lekë nga personat përgjegjës.

2.1. Rekomandim: Administratori i UKS SHA, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Administrimit në bashkëpunim me Zyrën e Financës, të marrë masa për arkëtimin e vlerës së

shpërblimeve të përfituar padrejtësisht, për pjesëmarrje në mbledhjet e KA, nga anëtarët e tij, përkatësisht z. S. K **në shumën 123,760 lekë** dhe z. A. L **në shumën 70,720 lekë.**

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.

Koment i grupit të auditimit: z. S. K është likuiduar me mandat arkëtimi 481, datë 11.05.2022, në shumën 10,000 lekë.

3.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor UKS SHA, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **60,169 lekë,** të cilësuar si dëm ekonomik, për shkak të zbatimit me vonesë të kontratës nga OE dhe mos aplikimit të penaliteteve për këtë vlerë nga Autoriteti Kontraktor.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është në proces zbatimi.

Koment i grupit të auditimit: Me anë të kërkesës nr. 738/4 prot., datë 17.01.2021, OE lidhur me detyrimin e lënë nga KLSH kërkoi që kjo vlerë ti kryhet zbritje nga Shoqëria mbi 5%.

4.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor UKS SHA, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **59,508 lekë,** të cilësuar si dëm ekonomik, për shkak të punimeve të pakryera nga kontraktori "A." SHPK.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Më datën 24.01.2019, është arkëtuar shuma 59,508 lekë nga OE.

5.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor UKS SHA, të marrë masa për arkëtimin e vlerës në **18,589 lekë,** të cilësuar si dëm ekonomik, për shkak të mos aplikimit të penalitetit, për vonesë në realizimin e kontratës nga ana e kontraktorit "A." SHPK.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Me mandat arkëtimi 17, datë 14.01.2019, është kryer likuidimi në shumën 18,598 lekë nga OE

C.2 MASA PR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandimi: Administratori i UKS, të marrë masa të menjëhershme që të rishikojë nevojat për staf (punonjës) si dhe të plotësojë strukturën organizative të UKS në përputhje me këto nevoja dhe të miratojë numrin e punonjësve në organet drejtuese të UKS SHA.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Kjo problematikë është konstatuar edhe për vitet 2019-2021, ku ka pasur përsëri tejkalim të strukturës së miratuar nga vendimet respektive nga Këshilli Mbikëqyrës.

2.1. Rekomandimi: Administratori dhe Zyra e Burimeve Njerëzore, të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e rregullave dhe procedurave, si dhe dokumentimin e tyre, në rastet e marrjes së masave disiplinore, largimit nga detyra, apo pushimit të menjëhershëm të punonjësve nga puna.

Në vijimësi

Statusi: Rekomandimi është zbatuar deri më datën 31.12.2021.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i ushtruar për periudhën nga vitet 2019-2021, është konstatuar se Shoqëria nuk ka asnjë proces gjyqësor me punonjësit e saj për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.

3.1. Rekomandimi: Administratori dhe Zyra Financës, të marrin masa të menjëhershme ndërprerjen e praktikave të tilla, të cilat sjellin pasoja negative për buxhetin e shoqërisë.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar deri më datën 31.12.2021.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i ushtruar për vitet 2019-2021, konstatohet se kjo praktikë është përmirësuar.

4.1. Rekomandim: UKS SHA, si Autoritet Kontraktor, të marrë masa për negocimin e afatit të zbatimit të kontratës së "Marrëveshjes së Nivelit të Shërbimit", deri më 26.07.2019, duke përllogaritur fillimin e periudhës 1 vjeçare të mirëmbajtjes, nga data 26.07.2018, e dorëzimit të përmirësimit të sistemit nga operatori ekonomik "I. S" SHPK.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

D. MASA DISIPLINORE:

D.I. Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, që bazuar në Statutin e UKS SHA, nenin 18 "Administratori i Shoqërisë", dhe 21 "Detyrimi i besnikërisë", të marrë masën **"Vërejtje me paralajmërim";**

1. Për Z. Sh. L, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA, si dhe në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë, për shkeljet e mëposhtme:

- Mungesë të plan biznesit të Shoqërisë, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme;
- Mungesë të Programeve vjetore ekonomiko-financiarë të shoqërisë;
- Mungesë e Rregullores së Brendshme të Funksionimit të UKS SHA, në përputhje me ndryshimet strukturore të saj;
- Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, reflektuar në mungesën e Strategjisë së Riskut, mungesën e Grupit të Menaxhimit Strategjik, mungesën e Regjistrit të Riskut, mungesën e Pyetësorit të Vetëvlerësimit, si dhe Gjurmës së Auditimit dhe Hartës së Proceseve, për disa aktivitete kontrolli;
- Mosmiratim të pasqyrave financiare të viteve ushtrimore 2016 dhe 2017 në Këshillin e Administrimit;
- Marrjen e vendimeve në Këshillin e Administrimit në kushtet e mosplotësimit të kuorumit të nevojshëm.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi nuk është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, nuk është marrë asnjë masë për realizimin e këtij rekomandimi.

D.II. Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas personave përgjegjës i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit si dhe Administratorit të Shoqërisë, që mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, Statutin e Ujësjellës Kanalizime Sarandë SHA, si dhe në Kontratën Individuale të Punës, nenin 12 "Masa disiplinore" të marrë masat disiplinore si më poshtë:

1. <u>Për znj. U. Sh</u>, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Burimeve Njerëzore, si dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, propozohet masa disiplinore ***"Vërejtje me paralajmërim",*** bazuar në nenin 12, pika 1, germa "d", për shkeljet e mëposhtme:

- Mangësi të theksuara në administrimin e dosjeve të personelit;
- Mangësi të theksuara në listë-pagesat e punonjësve, të cilat gjatë periudhës 2016, janë mbajtur nga Përgjegjësi i Zyrës së Burimeve Njerëzore;
- Mangësi në dokumentacionin e listë-prezencave në punë si dhe dokumentimin e dhënies së shpërblimeve për orë jashtë orarit zyrtar të punës.

2. <u>Për znj. Zh. M</u>, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës, si dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, propozohet masa disiplinore ***"Vërejtje me shkrim",*** bazuar në nenin 12, pika 1, germa "b", për shkeljet e mëposhtme:

- Mangësi në mbajtjen në mënyrën e duhur të dokumentacionit justifikues të shpenzimeve të kryera me bankë;
- Mos kryerjen e regjistrimeve kontabël në lidhje me nënhuatë dhe koston e tyre, në momentin e njohjes së kësaj problematike, pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017;
- Regjistrim i aktiveve (pasuri të paluajtshme) në disa raste pa poseduar dokumentacion vërtetues të pronësisë;
    - Mosfunksionim i sistemit të kontrollit të brendshëm, reflektuar në mungesën e Strategjisë së Riskut, mungesën e Grupit të Menaxhimit Strategjik, mungesën e Regjistrit të Riskut, mungesën e Pyetësorit të Vetëvlerësimit, si dhe gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve, për disa aktivitete kontrolli.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 756, datë 28.12.2018, të Administratorit të shoqërisë janë dhënë masa disiplinore për punonjësit U. Sh. dhe Zh. M.

3. <u>Për anëtarët e Njësisë së Prokurimit:</u>

3.1. V. G
3.2. Z. K
3.3. E. G
3.4. A. V
3.5. E. R
3.6. A. B

Propozohet masa disiplinore ***"Vërejtje me shkrim",*** bazuar në nenin 12, pika 1, germa "b", për shkelje e konstatuara gjatë zhvillimit të procedurat e prokurimit si më poshtë:

Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje gazoil D1" viti 2016, u konstatuan shkelje në kundërshtim me:

- LPP me ndryshime, neni 59 "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës", pika 2;
- LPP me ndryshime, neni 23 "Specifikimet teknike", pika 2;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 27 "Kontrata e mallrave" pika 3;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 27 "Kontrata e mallrave" pika 6, germa (c).

Në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje gazoil D1" viti 2016 (shtesë kontrate), u konstatuan shkelje në kundërshtim me:
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 36 "Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës", pika 2, germa (c).

Në procedurën e prokurimit me objekt "Përmirësimi i sistemit të faturimit", u konstatuan shkelje në kundërshtim me:
-VKM nr. 710, datë 21.8.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit" i ndryshuar, pika 2, germa (b) dhe (c);
-Udhëzimi nr. 4099, datë 3.11.2014 "Për një ndryshim në udhëzimin nr. 1159, datë 17.3.2014, të Ministrit të Shtetit për inovacionin dhe administratën publike, "Për hartimin e marrëveshjes së nivelit të shërbimit", pika 5.

Menjëherë

Statusi: Rekomandimi është zbatuar.

Koment i grupit të auditimit: Me Urdhrin nr. 756, datë 28.12.2018, të Administratorit të shoqërisë janë dhënë masa disiplinore për punonjësit A. V, V. G, A. B, E. R nuk ka marrë masë në kushtet se nuk është më në marrëdhënie pune, Z. K, E. G.

Aneksi 2.

Për periudhën objekt auditimi 2019, 2020, 2021 nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Strukturave Drejtuese (Këshilli i Administrimit dhe Administratori), vendimet e marra dhe zbatimi i tyre, u konstatua se Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë është emëruar dhe është pjesë përbërëse e Këshillit të Administrimit me të drejtë vote. *Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9901, date 14.04.2008, "Për tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar,* më konkretisht në Kreun II, *Këshilli i Administrimit,* sistemi me një nivel, Neni 155, *Numri, Emërimi dhe përbërja e Këshillit të Administrimit,* Pika 1, *Këshilli i Administrimit përbëhet nga të paktën tre apo një numër më i madh, por jo më shumë se 21 anëtarë. Anëtarët janë individë, shumica e të cilëve duhet të jenë të pavarur dhe të ndryshëm nga Administratorët e shoqërisë.* Gjithashtu veprimi i mësipërme bie në kundërshtim edhe me Nenin 156, *Zgjedhshmëria e kufizuar,* Pika 2, *"Një individ nuk mund të zgjidhet si anëtar i Këshillit të Administrimit, nëse ai, njëkohësisht, është",* Germa b, *"është administrator i një shoqërie mëmë ose i një shoqërie të kontrolluar të shoqërisë".*

Pra siç shprehet qartë në ligj Administratori nuk mund të jetë pjesë përbërëse e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë.

Për vitin 2019 Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, përbëhet nga 3 anëtarë:

Z. Sh. L, Kryetar i Këshillit të Administrimit dhe Administrator i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë.

Z. S. K, Zv. Kryetar i Këshillit të Administrimit.

Z. D. B, anëtar i Këshillit të Administrimit.

Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, për vitin 2019 ka marrë në total 4 vendime, konkretisht si më poshtë:

1. Vendim Nr.1, dt.29/01/2019 me objekt: "Miratimi i ndryshimit të pagës minimale për punonjësit e Shoqërisë në shumën 26,000 (njëzet e gjashtë mijë) Lek, mbështetur në VKM nr. 809, dt.26/12/2018".
2. Vendim Nr.1/1, dt.29/01/2019 me objekt: "Vlera e një matësi që do të vendoset tek abonentët nga Shoqëria, do të jetë 3,212 (tre mijë e dyqind e dymbëdhjetë) Lek pa TVSH, (sipas përllogaritjes

së bërë nga Dega Teknike) dhe pika e dytë me objekt: "Likuidimi do të kryhet brenda një afati 12 mujor, me këste dhe do ti faturohet çdo abonenti në faturën përkatëse".
3. Vendim Nr.1/2, dt.29/01/2019 me objekt: "Miratimin e Regjistrit të parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2019 të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime SHA Sarandë, mbështetur në relacionin e hartuar dhe pasqyrat përkatëse, bashkangjitur".
4. Vendim Nr.2, dt. 24/06/2019 me objekt: "Miratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin 2018, së bashku me dokumentacionin përkatës", "Përcaktimin e humbjes të Shoqërisë të realizuar gjatë vitit financiar 2018 për shumën 132,057,127.41 Lek", "Kjo humbje mbartet në periudhat e kaluara", "Miratimin e raportit të ekspertëve kontabël të regjistruar të Shoqërisë "*&* A." ShPK, përfaqësuar nga znj. L. A mbi auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin 2018", "Të përcjellë Pasqyrat Financiare së bashku me raportin e Auditimit për shqyrtim dhe miratim në Asamblenë e Përgjithshme".
Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:
Pika 1. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Regjistri për pjesëmarrjen në mbledhje të anëtarëve të Këshillit të Administrimit) për Këshillin e Administrimit dhe Administratori, konstatohet se anëtaret nuk janë mbledhur të paktën 1 (një) herë në muaj, veprime këto në kundërshtim me ***VKM-në nr. 63, date 27/01/2016, Neni 14, Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit, Pika 1,*** ku përcaktohet se:

Neni 14: Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit *Pika 1. Këshilli i Administrimit mblidhet jo me pak se 1 (një) herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e Kryetarit.*

Pika 2. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Regjistri për pjesëmarrjen në mbledhje të anëtareve të Këshillit të Administrimit) për Këshillin e Administrimit dhe Administratori, konstatohet se anëtaret nuk kanë nënshkruar në Regjistrin e pjesëmarrjes në mbledhje, veprime këto në kundërshtim me ***VKM-në nr. 63, date 27/01/2016, Neni 14, Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit, Pika 6,*** ku përcaktohet që:

Neni 14 Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit *Pika 6. Këshilli i Administrimit mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhje, i cili nënshkruhet në çdo mbledhje nga anëtaret e Këshillit të pranishëm në atë mbledhje.*

Për vitin 2020 Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, përbëhet nga 3 anëtarë:
Z. K. K, Kryetar i Këshillit të Administrimit
Z. E. Gj, Zv. Kryetar i Këshillit të Administrimit
Z. Sh. L, anëtar i Këshillit të Administrimit dhe Administrator i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë.
Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, për vitin 2020 ka marrë në total 30 vendime, më konkretisht si më poshtë:
1. Vendim Nr.1, dt.24/02/2020 me objekt. "Zgjedhjen e të Këshillit të Administrimit Z. K. K, "Zgjedhjen e Zv. Kryetarit të Këshillit të Administrimit z. E. Gj", "Emërimin e sekretares së Këshillit të Administrimit znj. A. V".
2. Vendim Nr.2, dt.24/02/2020 me objekt: "Miratimin e Plan Biznesit të Shoqërisë për vitin 2020".
3. Vendim Nr.3, dt.24/02/2020 me objekt: "Miratimin e strukturës të Shoqërisë Ujësjllës-Kanalizime SHA Sarandë si dhe I.T.U.N çuke, sipas skemës së paraqitur për çdo pozicion pune", "Miratimin e pagave të punonjësve sipas detyrave funksionale, referuar tabelës së paraqitur", "Miratimi i numrit të punonjësve të Shoqërisë sipas strukturës për çdo pozicion pune do të jetë 165

punonjës", "Miratimin e shtesës prej 5% të numrit te punonjësve në raste emergjente ose gjatë sezonit turistik", “Të merren masa për hartimin e Rregullores së brendshme të Shoqërisë dhe përcaktimin e nivelit të klasave të pagave për çdo pozicion pune brenda muajit Mars 2020".

4. Vendim Nr.4, dt.24/02/2020 me objekt: "Miratimin e Regjistrit të parashikimeve Prokurimeve Publike për vitin 2020 të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime SHA Sarandë, mbështetur në relacionin e hartuar dhe pasqyrat përkatëse, bashkangjitur".

5. Vendim Nr.5, dt.24/02/2020 me objekt: "Miratimin e fondit prej 11,880,279 (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e tetëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë) lek pa TVSH, për kryerjen e investimit të objektit: "Ndërtim Stacioni i ri PUS-çpimi në Vrion dhe lidhja me rrjetin kryesor transmetues", "Miratimin e Preventivit dhe të Projektit të hartuar nga Dega Teknike e Ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime SHA Sarandë".

6. Vendim Nr.6, dt.24/03/2020 me objekt: "Plani operacional për higjienizimin e shërbimit të fuqizimit me ujë të pijshëm dhe kanalizimeve".

7. Vendim Nr.7, dt.24/03/2020 me objekt: "Miratimi i "Plani i Biznesit 2019-2023" të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime SHA Sarandë".

8. Vendim Nr.8, dt.24/03/2020 me objekt: "Miratimin e fondit prej 800,000 (tetëqind mijë) lek pa TVSH, për kryerjen e investimit të objektit: "Përmirësim Rrjeti KUZ, Shkolla "Adem Sheme", Rr. "Zenel Gjoleka", Blloku i Pallateve pranë Xhamisë", sipas kërkesës së paraqitur nga Bashkia Sarandë", "Miratimin e Preventivit dhe të Projektit të hartuar nga Dega Teknike e Ndërmarrjes Ujësjellës-Kanalizime SHA Sarandë".

9. Vendim Nr.8/1, dt.24/03/2020 me objekt: "Miratimin e Draft Materialit të paraqitur për miratimin e normativave të konsumit të karburantit dhe metodologjinë e hartimit të dokumentacionit justifikues të harxhimit të karburantit dhe modeleve të fletëve të udhëtimit".

10. Vendim nr. 9, dt.24/04/2020 me objekt: "Miratimin e proces verbalit të datës 27/12/2019 të komisionit të inventarizimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve në magazinë që kanë humbur funksionin e tyre në shumën 256,403 lekë, "Miratimin e proces verbalit të dt.28/12/2019 të komisionit mbi nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve kompjuterike me vlerë fillestare 1,344,158.50 lekë, amortizimi 1,235,479 lekë dhe vlerë e mbetur 108,680 lekë", "Të ngrihet komisioni për verifikimin dhe hartimin e listës së mallrave me qarkullim të ngadalshëm dhe pasi të bëhet seleksionimi i atyre që mund të përdoren, pjesa tjeter të dalë jashtë përdorimi".

11. Vendim Nr.10, dt.24/04/2020 me objekt: "Miratimin e normës së provizionimit të detyrimeve në masën 0.5% mbi totalin e këtyre detyrimeve", "Të miratojë Projekt Vendimin e paraqitur për lidhjen e akt marrëveshjeve sipas kategorive të abonentëve".

12. Vendim Nr.11, dt.24/04/2020 me objekt: "Miratimin e znj. Zh. M me cilësinë e Nëpunësit Zbatues për lejimin dhe përdorimin e kësaj procedure".

13. Vendim Nr.11/1, dt.24/04/2020 me objekt: "Miratimin e procedurës për rekrutimin e punonjësve", "Miratimi i vlerësimit të pagë vjetore për çdo punonjës sipas formularit përkatës", "Përcaktimi i pagave të punonjësve dhe niveli i ndarjes së klasave do të aplikohet pas marrjes së vendimit për ndryshimin e pagës së Administratorit nga AP".

14. Vendim Nr.12, dt.28/05/2020 me objekt: "Miratimin e Rregullores së Brendshme të Shoqërisë".

15. Vendim Nr.13, dt.25/06/2020 me objekt: "Miratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin 2019, së bashku me dokumentacionin përkatës", "Përcaktimin e Fitimit të Shoqërisë të realizuar gjatë vitit financiar 2019 për shumën 9,727,814 lekë", "Fitimi i realizuar gjatë vitit 2019 të mbartet për investime të shoqërisë në vitet e ardhshme", "Miratimin e raportit të audituesve ligjorë kontabël të regjistruar, të Shoqërisë "F&. A." ShPK, përfaqësuar nga z. F. S dhe Shoqërisë "S. ." ShPK, përfaqësuar nga znj. L. A mbi auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë

për vitin 2019", "T'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve për emërimin e ekspertëve kontabël të miratuar për vlerësimin dhe pasqyrimin në Kapital të efekteve që sjellin transferimet: a. E kërkesave të arkëtueshme (Detyrimet e klientëve) që i përkasin Bashkisë Finiq në vlerën 26,871,536 lekë dhe të ish Komunave në varësi të kësaj Bashkie në vlerën 16,916,408 lekë dhe b. E mjeteve të transportit (pas riparimit dhe kthimit në gjendje pune të tyre) për vlerën neto 226,910 lekë (vlerë historike 11,356,256 lekë amortizim akumuluar 11,129,346 lekë)", "Të përcjellë Pasqyrat financiare së bashku me raportin e Auditimit për shqyrtim dhe miratim në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve".

16. Vendim nr. 14, datë 25/06/2020 me objekt: "Miratimin e masave që duhen marrë për zbatimin e rregullave të sigurimit teknik në të gjitha objektet që kanë të bëjnë me sigurimin teknik të punonjësve".

17. Vendim Nr.15, dt.29/07/2020 me objekt: "Miratimin e Raport Analizes për periudhën 6 mujore të funksionimit të Shoqërisë".

18. Vendim Nr.16, dt.29/07/2020 me objekt: "Miratimin e masave që duhen marrë për zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri".

19. Vendim Nr.17, dt.29/07/2020 me objekt: "Miratimin e fondit prej 4,422,930 (katër milion e katërqind e njëzet e dymijë e nëntqind e tridhjetë) Lek pa TVSH, për kryerjen e investimit të objektit "Ndërtim Pusi i Ri Nr.3/2020 në çuke-Ksamil dhe 1idhja me tubacionin e transmetimit", "Miratimin e Preventivit të hartuar nga Dega Teknike".

20. Vendim Nr.18, dt.29/07/2020 me objekt: "Miratimin e Projekt-Idesë "Për furnizimin me ujë të rajonit bregdetar Sarandë-Butrint nga burimet e Tatzatit".

21. Vendim Nr.18/1, dt.29/07/2020 me objekt: "Miratimi i "Plani i Biznesit 2020-2024" të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime SHA Sarandë", "Referuar Statutit te Shoqërisë, Neni7, pika a), dërgimin për miratim nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, të Planit të Biznesit 2020-2024".

22. Vendim Nr.19, dt.31/08/2020 me objekt: "T'i lejë detyrë Administratorit të Shoqërisë të marrë masa për ngritjen e komisioneve dhe ndjekjen e të gjitha problematikave që kanë të bëjnë me asetet e Shoqërisë për të bërë të mundur regjistrimin e çdo pasurie në emër të Shoqërisë duke përfshirë edhe objektet e reja të marra në dorëzim në Sarandë dhe Ksamil", "Për godinat dhe trojet që figurojnë me mbivendosje ose janë zënë nga persona të tjerë, të merren masa për lirimin e tyre", "Te behet plan rivelirni nga një topograf i licencuar për të pasqyruar gjendjen faktike të objekteve", "Ngritjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të investimeve të kryera nga Bashkia Sarandë, por që janë asete të Shoqërisë UK Sarandë".

23. Vendim Nr.20, dt.24/09/2020 me objekt: " T'i lejë Administratorit të Shoqërisë per t'iu drejtuar me shkresë Bashkisë Sarandë si dhe Ministrisë përkatëse, per t'u shprehur lidhur me sipëfaqet e tokës dhe objektet e zëna nga persona të tjerë", "Po ashtu t'i drejtohet me shkresë Bashkisë Sarandë ku, pasi t'i vijë në dispozicion një informacion të hollësishëm për asetet që disponon UKS të cilat i ka në pronësi por nuk i përdor, të shprehet Bashkia lidhur me to".

24. Vendim Nr.21, dt.20/10/2020 me objekt: "Te miratojë treguesit ekonomiko-financiar të Shoqërisë për 9 mujorin e vitit 2020".

25. Vendim Nr.22, dt.27/11/2020 me objekt: "Të konfirmojë dhe miratojë tarifat e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për vitin 2021, sipas tabelës bashkëlidhur", "Në vijim të këtij miratimi ngarkohet Administratori i Shoqërisë të ndjekë të gjitha procedurat e parashikuara ligjore për realizimin e seancës dëgjimore me publikun, marrjen e mendimit të Këshillit Bashkiak dhe paraqitjen e aplikimit për miratimin e tarifave prane ERRU".

26. Vendim Nr.23, dt.27/11/2020 me objekt: "T'i lejë detyrë Administratorit të Shoqërisë dhe komisioneve të ngritura që saktësojnë asetet e marra nga ish Komuna Ksamil", "Të përcktohet për ujësjellësin e Ksamilit vlera e aseteve të reja të marra në dorëzim", "Të saktësohet gjendja fizike e aseteve dhe të propozohet për nxjerrjen jashtë përdorimit të atyre që janë bërë të papërdorshme".
27. Vendim Nr.24, dt.27/11/2020 me objekt: "Dhënien e ndihmës për rast sëmundje të rëndë të një anëtari të familjes (djalit) të punonjësit të kësaj Shoqërie Z. O. B, në vlerën 100,000 (njëqind mijë) Lek. Të gjitha shpenzimet që llogariten mbi këtë vlerë (tatim në burim) të përballohen nga Shoqëria".
28. Vendim Nr.25, dt. 15/12/2020 me objekt: "Miratimin e tarifës së rilidhjes për furnizmin me ujë të konsumatorëve, pavarësisht nga shkaku i ndërprerjes në vlëren 2,400 (dymijë e katërqind) Lek".
29. Vendim Nr.26, dt.15/12/2020 me objekt: "Miratimin e Listës së punonjësve të Shoqërisë dhe anëtarëve të Këshillit të Administrimit që do të përfitojnë shërbim telefonie të paguar nga Shoqëria", "Vlera e shpenzimeve mujore që do të rimbursohet nga Shoqëria do të jetë në shumën 3,000 (tremijë) Lek", "Operatori i telefonisë do të jetë në varësi të numrave disponibël te punonjësve".
30. Vendim Nr.27, dt.15/12/2020 me objekt: "Miratimin e fondit prej 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lek, për mbulimin e shpenzimeve për 2 (dy) seancat e dëgjesave publike që Shoqëria UKS do të organizojë për propozimet e ndryshimeve në planin tarifor në Njësinë Administrative Ksamil dhe Bashkinë Sarandë, më datë 18/12/2020".
Pika 1. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Regjistri për pjesëmarrjen në mbledhje të anëtarëve të Këshillit të Administrimit) për Këshillin e Administrimit dhe Administratori, konstatohet se anëtarët nuk janë mbledhur të paktën 1 (një) herë në muaj, konkretisht për muajin Janar, veprime këto në kundërshtim me *VKM-në nr. 63, datë 27/01/2016, Neni 14, Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit, Pika 1*, ku përcaktohet që:

Neni 14: Mbledhja dhe vendimet e Këshillit të Administrimit *Pika 1. Këshilli i Administrimit mblidhet jo më pak se 1 (një) herë në muaj dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e Kryetarit.*

Për vitin 2021 Këshilli i Administrimit i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë, përbëhet nga 3 anëtare:
Z. K. K, Kryetar i Këshillit të Administrimit.
Z. E. Gj, Zv. Kryetar i Këshillit të Administrimit.
Z. Sh. L, anëtar i Këshillit të Administrimit dhe Administrator i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë.
Këshilli Administrativ i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sarandë për vitin 2021 janë marrë në total 12 vendime, më konkretisht si më poshtë:
1. Vendim Nr.28, dt.18/01/2021 me objekt: "Të miratojë Rregulloren "për hetimin administrativ të sinjalizimit të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime SHA Sarandë", e cila i bashkëngjitet këtij vendimi", "Vendimi dhe Rregullorja t'i përcillet për zbatim drejtorive përkatëse", "Ky vendim hyn në fuqi menjëherë".
2. Vendim Nr.1, dt.15/02/2021 me objekt: "Miratimin e Regjistrit të parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2021 të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime SHA Sarandë, mbështetur në relacionin e hartuar dhe pasqyrat përkatëse, bashkangjitur", "Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë si dhe degët përkatëse".

3. Vendim Nr.3, dt.15/02/2021 me objekt: "Miratimin e kërkesës së Degës Mekanike për sasinë prej 100 l/muaj të karburantit që do të konsumohet për nevoja të këtij Sektori", "Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë si dhe degët përkatëse".
4. Vendim Nr.3, dt.05/03/2021 me objekt: "Miratimin e shpërblimit në shumën 4,500 (katërmijë e pesëqind) Lek, për 42 punonjës me rastin e Festës së 8 Marsit".
5. Vendim Nr.3/1, dt.05/03/2021 me objekt: "Miratimin e Studimit (Raport Hidrogjeologjik) "Për furnizimin me ujë të rajonit bregdetar Sarandë-Butrint nga burimet e Tatzatit".
6. Vendim Nr.4, dt.12/04/2021 me objekt: "Miratimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin 2020 së bashku me dokumentacionin përkatës", "Përcaktimin e rezultatit financiar të Shoqërisë (humbje) në shumën 54,571,029 Lek", "Humbja e realizur gjatë vitit 2020 të mbartet për periudhat e ardhshme", "Miratimin e raportit të audituesve ligjorë kontabël të regjistruar të Shoqërisë "F&. A." ShPK përfaqësuar nga z. F. S dhe Shoqërisë "S." ShPK përfaqësuar nga Znj.L. A mbi auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërisë për vitin 2020", "T'i propozojë Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve për emërimin e ekspertëve kontabël të miratuar për vlerësimin dhe pasqyrimin në Kapital të efekteve që sjellin transferimet: a. E kërkesave të arkëtueshme (detyrimet e klintëve) qe i përkasin Bashkisë Finiq në vlerën 26,871,536 Lek dhe të ish Komunave në varësi të kësaj Bashkie në vlerën 16,916,408 Lek dhe b. E mjeteve të transportit (pas riparimit dhe kthimit në gjendje pune të tyre) për vlerën neto 226,910 Lek (vlerë historike 11,356,256 Lek — amortizim akumuluar 11,129,346 Lek)", "Të përcjellë Pasqyrat Financiare së bashku me Raportin e Auditimit për shqyrtim dhe miratim në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionarëve".
7. Vendim Nr.5, dt.12/04/2021 me objekt: "Dhënien e ndihmës për rast sëmundje të rëndë dhe kurim jashtë shtetit të një anëtari të familjes (vëllait), të punonjësit së kësaj Shoqërie z. F. B në vlerën (dyqind mijë) Lek. Të gjitha shpenzimet që llogariten mbi këtë vlerë (tatim në burim) të përballohen nga Shoqëria".
8. Vendim Nr.7, dt.22/06/2021 me objekt: "Miratimin e fondit prej 11,044,530 (njëmbëdhjetë milion e dyzet e katërmijë e pesëqind e tridhjetë) Lek pa TVSH, për kryerjen e investimit të objektit "Përmirësim rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura, Rr."13 Bilbilenjte", Rr."Abedin Dino", Rr."Vangjel Pandi", Rr. "Skënderbeu", Rr. "18", Rr. "Pandeli Bocari", "Miratimin e Preventivit dhe të Projektit të hartuar nga Dega Teknike e Ndërmarrjes Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë".
9. Vendim nr. 9, datë 28/10/202l me objekt: "T'i lejë detyrë Administratorit të Shoqërisë si dhe Degës Teknike që të hartojë dokumentacionin e nevojshëm me qëllim pajisjen me certifikatë pronësie të aseteve të Shoqërisë (rrjeti kanalizimeve Sarandë)".
10. Vendim Nr.10, dt.28/10/2021 me objekt: "Të miratojë kërkesën e Këshillit të Bashkisë Sarandë përcjellë pranë Shoqërisë UKS nëpërmjet Kryetarit të Bashkisë Sarandë", "Nga ana e Degës Teknike të hartohet dokumentacioni i nevojshëm, projekti si dhe preventivi, me që1lim lidhjen me kanalizimet dhe sistemimin e ujërave të zeza në lagjen Lugu i Dardhës".
11. Vendim Nr.11, dt.24/11/2021 me objekt: "Miratimin e fondit prej 9,825,084 (nëntë milion e tetëqind e njëzet e pesëmijë e tetëdhjetë e katër) Lek pa TVSH, për kryerjen e investimit me objekt "Ndërtim rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura, Lugu i Dardhës", "Miratimin e projektit dhe preventivit të hartuar nga Dega Teknike".
12. Vendim nr. 12, dt.30/12/2021 me objekt: “Miratimin e Planit të Biznesit të Shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime SHA Sarandë për vitin 2022”, “Referuar Statutit të Shoqërisë, Neni 7,

pika a, dërgimin për miratim nga Asambleja e Aksionarëve të Planit të Biznesit për vitin 2022".

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Strukturave Drejtuese për vitin 2020, nuk u konstatuan mangësi në mbajtjen e dokumentacionit dhe as parregullsi në vendimet e marra për këtë vit.

4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Tabela nr. 1. Realizimi i strukturës organizative për vitet 2019-2021.

Muajt	Viti 2019			Viti 2020			Viti 2022		
	Miratuar	Realizuar	Diferenca	Miratuar	Realizuar	Diferenca	Miratuar	Realizuar	Diferenca
Janar	170	174	+ 4	170	162	- 8	170	177	+ 7
Shkurt	170	168	- 2	170	163	- 7	170	177	+ 7
Mars	170	169	- 1	170	163	- 7	170	175	+ 5
Prill	170	172	+ 2	170	165	- 5	170	174	+ 4
Maj	170	172	+ 2	170	166	- 4	170	176	+ 6
Qershor	170	173	+ 3	170	168	- 2	170	173	+ 3
Korrik	170	177	+ 7	170	168	- 2	170	172	+ 2
Gusht	170	180	+ 10	170	171	+ 1	170	172	+ 2
Shtator	170	181	+ 11	170	171	+ 1	170	172	+ 2
Tetor	170	172	+ 2	170	172	+ 2	170	178	+ 8
Nëntor	170	166	- 4	170	174	+ 4	170	179	+ 9
Dhjetor	170	166	- 4	170	175	+ 5	170	177	+ 7

Burimi i të dhënave: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.

5. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.,).

Tabela nr. 1. Gjendja e bankave për vitet 2019-2021.

Lekë

Viti 2019			
Nr.	**Banka**	**Gjendja në fillim të vitit**	**Gjendja në fund të vitit**
1	Raiffeisen Bankë	4,262,899.8	1,457,353.96
2	Tirana Bankë	6,485,261.6	10,601,007.80
3	Societe Generale Bankë	5,992,319.8	1,273,735.53
4	Banka Kombëtare Tregtare	764,541.3	7,215,117.02
5	Amerikan Bankë Invenstiments	1,597,507.5	582,031.26
6	NBG	8,962,316.9	4,224,860.39
7	Credins Bankë	6,106,936.1	1,566,567.84
8	Alpha Bankë	3,320,505.3	1,769,622.30
9	FI-Bankë	27,137	653,647
10	Intesa San Paolo Bankë	0	968.40
11	Tirana Bankë USD	0	(64.17 USD) 6,971.43
Totali		**37,519,425.4**	**29,351,882.93**
Viti 2020			
Nr.	**Banka**	**Gjendja në fillim të vitit**	**Gjendja në fund të vitit**
1	Raiffeisen Bankë	1,457,353.96	2,035,999.16
2	Tirana Bankë	10,601,007.80	1,042,974.99
3	Tirana Bankë USD	(64.17 USD) 6,971.43	11,055.09
4	OTP	1,273,735.53	100,122.85
5	Banka Kombëtare Tregtare	7,215,117.02	2,570,335.48
6	Amerikan Bankë Invenstiments	582,031.26	3,315,989.69
7	NBG	4,224,860.39	0

8	Credins Bankë	1,566,567.84	1,321,791
9	Alpha Bankë	1,769,622.30	1,652,616.30
10	FI-Bankë	653,647	655,523.40
11	Union Bankë	0	1,256,255.92
12	Intesa San Paolo Bankë	968.40	870,476
Totali		**29,351,882,53**	**14,833,139.88**
Viti 2021			
Nr.	**Banka**	**Gjendja në fillim të vitit**	**Gjendja në fund të vitit**
1	Raiffeisen Bankë	2,035,999.16	124,168.2
2	Tirana Bankë	1,042,974.99	7,368,826.6
3	Tirana Bankë USD	11,055.09	7,128.3
4	OTP	100,122.85	1,185,766.5
5	Banka Kombëtare Tregtare	2,570,335.48	1,442,939.5
6	Amerikan Bankë Invenstiments	3,315,989.69	5,421,194.6
7	Credins Bankë	1,321,791	3,179,401.8
8	Alpha Bankë	1,652,616.30	65,785.3
9	FI-Bankë	655,523.40	362,091.6
10	Union Bankë	1,256,255.92	3,471,891.7
11	Intesa San Paolo Bankë	870,476	143,193
Totali		**14,833,139.88**	**22,772,387.13**

Burimi i të dhënave: Shoqëria Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë

Tabela nr. 2. Të dhënat mbi konsumin e karburantit për mjetet audituara me zgjedhje paraqiten si më poshtë:

Litra

Viti 2019														
		Muajt												
Mjeti	**Targa**	**Janar**	**Shkurt**	**Mars**	**Prill**	**Maj**	**Qershor**	**Korrik**	**Gusht**	**Shtator**	**Tetor**	**Nëntor**	**Dhjetor**	**Total**
Mercedes	SR...B	410	480	480	570	590	540	680	580	610	610	750	600	**6,900**
Hundai	AA...LU	580	500	410	500	480	475	430	580	570	520	510	550	**6,105**
Ford	AA...LM	110	200	210	220	250	150	200	250	280	240	260	200	**2,570**
Fiat	SR...8B	410	480	420	430	400	400	370	400	300	-	-	240	**3,850**
Nissan	SR...B	210	180	200	200	200	160	200	250	220	200	220	240	**2,480**
Skrep	A...4	600	560	510	590	510	480	680	550	580	580	590	680	**6,910**
Renault	AA...PZ	730	600	660	690	680	650	870	1140	760	740	730	820	**9,070**
Motokarro	-	140	140	160	180	130	140	150	150	140	120	130	160	**1740**
TOTALI		**3,190**	**3,140**	**3,050**	**3,380**	**3,240**	**2,995**	**3,580**	**3,900**	**3,460**	**3,010**	**3,190**	**3,490**	**39,625**
Viti 2020														
		Muajt												
Mjeti	**Targa**	**Janar**	**Shkurt**	**Mars**	**Prill**	**Maj**	**Qershor**	**Korrik**	**Gusht**	**Shtator**	**Tetor**	**Nëntor**	**Dhjetor**	**Total**
Mercedes	SR...B	630	640	650	660	670	630	510	550	560	470	450	520	**6,940**
Hundai	AA...LU	570	560	580	570	560	480	550	570	580	590	570	580	**6,760**
Ford	AA...LM	40	100	90	100	50	50	60	100	200	100	240	150	**1,280**
Fiat	SR...B	250	280	250	260	240	190	260	240	250	220	230	240	**2,910**
Nissan	SR...B	230	240	250	240	250	240	250	240	260	240	230	260	**2,930**
Skrep	A...4	600	630	640	630	620	490	620	600	660	610	620	670	**7,390**
Renault	AA...PZ	720	690	710	700	710	540	850	730	830	730	700	780	**8,690**
Mitsubishi	AA...YP	120	130	120	120	100	60	200	180	170	180	160	200	**1,740**
Mitsubishi	AA...YP	230	220	230	220	210	170	200	180	170	180	210	210	**2,430**
Totali		**3,390**	**3,490**	**3,520**	**3,500**	**3,410**	**2,850**	**3,500**	**3,390**	**3,680**	**3,320**	**3,410**	**3,610**	**41,070**
Viti 2021														
		Muajt												
Mjeti	**Targa**	**Janar**	**Shkurt**	**Mars**	**Prill**	**Maj**	**Qershor**	**Korrik**	**Gusht**	**Shtator**	**Tetor**	**Nëntor**	**Dhjetor**	**Total**
Mercedes	SR...B	530	480	470	490	470	480	510	480	510	530	560	540	**6,050**
Hundai	AA...LU	570	560	550	570	580	590	590	600	580	500	570	510	**6,770**
Ford	AA...LM	200	100	200	200	200	200	100	100	200	250	220	200	**2,170**
Fiat	SR...B	210	220	200	210	200	210	220	120	110	120	100	70	**1,990**
Nissan	SR...B	260	250	240	250	230	250	260	230	220	240	250	240	**2,920**
Skrep	A...4	680	620	590	620	600	610	600	740	410	480	580	390	**6,920**
Totali		**2,450**	**2,230**	**2,250**	**2,340**	**2,280**	**2,340**	**2,280**	**2,270**	**2,030**	**2,120**	**2,280**	**1,950**	**26,820**

Burimi i të dhënave: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.

Tabela nr. 3. Të dhënat mbi detyrimet e kamatëvonesat mbi kontratat e konsumit të energjisë elektrike.

Lekë

Nr.	Emërtimi	Nr. i kontratave	Detyrime pa u likuiduar nga viti 2019	Detyrime pa u likuiduar nga viti 2020	Detyrime pa u likuiduar nga viti 2021	Totali i detyrime deri më datën 31.12.2021	Kamatëvonesa deri më 31.12.2021
1	Stacioni i pompave të ujërave të zeza mbi RRAP	GJ0A010006018471	1,610,112	1,059,072	286,424.12	2,955,608.12	4,818,416.76
2	Pompa e ujit metalike Sarandë qytet	GJ0A010004019505	116,913.60	15,840	1,440	134,193.60	737,172.41
3	Ndërmarrja e ujësjellësit	GJ0A010028022097	34,988.80	1,360	13,524	49,872.80	168,910.70
4	Pompa e ujit Vrion	GJ0A010062022116	14,310,821.72	20,828,792	23,141,376	58,280,989.72	34,428,260.63
5	Burim ujësjellës Navaricë	GJ0B030014044063	4,233.60	2,671.20	3,511.20	10,416	23,205.49
6	Pompa e ujit Gjashtë	GJ0B020198047001	1,703,702.40	1,203,494.40	1,718,937,60	4,626,134.40	4,946,126.89
7	Ujësjellës Kanalizime Myrtajt	GJ0A010045095109	209,210.40	178,735.20	226,833.60	614,779.20	558,171.67
8	Pompë uji (Shelegar)	GJ0B020214046972	263,037.60	170,133.60	272,764.80	705,936	612,911.33
9	Stacioni i ri i ujërave të zeza Çuke-ITUN	GJ1G060128066646	186,700	1,360	13,358.40	201,418.40	1,034,710.46
10	Ujësjellës Komuna Aliko	GJ0B020001044526	1,902,062.40	1,020,264	1,575,319.20	4,497,645.60	14,004,596.41
11	Depo uji Lugu Dardhës	AL0019394	0	20,332	2,040	22,372	13,713.11
12	Stacioni i pompimit Lagja Baba Rexhepi	AL0021997	0	263,162.40	181,183.20	444,345.60	75,785.83
13	Stacioni i pompimit Lugu Dardhës	AL0032429	0	17,418.56	28,561.46	45,980.02	19,098.85
14	Pusi Ksamil Çuke	GJ0B020001044570	539,020.00	198,352	2,040	739,412	1,876,231.97
15	Pompa e re Ksamil	GJ0B020288097332	1,498,300	632,404	1,060,764	3,191,468	2,991,864.56
16	Elekropompa Ksamil-Çuke	GJ0B020002044564	1,680	960	1,440	4,080	58,181.85
17	Komuna Ksamil (Pompë uji Manastir)	GJ0B020050099741	167,915.20	191,953.60	194,976	554,844.80	476,599.85
18	Elekropompa e re Ksamil-Çuke	GJ1G020106044569	9,569,280	10,481,856	13,016,640	33,067,776	31,665,857.08
19	Elekropompa-Çuke	GJ0B020001046861	1,680	960	1,440	4,080	191,555.39
20	KUZ Stacioni i pompimit PS2	GJ0B010001101519	746,140	18,276.64	2,040	766,456.64	658,455.55
21	KUZ Stacioni i pompimit PS4	GJ0B010001101520	786,981.76	33,320.32	2,040	822.342.08	715,529.83
22	KUZ Stacioni i pompimit PS5	GJ0B010001101521	723,455.20	(672,038.40)	127,540.76	178,957.56	142,679.06
23	KUZ Stacioni i pompimit PS6	GJ0B010001101522	915,292	365,547.20	1,182,942.14	2,463,781.34	1,408,138.86
				340		340	
				(205,939)		(205,939)	
Totali			**35,291,526.68**	**35,828,627.72**	**43,057,136.47**	**114,177,290.87**	**101,626,174.54**

Burimi i të dhënave: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.

Tabela nr. 4. Të dhënat mbi gjobat e likuiduara nga Shoqëria.

Lekë

Datë Pagese	Lloji i detyrimit	Periudha e marrjes penalitetit	Principal	Gjobë	Interesa	Totali
21.11.2019	TVSH detyrim principal	Mars 2011	0	0	417	417
21.11.2019	ESIG 27 deklarim i vonuar	Shtator 2018	0	10,000	0	10,000
21.11.2019	Sigurime shoqërore & TAP deklarim i vonuar	Gusht 2015	0	9,067	0	9,067
21.11.2019	Sigurime shoqërore & TAP deklarim i vonuar	Korrik 2019	0	11,296	354	11,650
21.11.2019	TAP detyrim principali	Maj 2015	101	22	29	51
21.11.2019	Tatim burim deklarim vonuar	Korrik 2018	0	8,859	0	8,859
21.11.2019	Tatim burim deklarim vonuar	Shkurt 2019	0	10,000	0	10,000
21.11.2019	Paraqitje me vonesë vendim Ortaku	Janar Dhjetor 2016	0	80,000	0	80,000
21.11.2019	Paraqitje me vonesë vendim Ortaku	Janar Dhjetor 2017	0	20,000	0	20,000
31.12.2021	Tatim burim deklarim vonuar	Tetor 2019	0	10,000	0	10,000
31.01.2020	Mos depozitim të PF për mungesë vendim Asambleje	QKB- PF Viti 2018	0	15,000	0	15,000
09.10.2020	Paraqitje me vonesë vendim Ortaku	Janar Dhjetor 2019	0	10,000	0	10,000
28.01.2021	Mos depozitim të PF për mungesë vendim Asambleje	QKB- PF Viti 2019	0	15,000	0	15,000
10.12.2021	Mos deklarim tejkalim 10% fitimi	Viti 2016	0	6,000	0	6,000
28.12.2021	Tatim burim deklarim i vonuar	Tetor 2021	0	10,000	861	10,861
Totali			**101**	**215,244**	**1,661**	**217,006**

Burimi i të dhënave: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.

Tabela nr. 5. Detyrimet dhe penalitetet referuar akt marrëveshjeve të nën huas.

ID MFE	Projektet	Monedha	Stoku	Detyrimet e Prapambetura të UK Sarandë deri më 31.12.2021				Penalitete më 31.12.2021 (e)	Total Detyrimi i UK Sarandë ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
				Interes (a)	Komision (b)	Principal (c)	Totali i Detyrimit d=(a+b+c)		

										më 31.12.2021 (d+e)
O-03/13/Saranda	"Infrastruktura Ujore Bashkiake "- BEI Stacioni i trajtimit të ujërave të ndotur	EUR	2,357,251.93	392,891.59	0	1,275,923.90	1,668,815.49	141,223.38		1,810,038.87
O-03/04/Saranda	"Projekti Bashkiak i Furnizimit me ujë dhe Kanalizime" –IDA	USD	2,186,718.91	336,372.38	0	1,968,047.10	2,304,419.48	0		2,304,419.48
O-10/08/Saranda*	"Infrastruktura Ujore bashkiake I " KfŴ (Saranda 4,000,000 Euro)	EUR	4,000,000.00	11,626.58	0	133,333.34	144,959.92	0		144,959.92
O-12/04/Saranda**	"Infrastruktura Ujore bashkiake II" KfŴ (UK Sarande 500,000 Euro)	EUR	500,000.00	0	0	0	0	0		0
Totali			9,043,970.84	740,890.55	0	3,377,304.34	4,118,194.89	141,223.38		4,259,418.27

Burimi i të dhënave: Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT